banorëve të një qyteti. Por krahas këtij skenari zhvillimi, një tjetër skenar prej kohësh zhvillohet paralelisht. Po aq aktuale dhe e pranishme, ndoshta me ndikim edhe më të madh në jetën e banorëve të kryeqytetit janë ndërkohë ndërtimet dhe kantieret e reja qoftë këto në brendësi të pëlhurës urbane të qytetit, qoftë këto edhe në zonën peri-urbane të tij. Silueta apo “skyline-i” i qytetit mund të ilustronjë më shumë se çdo gjë tjetër shkallën e lartë të kësaj tendence në qytet në këto 30 vitet e fundit.

Të gjitha këto fenomene që ndodhin në qytet përcaktojnë, apo krijojnë një dyzim (dichotomy) mes qasjes apo tendencës në të cilin qyteti ka planifikuar dhe tenton të zhvillohet. Nëse në kontekstin ndërkombëtar dhe sidomos atij evropian, tendencat janë shumë të lexueshme por dhe të matshme mbi ruajtjen e ekuilibrave mes antropizimit dhe sistemeve natyrore, në kontekstin lokal ende nuk është zhvilluar madje nuk ka as metodologji të ndonjë vlerësimi sasior dhe cilësor të këtij aspekti. Pikërisht ky është sfondi në shkallë lokale dhe ndërkombëtare, mbi të cilin ngrihen edhe pyetjet kryesore të këtij kërkimi:

Parë nëpërmjet lentës së sistemeve natyrore dhe gjysmë-natyrore, cili është dimensionin natyror i pëlhurës urbane të qytetit të Tiranës?

Thënë sa më sipër, mënyra e trajtimit të kësaj teme disertacioni ka për qëllim shmangien në maksimum të aspekteve që mund të interpretohen dhe atyre subjektivë dhe do të tentojë t’i përmbahet shifrave, metodave dhe vlerësimeve objektive (sasiorë dhe cilësorë) për të përfruar një diskutim sa më afër realitetit dhe jo vetëm, por për ta bërë kontekstin lokal të krahasueshëm me atë evropian që përbën dhe një tjetër nën-objektiv të këtij studimi.

1.4 Përcaktimi i metodologjisë së përgjithshme të kërkimit

Ky kërkim është konceptuar i organizuar me një hyrje dhe më pas zhvillimit të tre pjesëve, të cilat përveçse janë komplementare të njëra-tjetrës, mund të qëndrojnë duke u zhvilluar me tej edhe si pjesë studimore më vete duke synuar gjithsecila të ketë një rezultat të vetin, por ku peshën kryesore e merr krijimi i data bazës, analizimi dhe vlerësimi i dimensionit në terma sasiorë dhe cilësorë i sistemeve natyrore dhe gjysmë natyrore në pëlhurën urbane të qytetit të Tiranës. Organizimi në këtë formë ka qenë deri diku i detyruar edhe si rrjedhojë e mungesës së një data baze mbi të cilën të mund të zhvilloheshin analiza të detajuara dhe të thelluara, ca më pak të studimeve lokale në fushën e landscape-it apo peizazhit natyror.

Kështu, për të mundësuar kthimin e përgjigjes ndaj pyetjes kryesore të kërkimit, pas studimit të literaturës dhe aspekteve teorike e qasjeve në nivel ndërkombëtar, janë kombinuar disa metoda të kërkimit si (i) metoda të vlerësimit sasior; (ii) metoda të kërkimit cilësor dhe në pjesën e tretë prezantohet një eksperiment i realizuar në proceset didaktike, që përfaqëson (iii) metodën e kërkimit nëpërmjet procesit të projektimit (TABELA 1.4.1).




TABELA 1.4.1

Tabelë ilustruese e zhvillimit të Metodës | Metodave së Kërkimit;
Përpunoi: Autori

Hyrja - Me mbledhjen e informacioneve teorike, hartografike dhe data bazës ekzistuese, për të mundësuar me pas kthimin e pyetjes kryesore të kërkimit, rezultoi e nevojshme përshkrimi i një përmbledhjeje të qasjeve teorike në fushën e kërkimit për të sqaruar disa koncepte kryesore të cilat janë sfidë e kërkimeve dhe zhvillimeve sot në botë, e sidomos në vendet evropiane. Kjo realizohet edhe për faktin se është një fushë kërkimi relativisht komplekse që prej fillësive të saj, gjatë gjithë kohës në evoluim dhe referuar shumë shkrimeve, ende në kërkim të vetes së vet.

Është vlerësuar si i domosdoshëm një shpjegim në nivel teorik për të kuptuar se çfarë elementësh, apo kë segment në fushën e peizazhit natyror ky studim ka për qëllim të përmbushë. Krijimi i një sfondi të qartë teorik dhe të kuptuarit të qasjes/qasjeve mbi projektimin/planifikimin në shkallë të ndryshme të pëlhurës urbane/territorit është konsideruar si një fazë shumë e rëndësishme për të arritur në konkluzione të tilla të cilat do të mund të shërbenin në organizimin dhe strukturimin më pas të gjithë kërkimit në fazat dhe kalimin e proceseve të mëposhtme:

Pjesa e Parë - Kjo pjesë e studimit tenton të realizojë një kërkim në terma ndërkombëtarë për të mundësuar krijimin e një modeli reference, e që më pas të mund të përdoret për t'u krahasuar me modelin ekzistues lokal. Kështu, nëpërmjet kombinimit të metodave të kërkimit sasior dhe krahasimeve, tentohet të realizohen vlerësime mes konteksteve të ndryshëm. Në kushtet e mungesës se referencave lokale në këtë fushë kërkimi, është tentuar të përcaktohen për të analizuar të dhëna në analogji me terma të përdorur në fushat akademike dhe atë legjislativë të Komunitetit Evropian. E gjithë kjo pjesë e parë është vlerësuar si një domosdoshmëri jo vetëm për të evidentuar apo nënvizuar elementët të cilët do të konsiderohen në kryerjen e këtij studimi, por dhe për të nxjerre në pah problematika të tjera në nivel lokal të cilat mund të jenë pjesë e studimeve të mëvonshme, sikundër edhe ka rezultuar, e do të trajtohen në kapitujt e mëvonshëm.

Pjesa e Dytë - Në këtë fazë të dytë, pasi janë përcaktuar termat në analogji me kontekstin evropian, tentohet të kuptohet konteksti lokal duke filluar nga dinamika e shtrirjes urbane në kohë, forma e qytetit, marrëdhënia që ky organizëm ka tentuar të krijojë me territorin, shkalla e ruajtjes së territorit natyror dhe gjysmë - natyror në periudha të ndryshme. Kjo përfaqëson atë pjesë të studimit e cila ka për qëllim të kthejë përgjigje edhe ndaj pyetjes kryesore të kërkimit. Duke qenë një fushë relativisht komplekse, janë përzgjedhur metoda dhe zëra të cilët do të mund t'i kthejnë përgjigje kësaj pyetje. Thënë këtë, është vlerësuar se verifikimi i termave sasiorë dhe pjesërisht cilësorë, paraqiten si metoda të mundshme për kthimin e kësaj përgjigjeje. Ndërsa për sa i takon termave sasiorë është e qartë se për çfarë komponenti/komponentësh bëhet fjalë, në terma cilësorë është bërë një përzgjedhje e elementeve të cilët përcaktojnë cilësinë e zonave me karakter natyror të cilët janë shumë. Në këtë kërkim me përcaktim cilësor i kemi referuar “aksesibilitetit” apo siç njihet ndryshe të qasurit apo të arriturit, duke ju referuar shkallës së afërsisë që çdo kategori e paracaktuar në studim e peizazhit natyror do të mund të ketë me banorët.

Pjesa e Tretë - Për ta bërë më të prekshëm këtë kërkim, por dhe për ta ndërlidhur fushën e kërkimit dhe vënë në funksion të zhvillimit të metodologjive të projektimit apo planifikimit, është përzgjedhur një projekt i zhvilluar përgjatë zhvillimit të Studiove të Diplomës ku ilustrohen rezultatet që mund të sjellë procesi i kujdesshëm i projektimit. Në këtë rast, metodat e analizimit nëpërmjet projektimit janë ndërthurur me metodat krahasimeve për të nxjerrë konkluzione dhe për të dhënë rekomandime, bazuar edhe në kërkimin e kryer mbi procesin e projektimit në fushën e zhvillimit të landscape-it apo peizazhit natyror.

Pas zhvillimit të këtyre pjesëve, vijohet me një përshkrim të vazhdimësisë së studimeve dhe hartim të konkluzioneve dhe rekomandimeve.

1.5 Pse ky kërkim?

Shqetësimi kryesor në nivel global në ditët e sotme është rritja e popullsisë në nivel global e si rrjedhim edhe sigurimi i burimeve natyrore për këtë popullsi gjithmonë e në rritje jo vetëm për popullsinë sot, por për brezat e ardhshëm nisur dhe nga vetë përkufizimi i ZHQ. Duke vlerësuar të gjitha zhvillimet në botë, sidomos ato urbane janë analizuar problematika të cilat në nivel planifikimi keq-menaxhojnë sistemet natyrore pre-ekzistuese. Thënë këtë, probleme të fragmentarizmit të territorit, shpyllëzimeve, dëmtimit e të gjithë sistemeve natyrore e si rrjedhim ekosistemeve, vlerësohen për të mundësuar jo vetëm teori dhe strategji të tjera në nivel të zhvillimit për të mos i dëmtuar ato, por dhe për të mundësuar ristrukturimin e sistemeve natyrore tashme të dëmtuara. Pra gjithë ky proces është i lidhur ngushtë me mënyrën e zhvillimit të territoreve për të mundësuar ruajtjen e resurseve natyrore dhe përdorimin e qëndrueshëm të tokës në shërbim të popullatave. Është e vërtetuar tashmë se njeriu nëpërmjet ndërhyrjeve të tij, antropizimit dhe zhvillimit të habitateve të tij është shkaktari kryesor i krijimit të problemit. Në këtë kontekst, mënyra se si këto habitate që ne i klasifikojmë si zona urbane, zhvillohen dhe shtrihen në territor në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm, merr rëndësi të madhe për sa i takon konsumimit të tokës. Nga ana tjetër, duke qenë organizma gjithmonë e në rritje, cilësia që ato i ofrojnë popullatave, është një tjetër prioritet. Ashtu sikurse do të mund të ilustrohet në kapitujt që vijojnë, prezenca e peizazhit natyror në brendësi të pëlhurës urbane është një komponent shumë i rëndësishëm, e si i tillë do të duhet të konsiderohet gjatë gjithë proceseve të planifikimit për vete faktin e shkallës vulnerabile që mbart.

1.5.1 Rëndësia e ruajtjes së sistemeve natyrore në zonat urbane, peri-urbane dhe rurale

Parë në këtë këndvështrim, ruajtja e territoreve në kufijtë e peri-urbanes së qytetit të Tiranës është një prioritet. Prej tre dekadash tashmë qyteti vijon të shtrihet në drejtimin horizontal duke transformuar territoret nga natyrore apo gjysmë - natyrore (me karakter agrikulturor) në territore të antropizuara. Siç do të shpjegohet edhe në kapitujt e mëvonshëm, përdorimi i tokës në mënyrë të racionalizuar është një prej metodave të konservimit të territoreve natyrore e nëpërmjet kësaj strategjie – ruajtja e resurseve natyrore për brezat e ardhshëm. Vëmendja për sa i takon ruajtjes së peizazhit natyror në perimetër të zonave të urbanizuara ka një rëndësi edhe më të madhe nëse konsiderojmë aspektin identitar të tyre.

1.5.2 Rëndësia e ruajtjes dhe zhvillimit të sistemeve natyrore dhe gjysmë - natyrore në brendësi të sistemeve urbane

Një gol tjetër i rëndësishëm në lidhje me ZHQ është dhe cilësisë së jetës në aspektet sociale, ekonomike dhe mjedisore që habitatet e njerëzve ofrojnë nëpërmjet mënyrës së si zhvillohen, marrëdhënies që krijojnë me territoret natyrore apo gjysmë-natyrore në brendësi të tyre. Me shtrirjen e madhe që këto organizma po fitojnë, gjithmonë e më tepër fiton rëndësi prezenca e këtyre territoreve në brendësi të pëlhurës urbane për të qenë në afërsi me banorin. Është vërtetuar nga shumë studime të kryera që prezenca në distancë të afërt e këtyre mjedisëve me karakter natyror ndikon ndjeshëm në mirëqenien dhe shëndetin e njeriut, përfshirë atë mendor.

Vëmendja sot qëndron jo vetëm tek njeriu, por dhe tek vazhdimësia e jetës cilësore të gjithë specieve si një kusht i domosdoshëm për të siguruar vazhdimësinë e jetës. Historikisht shumica e qyteteve kanë qenë të lira nga hapësirat e gjelbra, por qytetet kanë qenë relativisht të vogla dhe shumica e njerëzve jetonin në zonat rurale. Vetëm në shekullin e 19-të u arrit që rëndësia e parqeve dhe e hapësirave të tjera urbane të gjelbra për banorët të njihej deri diku (Swanwick et al., 2003). Në ditët e sotme kuptohet që sistemet natyrore dhe gjysmë - natyrore të cilat vijnë në pëlhurën urbane në formën e Hapësirave të Gjelbra Urbane (HGJU) janë thelbësore në mirë-funksionimin dhe në sigurimin e një qyteti të qëndrueshëm dhe të jetueshëm nëpërmjet të gjithë përfitimeve që sjellin në aspektet (i) Sociale; (ii) Ekonomike; (iii) Mjedisore. HGJU (1) Luajnë një rol në jetën rekreative të përditshmërisë së banorëve të një qyteti; (2) Kontribuojnë në ruajtjen e biodiversitetit; (3) Kontribuojnë në identitetin kulturor të një qyteti; (4) Ndhimojnë në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e cilësisë mjedisore të qytetit; dhe (5) Sjellin zgjidhje natyrore ndaj problemeve teknike (trajtimi i ujërave të ndotura) në qytete (Sandström 2002). Përveçse evidencave gjithmonë e në rritje të përfitimeve të HGJU, interesi për to udhëhiqet nga disa faktorë të tjerë sipas Swanwick et al. (2003): (Green Surge 3.1).

1.5.3 Përmbledhje e përfitimeve të prezencës së gjelbërimit në afërsi dhe brendësi të sistemeve urbane

Duke parë gjithë qasjet në shkallë ndërkombëtare, diskutimet shumë të shpeshta mbi zhvillimin e qëndrueshëm, mjedisi në përgjithësi dhe sistemet natyrore në veçanti kanë fituar një pozicionim të rëndësishëm, qoftë në aspektet teorike, qoftë në aspektet praktike. Peizazhi natyror dhe ai urban si fusha kërkimi e sidomos aplikimi në kontekstin shqiptar, janë ende fusha të pa eksploruara në këndvështrimin personal.

Me daljen e vendit nga një sistem totalitar dhe kalimin e tij në ekonomi të tregut të lirë, qyteti dhe banorët e tij janë munduar të adresojnë aspektet më jetike si p.sh. strehimi apo sigurimi i të ardhurave bazë të jetesës. Problematika të tjera të lidhura me pronësinë kanë qenë dhe janë ende të pa-zgjidhura në një pjesë të madhe duke renduar edhe me shumë problemet e zhvillimit dhe konservimit të territoreve natyrore dhe gjysmë - natyrore. Thënë sa më sipër, zhvillimi i menjëhershëm, sidomos 30-vjeçarin e fundit, bazohet kryesisht në ndërtimin e modeleve të shpejta ekonomike të zhvillimit të qyteteve apo qendrave urbane. Më pak vëmendje i është kushtuar zhvillimit të qëndrueshëm që është një koncept që shtrihet përtej aspektit ekonomik, e shumë pak

është folur e flitet për specifika që përcaktojnë cilësinë e jetës që ofrohet në qendrat e urbanizuara, ku duhet theksuar që Peizazhi Natyror luan një rol shumë të rëndësishëm. Në këtë këndvështrim, duke qenë dhe një nga elementët më vulnerabile në procese të ndryshme që janë zhvilluar, prezenca e sistemeve natyrore pothuaj ka rezultuar shpesh larg vëmendjes së aktorëve pjesëmarrës.

Duke u rikthyer në vëmendjen që ky aspekt ka fituar sot në nivele të ndryshme, është parë i domosdoshëm realizimi i një kërkimi në këtë fushë për të filluar e kontribuar sadopak duke filluar që nga kërkesa për vëmendje, një tentativë për të krijuar data-bazë, e për të vijuar deri tek supozimet apo propozimet e zhvillimit të metodave të përmirësuara gjatë procesit të projektimit. Thënë këtë, ky studim vjen si një thirrje për vëmendje ndaj një elementi shumë vulnerabile në kontekstin shqiptar - Peizazhit Natyror sidomos ruajtjes, zhvillimit dhe prezencës së tij brenda e në afërsi të kontekstit urban.

Suksesi i ruajtjes së peizazhit natyror është i lidhur në mënyrë paradoksale me zgjerimin e planifikuar të peizazheve të modifikuara nga njeriu në një zonë natyrore dhe kudo ku ka peizazh rural, në periferitë urbane gjithashtu. (Glikson, 1971)

1.6 Ngritja e pyetjeve të kërimit dhe përcaktimi i objektivave të studimit

Për t'ju përgjigjur pyetjes kryesore të kërimit mbi përcaktimin e dimensionit natyror të pëlurës urbane të qytetit të Tiranës, janë përcaktuar disa hapa paraprake e janë ngritur disa nën-pyetje mbi të cilat janë përcaktuar dhe objektivat e këtij kërkimi. Nëpërmjet grupimit të tematikave janë përcaktuar me pas kapitujt (FIGURA 1.6.1). Në vazhdimësi e për të plotësuar pyetjen kryesore të kërimit “Cili është dimensionin natyror dhe gjysmë-natyror në pëlurën urbane të qytetit të Tiranës?” lindin një seri nën-pyetjesh të cilat në këtë studim janë renditur dhe organizuar si më poshtë:

- (i) **Nën pyetje 01 - Cila do të ishte fusha e kërimit dhe cilët do të ishin treguesit kryesorë të kësaj fushe kërkimi, që do të mund t'i përgjigjeshin pyetjes në komunikimin mes urbanizimit dhe territorit natyror e atij gjysmë-natyror?**

(Objektiv 01.1) Në terma të përgjithshëm lind e nevojshme të zhvillohet në nivel informues prezantimi i fushës së kërimit ajo e peizazhit natyror, si një ndër fushat më të pa-eksploruara në nivel lokal e ndërkohë fusha e studimit më e përshtatshme në të gjitha nivelet në kthimin e përgjigjes kryesore të kërimit. Të kuptuarit e rëndësisë së këtij kërkimi nuk do të mund të dilte qartë pa përshkrimin e rolit dhe rëndësisë së tij përgjatë historisë si shoqëruar në zhvillimin e qyteteve. Është pikërisht konteksti historik i cili do të jetë fillesa e zhvillimit të modelit teorik dhe përcaktimit të elementëve thelbësorë që do të trajtohen. (Objektiv 01.2) Për të përcaktuar më pas treguesit kryesorë, do të ishte e nevojshme të shpjegohej shkalla e kompleksitetit në këtë fushë kërkimi në mënyrën se si trajtohet sot, e më pas të përcaktohej matrica me treguesit kryesorë mbi të cilët do të mund të mbështetej ky kërkim në mënyrë specifike.

- (ii) **Nën pyetje 02 - Cila është marrëdhënia mes landscape-it dhe qasjet e zhvillimit të qëndrueshëm sot?**

(Objektiv 02.1) Përshkrimi i qasjeve në planifikimin territorial dhe pozicionit që ka fituar sot projektimi dhe planifikimi i peizazhit natyror (landscape-it) në marrëdhënien mes urbanizimit dhe territoreve natyrore, në shërbim të sigurimit të cilësisë së jetës në to do të duhet të specifikohet e të dalë në pah nëpërmjet trajtimit të tendencave kryesore të zhvillimit e thënë këtu, më pas arsyet e përzgjedhjes së këtij studimi do të mund të kuptohen më mire. Është për t'u theksuar rëndësia e tij përgjatë proceseve të planifikimit të territorit, sidomos të territoreve urbane. (Objektiv 02.2) Përcaktimi i indikatorëve të rëndësishëm (referuar aspekteve teorike dhe standardeve ndërkombëtare) për t'u vlerësuar, është një tjetër objektiv i rëndësishëm i cili fillon gradualisht të strukturojë dhe kërkimin. Praktikisht objektivat e vendosur deri tani kanë për qëllim të krijojnë një sfond teorik dhe praktik të përshtatshëm për të vijuar më pas me hapa të tjerë të vlerësimeve të këtij kërkimi.

(i) Nën pyetje 03 - Paralelizëm mes modeleve lokale dhe evropiane. Cilat do të ishin indikatorët lokalë në nivel sasior e cilësor të cilët do të duhet të analizohen?

(Objektiv 03.1) Me qëllim kthimin nga një vlerësim subjektiv, në një vlerësim objektiv, përcaktimi i indikatorëve të cilët do të vlerësohen është i nevojshëm. Mblidhet data-baza, organizohen dhe analizohen të gjitha përkufizimet, terminologjitë e standardet në nivel lokal. Krahasimi i tyre me qasjet ndërkombëtare, pas prezantimit të tyre, lind si nevojë për të dhënë një pozicion më të mirë në një kontekst më të gjerë e për të bërë të mundur, krijimi i paralelizmave. Përcaktimi i metodologjisë krahasuese është gjithashtu një proces i nevojshëm. Realizimi i krahasimeve me kontekste të ngjashme është një objektiv shumë i rëndësishëm për të mundësuar të kuptuarit e vlerësuarit të situatës në të cilën qyteti ndodhet, parë nën këtë lente.

(ii) Nën pyetje 04 - Cila ka qenë qasja përgjatë historisë dhe tani në urbanizimin e Tiranës për sa i takon prezencës së sistemeve natyrorë dhe atyre gjysmë-natyrorë?

(Objektiv 04.1) Për t'ju përgjigjur kësaj pyetje, analizimi sipas faktit i momenteve të ndryshme historike bazuar në hartografi është i nevojshëm. Të preferuara në këtë proces mbeten ortofotot për shkak të informacionit që kanë mbi mbulimin e tokës. Pas përcaktimit të indikatorëve që do të vlerësohen, do të krijohet data-baza dhe do të nxirren statistika të cilat do të japin dhe tendencën e zhvillimit si dhe të kuptuarit e këtyre tendencave në marrëdhënien mes urbanizimit, lëvizjes demografike dhe prezencës së territoreve natyrorë e gjysmë-natyrorë në pëlhurën urbane të qytetit. Identifikimi dhe interpretimi i gjetjeve pozitive dhe negative do të realizonin dhe përmbushjen e këtij objekti. (Objektiv 04.2) Analizimi i situatës në ditët e sotme në pikëpamje të sasisë dhe cilësisë, do të përbënte dhe objektivin kryesor të kësaj teze doktrate. Kjo do të mund të përcaktonte një sfond mbi të cilin do të mund të fillohej të kuptuarit dhe interpretuarit të prezencës aktuale të peizazhit natyror. (Objektiv 04.3) Të kuptuarit e qasjes në nivelet e planifikimit sot në Tiranë është një aspekt shumë i rëndësishëm për të kuptuar trendin e zhvillimit të qytetit parë nën lentën e peizazhit

natyror. Thënë këtë, analizim i koncepteve kryesore të Tirana 2030 do të mund të jepte një panoramë shumë të qartë për sa i takon proceseve të planifikimit.

(iii) Nën-Pyetje 05 - Cilat do të ishin metodat dhe/apo rekomandimet në projektim dhe planifikim për të mundësuar përmirësimin e dimensionit natyror dhe gjysmë-natyror në brendësi të pëlhurës së qytetit?

(Objektiv 05.1) Përzgjedhje e një rasti studimor të trajtuar gjatë zhvillimit të Studios së Diplomës, udhëhequr nga autori, vjen me qëllim për të prezantuar se si fusha e kërkimit dhe ajo didaktike do të mund t'i shërbejnë njëra tjetrës. Rezultatet e kësaj faze do të mund të shërbejnë për të përmirësuar secilin prej proceseve të përfshirë në fushën e akademisë.

1.7 Struktura e kërkimit; Organizimi në kapituj e nën-kapituj

Siç u përmend më sipër, kjo teze disertacioni është konceptuar nëpërmjet organizimit në tre pjesë, krahas kapitullit të hyrjes dhe atij të konkluzioneve që përcaktojnë dhe shtyllën kurrizore të këtij studimi. Më poshtë dhe në (TABELEN 1.7.4) pasqyrohen nëpërmjet tekstit dhe grafikës tabela përmbledhëse e ndërlidhjes mes (a) Fazave të Parashikuara të punës kërkimore; (b) Kapitujve; si edhe (c) Përmbajtjes së tyre.

- (i) **Hyrja** Kjo do të përmbaje qasje në nivel ndërkombëtar të zhvillimit të territorit; Arsyet e Kërkimit; Metodologjinë e propozuar për të gjithë punimin e disertacionit; Prezantim të qasjeve teorike përgjatë historisë, që nga momenti i të ekzistuarit si fushë studimi e integruar me zhvillimin urban e deri në ditët e sotme me qëllim krijimin e një modeli teorik studimi.
- (ii) **Pjesa e Parë** Në krijimin e një sfondi të qartë të politikë-bërjes sot në nivel ndërkombëtar; Përshkallëzimi i politikë-bërjes nga niveli ndërkombëtar (KB), në nivel evropian (KE) e deri në nivelin lokal; Kërkimi i modeleve të referencës në ditët e sotme; Përcaktimi i metodologjive krahasuese dhe më pas realizimi i krahasimit në terma të përgjithshëm i modeleve ndërkombëtare dhe atij lokal.
- (iii) **Pjesa e Dytë** Përcaktimi i dimensionit natyror në pëlhurën urbane të qytetit të Tiranës në vite, që nga data e prezencës së hartave e deri në vitin 2015; Analizimi në aspektin sasior dhe cilësor i HGJU për pëlhurën urbane të qytetit të Tiranës, që përben dhe golin kryesor në zhvillimin e kësaj teme disertacioni trajtohet në këtë pjesë të dytë të kërkimit; Trajtimi nëpërmjet leximit i planit të përgjithshëm vendor TR 2030 është një tjetër aspekt ku do të vendoset theksi në ekzistencën e politikë-bërjes edhe në nivel lokal të qasjes ndaj peizazhit natyror.
- (iv) **Pjesa e Tretë** Kërkim nëpërmjet projektimit; Eksperimentimi didaktik vjen me qëllim të prezantimit të metodave të ndryshme për të kryqëzuar të dhënat kërkimore dhe didaktike në shërbim të përmirësimit të secilës prej fushave të veprimit. Në thelb kërkohet të ilustron përdorimi dhe vënia në shërbim e teorisë në përmirësim të procesit të projektimit.

PYETJET DHE OBJEKTIVAT E KËRKIMIT SHKENCOR

PYETJE KRYESORE E KËRKIMIT: Parë në aspektin e marrëdhënies së krijuar me hapësirat natyrore dhe gjysëm-natyrore, cili është modeli, por dhe performanca e qytetit të Tiranës?

<p>NËN-PYETJE 1: Si do të mund të interpretohej marrëdhënia mes hapësirave natyrore dhe gjysëm-natyrore, prezencës së tyre dhe performacës?</p> <p>(Kapitulli 1)</p>	<p>OBJEKTIV-1.1: Të kuptuarit e efekteve që ka urbanizimi në prezencën e hapësirave natyrore dhe gjysëm-natyrore. Problematikat e qytetit sot.</p> <p>OBJEKTIV-1.2: Shpjegim teorik mbi rëndësinë që ka ruajtja e hapësirave natyrore dhe gjysëm natyrore në zhvillimin e qëndrueshëm në përgjithësi dhe atë të qyteteve në veçanti.</p> <p>OBJEKTIV-1.3: Modelim teorik dhe një kuptueshmëri e performancës nëpërmjet skanimit të qasjeve teorike përgjatë historisë.</p>
<p>NËN-PYETJE 2: Cila ka qenë marrëdhënia përgjatë historisë me hapësirat natyrore dhe gjysëm-natyrore në qytetin e Tiranës?</p> <p>(Kapitulli 2,3 dhe 4)</p>	<p>OBJEKTIV-2.1: Ndryshimi i formës, shtrirjes, gjurmës, demografisë dhe marrëdhënies me hapësirat natyrore dhe gjysëm-natyrore në planifikimin e qytetit të Tiranës në vite.</p> <p>OBJEKTIV-2.2: Analizim i rëndësisë së sistemeve natyrore dhe gjysëm natyrore në legjislacionet dhe rregulloret e hartuara përgjatë historisë.</p> <p>OBJEKTIV-2.3: Analizimi i zbatueshmërisë së instrumentave të planifikimit dhe të parashikuara në legjislacion në 30-vjeçarin e fundit.</p>
<p>NËN-PYETJE 3: Cilat janë trendet e fundit të zhvillimeve në Tiranë në lidhje me ruajtjen dhe/apo zhvillimet e hapësirave natyrore dhe gjysëm natyrore?</p> <p>(Kapitulli 5)</p>	<p>OBJEKTIV-3.1: Të analizuarit e strategjive të propozuara të Planit të Përgjithshëm Vendor të Tiranës në këndvështrimin e ruajtjes dhe zhvillimit të hapësirave natyrore dhe gjysëm-natyrore.</p> <p>OBJEKTIV-3.2: Të analizuarit e aspekteve legjislative të lidhura me PPV-në në fuqi.</p> <p>OBJEKTIV-3.3: Analizë e shpejtë mes asaj që është planifikuar dhe zhvillimeve në territor për të kuptuar "trendin" real.</p>
<p>NËN-PYETJE 4: Referuar prezencës së hapësirave natyrore dhe gjysëm-natyrore, si qëndrojnë qasjet lokale në krahasim me qasjet e përgjithshme ndërkombëtare?</p> <p>(Kapitulli 6)</p>	<p>OBJEKTIV-4.1: Të kuptuarit e qasjeve, politikave dhe objektivave në shkallë globale si edhe të instrumentave ligjore në shkallë evropiane apo në një kontekst më të afërt.</p> <p>OBJEKTIV-4.2: Të kuptuarit e instrumentave apo hallkave të cilët sigurojnë zbatueshmërinë dhe sigurinë e cilësive përta të takon prezencës së hapësirave të gjelbra natyrore dhe gjysëm-natyrore.</p> <p>OBJEKTIV-4.3: Të kuptuarit e pozicionimit të qasjeve lokale në marrëdhënie me objektivat e vendosur në shkallë ndërkombëtare.</p>
<p>NËN-PYETJE 5: Referuar prezencës së hapësirave natyrore dhe gjysëm-natyrore, si qëndron qyteti i Tiranës i vendosur në një kontekst më të gjerë?</p> <p>(Kapitulli 7)</p>	<p>OBJEKTIV-5.1: Paralelizmi mes terminologjive të hasura mes legjislacioneve lokale dhe atyre ndërkombëtare. Përkufizime dhe definicione të termave teknike. Paralelizmi i termave përshkrimore për të mundësuar një krahasim sa më afër realitetit.</p> <p>OBJEKTIV-5.2: Vlerësimi në aspektin sasior dhe cilësor të zërave të paracaktuar, krahasimi mes modeleve të ndryshme.</p> <p>OBJEKTIV-5.3: Implementimi i metodologjive avangardë si përdorimi i CAD dhe GIS në analizim të këtyre të dhënave për rastin studimor të qytetit të Tiranës.</p>
<p>NËN-PYETJE 6: Çfarë potenciali ka struktura urbane e qytetit të Tiranës për të mundësuar implementimin në sasinë dhe cilësinë e duhur hapësirat natyrore dhe gjysëm-natyrore? Si do të mund të vlerësohet cilësia e zonave natyrore?</p> <p>(Kapitulli 8 dhe 9)</p>	<p>OBJEKTIV-6.1: Vlerësim dhe përzgjedhje e një zone potenciale të modehuar. Propozim i një metodologjie teorike të të analizuarit.</p> <p>OBJEKTIV-6.2: Skanim i qasjeve teorike në raste të ngjashme për të mundësuar vendosjen e më pas implementimin e objektivave.</p> <p>OBJEKTIV-6.3: Realizim i monitorimit për të vlerësuar shkallën e arritjes së objektivave.</p>

TABELA 1.6.1

Tabelë ilustruese e pyetjeve dhe objektivave të Kërkimit Shkencor
Përpunoi: Autori

- (v) **Konkluzione dhe Rekomandime** Përfitimet e këtij kërkimi; Mundësitë e plotësimit e vazhdimet të tij; Aspektet në të cilat do të mund të përdoret e thellohet si studim; Realizimi i rekomandimeve në aspekte planifikuese, monitoruese, standardizuese e projektuese, por dhe në aspektin e përmirësimit të aspekteve didaktike e programeve mësimore.

Është strukturuar në një formë të tillë pasi është vlerësuar si domosdoshmëri trajtimi në aspektin historik të qasjeve në qytetin e Tiranës, por dhe të kuptuarit dhe vlerësuarit të një konteksti më të gjerë sesa konteksti lokal. Pyetjet që lidhen me këtë të fundit, vlerësohen në Pjesën e Dytë të kërkimit.

1.8 Përshkrim i përgjithshëm i qasjeve teorike të landscape-it apo peizazhit natyror përgjatë historisë;

1.8.1 Përkufizime të Peizazhit

Por çfarë është peizazhi? Përpara se të ishte një profesion i lirë, një fushë akademike, apo një mjet projektimi, ka qenë një zhanër në fushën e pikturës, një motiv për artet teatrale, dhe një mënyrë e subjektivitetit njerëzor (Doherty, Gareth; Waldheim, Charles., 2016). Mes atyre që e përshkruajnë origjinën dhe shfaqjen e peizazhit, shquhet J.B. Jackson. Jackson e hapi veprën e tij kryesore të titulluar “Vetë Bota” në vitin 1984, duke përsëritur përkufizimin në fjalor të fjalës peizazh - “një pjesë e sipërfaqes së tokës e cila mund të perceptohet me një shikim”.

Është peizazhi një skenë të cilën ne e shohim, apo është një botë në të cilën jetojmë? Është peizazhi përreth nesh apo përballë nesh? A e observojmë, apo e jetojmë peizazhin? Në fakt asnjëra nuk e përjashton tjetrën, në fakt i bëjmë të dyja (Wylie, 2007).

Termi peizazh është hasur për herë të parë në pikturat e shekullit të 13-të. Peizazhi tradicionalisht ka qenë përkufizuar si një element estetik, i tillë si një shtrirje e një skenografie, apo si gjeografia e përgjithshme e një rajoni. Sipas Shoqatës së arkitekteve Amerikanë të landscape-it, projektuesit e peizazhit projektojnë ambientin e ndërtuar të lagjeve, qyteteve dhe metropoleve, ndërsa ruajnë dhe menaxhojnë mjedisin natyror, duke filluar nga pyjet dhe fushat, e deri tek lumenjtë dhe brigjet. Anëtarë të këtij profesioni kanë një angazhim për të përmirësuar cilësinë e jetës nëpërmjet projektimit më të mirë të vendit për njerëzit dhe për gjallesat e tjera (Rouse, 2013) (www.asla.org/nonmembers/What_is_Asla.cfm).

Shumë janë autorët të cilët kanë vënë theksin në rëndësinë e peizazhit natyror apo mënyrave të lidhjes së ndërsjellët të tij me një organizëm kompleks të tillë siç shfaqet qyteti. Në këtë studim do të preken disa prej autorëve kryesorë të cilët kanë vënë theksin në të konsideruarit të peizazhit nëpërmjet dhënies formë të qytetit. Problemi i një planifikuesi peizazhi nuk është më preferencë e një peizazhi të bërë nga njeriu apo peizazhi natyror, por është vendosja e kontrollit social dhe biologjik që do të siguronte mbijetesën, përdorimin, dhe vlerat e peizazhit si një burim jete. (Glikson, 1971).




TABELA 1.7.1

Tabelë ilustruese e Strukturës së Kërkimit Shkencor Përpunoi: Autori

Lind paraprakisht nevoja për të sqaruar disa terminologji duke filluar nga përkufizimi i termit “Peizazh” si një korrespondente e fjalës “landscape”. Referuar Konventës së Peizazheve, “Peizazh” do të thotë një sipërfaqe (zonë), ashtu sikurse perceptohet nga njerëzit, karakteri i së cilës është rezultat i veprimit dhe ndërveprimit të faktorëve natyrorë dhe/ose njerëzore. (Këshilli i Evropës, 2006) Thënë këtë, peizazhi mund të ketë karaktere të ndryshme në funksion të pozicionit se ku ndodhet. Ai mund të ketë karakter tërësisht natyror, gjysmë-natyror apo urban. Kjo temë disertacioni i referohet kryesisht peizazhit natyror të perceptuar në afërsi e brendësi të territorit të urbanizuar.




FIGURA 1.8.1

Zhvillimi i kërkimit mbi peizazhin;
Burimi: (Antrop, Marc, 2019)

1.8.2 Frederic Law Olmsted

Frederic Law Olmsted është një peizazhist amerikan i njohur dhe si babai i Arkitekturës së Peizazhit (Landscape Architecture) në SHBA, i njohur për projektimin e “Central Park” (1857), “Prospect Park” (1859) në New York, dhe më pas “Franklin Park” (1878) në Boston. Më shumë sesa projektues, ai njihet për prezantimin e parqeve si formë e hapësirës urbane në qytetin industrial dhe si dhe konceptit të ri të prezantuar mbi lidhjen e sistemit të parqeve dhe krijimit të një rrjeti të njohur si “Emerald Necklace” apo “Gjerdani Emerald”. Për herë të parë ky rrjet hapësirash dhe korridoresh lidhte rrjedha uji, bulevarde me një sipërfaqe më shumë se 400 Ha (apo 4 km²). Një fakt shumë i rëndësishëm për Frederic Law Olmsted është diskutimi i tij mbi ndryshimin e terminologjisë dhe titullit të profesionistëve të fushës, “Landscape Architect” dhe jo “Landscape Gardener” sikundër njihet deri në atë periudhë.




FIGURA 1.8.2.1 Skemë e sistemit të parqeve;
Burimi: (Waldheim, Landscape as Urbanism, 2016)

Shumë e rëndësishme është edhe në ditët e sotme teoria e lidhjes së hapësirave të gjelbra që në shkallë rajonale e deri në brendësi të qytetit. Tashmë kjo qasje është zhvilluar si teori dhe ka mbështetësit e vet e njihet si “Infrastruktura e Gjelbër” (Green Infrastructure) dhe përbën një prej golave kryesore për t’u arritur në vendet e zhvilluara, kryesisht Amerikë e Veriut dhe ato të Komunitet Evropian.

1.8.3 Ebenezer Howard

Howard njihet si frymëzuesi i qyteteve të kufizuara me brez të gjelbër. Në librin e tij “Qytetet Kopsht të së nesërme” (1902), Howard propozoi një alternativë bindëse në urbanizimin e pakontrolluar që po gllabëronte fshatrat angleze. Për të ndaluar shpërhapjen e pakontrolluar të qyteteve industriale, ai propozoi zëvendësimin e vargjeve të ndërtimeve me komunitete me përdorim miks me një shtrirje rreth 6,000 hektarë dhe me një popullsi rreth 32,000 banorë. Sipas këtij modeli, çdo qytet i ri do të duhet të ketë qendrat e veta të punës, lagjet e banimit, zonat e shërbimeve tregtare së bashku me zonat industriale por dhe territorin agrikorik i cili do të duhej të rezervohet përreth zonës urbane. Ky i fundit, jo vetëm do të mund të pengonte

dhe shtrirja e fshatit në drejtim të qytetit. Si një element që përcakton shkallën e higjienës dhe që është utilitare, do të duhej që natyra të çohet në drejtim të banorëve. Sipas tij, qytetet do të duhej të përsërisnin formën e yllit apo të lules, një formë për t'u alternuar me linjat e transportit hekurudhor të cilat realizonin lidhjen mes qendrës së qytetit dhe fshatit.




FIGURA 1.8.4.1 Qyteti - Fshati; Fshati - Qyteti
Burimi: Geddes, 2015 (De Oliveira, 2017)

Geddes njihet për artikujt, raportet, e leksionet e shumta, ka marrë pjesë në hartimin e planeve në Qipro, Tel Aviv, Montpellier, Edinburg, Indi, pjesërisht të realizuar, por roli i tij kryesor do të konsiderohet përcaktimi i perkufizimeve të elementeve të planifikimit duke përcaktuar kështu edhe një prej themeluesve të Planifikimit Rajonal.

1.8.5 Kevin Lynch

Në librin e tij “Menaxhimi i ndjenjës (ndjesisë) së një rajoni”, Lynch flet për marrëdhënien mes njeriut dhe mjedisit dhe lëvizjen e balancave mes tyre shkaktuar prej species humane. Ai vendos theksin pikërisht në cilësinë e një vendi bazuar në balancën mes elementëve natyrorë, por dhe kënaqësisë që perceptohet. Vetë njeriu është një pjesë e natyrës dhe qytetet janë po aq natyrore sa edhe fushat. Ne, në mënyrë të paevitueshme prishim rregullin ekologjik të një vendndodhje. Ne nuk mund të ruajmë një balancë që ka ekzistuar më parë, megjithëse me raste, me zhdukjen e saj ndërhyjmë për ta ri-sjellë deri në një farë shkalle. Më shpesh ne përpiqemi të krijojmë një balancë të re, po aq të qëndrueshme sa ajo e mëparshme, por të përshtatur më shumë me nevojat tona. Specie të ndryshme, të cilat kapin energjinë e diellit, kërkojnë dhe varen prej tij, ekzistojnë në një balancë të mirë mes ujit, ajrit dhe tokës. Mbi këtë sistem varet dhe mbijetesa jonë. Balanca dhe stabiliteti i këtyre elementeve, janë tregues thelbësorë të cilësisë së një vendi. (Lynch, Managing the Sence of a Region, 1976)

Mesazhet e shumta të një mjedisi, ndikojnë në përmbushjen, njohjen, zhvillimin tonë, por dhe në kënaqësinë emocionale dhe atë estetike. (Lynch, Managing the Sence of a Region, 1976)

1.8.6 Christopher Alexander

Shtirirja e vazhdueshme e urbanizimit shkatërron jetën dhe bën qytetet e padurueshme, por dhe dimensionin shumë të madh i qyteteve është gjithashtu i vlefshëm dhe i fuqishëm. (Alexander, 1977).




FIGURA 1.8.6.1 Modeli i zhvillimit të qytetit sipas C. Alexander; Burimi: (Alexander, 1977)

Sipas tij njerëzit ndihen mirë kur kanë kontakt të vazhdueshëm me fshatin, fushat e hapura apo qasen ndaj bimësisë, shpendëve apo kafshëve të egra. E për të realizuar këtë, qytetet duhet të kufizohen me fshatrat pothuaj në çdo pikë të tyre. Në të njëjtën kohë, qyteti ofron një jetë të mirë vetëm kur ofron një densitet ndërveprimesh mes njerëzve dhe punës si dhe mënyra të ndryshme jetese. Për të siguruar këtë lloj ndërveprimi, qyteti sipas Aleksander, duhet të jetë i vazhduar, jo i ndërprerë. Në këtë strukturë të tij, duhet që këto dy fakte të sillen në formë të balancuar.

Duhet ndërthurur gishtat e tokës së punueshme dhe tokës urbane dhe në qendër të një metropoli. Gishtat urbanë nuk duhet të jenë asnjëherë më shumë se 1 milje të gjerë, ndërsa gishtat e tokave bujqësore nuk duhet të jenë asnjëherë me pak se 1 milje të gjera (Alexander, 1977).




FIGURA 1.8.6.1 Modeli i krijimit të hapësirave të gjelbra në qytet sipas C. Alexander; Burimi: (Alexander, 1977)

Njerëzit kanë nevojë për të vizituar vende të hapura të gjelbra, e kur janë afër tyre të kenë mundësi t'i përdorin. Por kur gjelbërimi është më larg se sa tre minuta, distanca e mbyl praktikisht nevojën. (Alexander, 1977). Ndërto një zonë të gjelbër publike të hapur tre minuta larg rreth 750 këmbë (228.6 metra) nga çdo shtëpi dhe çdo vend pune. Kjo do të thotë që gjelbërimi do të duhet të jetë i shpërndarë në mënyrë uniforme në intervale prej 1,500 këmbësh (457.2 metrash) në të gjithë qytetin. Krijoh hapësira të gjelbra me gjerësi të paktën 45m dhe me një sipërfaqe të paktën 5,500 m² (0.55 Ha) (Alexander, 1977).

1.8.7 Ian McHarg

Në librin “Të projektosh me natyrën” (1969), Ian McHarg ka vendosur një proces natyror si bazë për të limituar ndikimin e zhvillimeve urbane në burimet natyrore, gjithashtu ai i hap rrugë të ashtuquajturës metodë e mbivendosjes apo e krijimit “shtresave të tortës” mbi analizimin e peizazhit për të përcaktuar përshtatshmërinë e tij për zhvillim. Kjo metodë fillon me mbivendosje të hartave të faktorëve të ndryshëm ekologjikë duke përfshirë klimën, gjeologjinë, hidrogjeologjinë, dherat, vegjetacionin dhe jetën e egër. Një analizë e përshtatshme e bazuar në sintezën e këtyre faktorëve kryhet për të evidentuar aftësinë e territorit për të qëndruar ndaj ndikimit të zhvillimit mbi këto burime të vlefshme natyrore. McHarg në thelb, vendosi nocionin e të ashtuquajturave “shërbimeve ekologjike” (Ecological Services) – që do të thotë që natyra ka një vlerë të menjëhershëm dhe të matshme në mirëqenien e njeriut, duke siguruar përfitime si cilësia e ajrit, cilësia e ujit dhe furnizimi i tij, ruajtja e dherave (tokës) dhe ruajtja e botës së egër. Në mënyrë optimale gjithsecili do të dëshironte dy sisteme brenda një rajoni metropolitan - Një strukturë të proceseve natyrore të ruajtura në hapësirën e hapur dhe tjetra do të ishte struktura e zhvillimit urban. Vetëm një ndërthurje e të dyjave, do të kënaqte sigurimin e hapësirës së hapur për popullatën. (De Oliveira, 2017)

1.8.8 Përmbledhje e qasjeve teorike përgjatë historisë

Në formë të përmbledhur mund të themi se që me lindjen e qytetit industrial, ka pasur një vëmendje të shtuar ndaj treguesve si (1) Dimensioni i qytetit dhe shtrirja e tij; (2) Prezenca e hapësirave të hapura të gjelbra në afërsi të zonave të banuara; (3) Këto të jenë të baraslarguara (C. Alexander); (4) Tendanca për të pasur hapësira të gjelbra të bollshme të lidhura mes tyre. Të gjitha sa më sipër kanë çuar në propozime të modeleve të formave të zhvillimit të qyteteve nga disa autorë (E. Howard; P. Geddes; C. Alexander; etj.), ose në metodologji dhe rekomandime të procesit të planifikimit dhe të projektimit (I. McHarg). Probleme të ngjashme me ato të shfaqura me revolucionin industrial, ekzistojnë edhe sot me të gjithë zhvillimet demografike që po ndodhin në shkallë globale. Një seri teorish bashkëkohore janë krijuar e zhvilluar sot, të cilat shtrihen përtej territorit urban dhe jo vetëm, tentojnë të vlerësojnë e konservojnë territoret natyrore, të normëzojnë qendrat urbane nisur nga qasjet e landscape-it apo peizazhit natyror.

1.9 Përshkrim i përgjithshëm i qasjeve teorike sot

1.9.1 Infrastruktura e Gjelbër apo “Green Infrastructure”

“Infrastruktura e Gjelbër” është një qasje e cila mbështetet në krijimin e rrjeteve të vazhduara të një seri hapësirash të hapura dhe korridoresh, të cilat mundësojnë përfitime si ekocentrike ashtu edhe antropocentrike. Është një qasje e cila tenton të zhvillohet e realizohet si në shkallë kontinentale, si në atë rajonale ashtu edhe në atë lokale. Duke përdorur informacion që rrjedh nga ekologjia urbane si edhe nga kërkimet shkencore të ekosistemeve, planifikuesit dhe projektuesit do të mund të përzgjedhin një sërë politikash dhe praktikash të cilat ndihmojnë vlerat ekocentrike dhe antropocentrike në shkallë të ndryshme në sistemet e infrastrukturës së gjelbër. Si një sistem sistematik, qasje gjithëpërfshirëse (holistike), duke përfshirë kooperim ndër-disiplinor, infrastruktura e gjelbër adreson tema si ndotjet, habitat-et, rekreacionin, hapësirën e hapur dhe formën urbane. (Austin, 2014)

1.9.2 Ekologjia e Peizazhit Natyror apo “Landscape Ecology”

Në librin “Principet e arkitekturës së peizazhit dhe planifikimit të territorit”, “Ekologjia e Peizazhit Natyror” përshkruhet si një fushë principet e së cilës do të mund të aplikohen në çdo mozaik të territorit, duke filluar nga territoret suburbane, në ato të agrikulturës, në shkretëtira apo edhe pyje. Këto përmbajnë organizma të gjallë, si rrjedhim përbëjnë një sistem të jetueshëm (Dramstad, Wenche E; Olson, James D; Forman, Richard T.T, 1996). “Ekologjia e Peizazhit Natyror” si qasje bazohet në (1) Strukturën e peizazhit; që do të thotë tekstura apo rregulli i elementëve të peizazhit; Kjo strukturë do të mund të marrë formën e (1.a) Njollës; (1.b) Korridorit; (1.c) Matricës; Këto struktura krijojnë morfologji hapësinore e qëndrojnë të lidhura ngushtë me aspektin tjetër (2) Atë funksional i cili lidhet me lëvizjet, duke përfshirë ato të kafshëve, bimëve, ujit, erës, materialeve, energjisë nëpërmjet strukturës; dhe (3) Ndryshimeve të strukturës, teksturës apo funksionimit në kohë. Në mënyrë hipotetike mendohet se për çdo peizazh, apo çdo zonë të madhe peizazhi, ekziston një rregull hapësinor i ekosistemeve dhe përdorimit të tokës për të maksimizuar integritetin ekologjik. E njëjta gjë është e vërtetë për të arritur nevojat bazë njerëzore dhe për të krijuar një mjedis të qëndrueshëm. Nëse është kështu, sfida me e madhe, por e arritshme është zbulimi i kësaj marrëveshjeje (Dramstad, Wenche E; Olson, James D; Forman, Richard T.T, 1996).

1.9.3 Peizazhi Natyror si Urbanizim apo “Landscape as Urbanism”

Kjo teori ka udhëhequr në një metodë të re, të integruar të aspektit praktik në të cilin planifikimi dhe projektimi lidhen dhe mbivendosen, këtu kufijtë ndërdisiplinorë mjugullohen. Një shembull fillestar është “Peizazhi Natyror si Urbanizim” (Landscape as Urbanism) i cili e vendos peizazhin në themel të zhvillimeve urbane të gjithë shkallëve të ndërhyrjes, nga shkalla makro (p.sh. përmytjet, rrugët e gjelbra, parqet) deri në shkallë mikro (p.sh. strukturat (patterns) dhe karakteret e blloqeve, rrugëve dhe hapësirave publike). (Rouse, 2013).

1.9.4 Urbanizmi i Ri apo “New Urbanism”

“New Urbanism” është një lëvizje e cila bazohet në ndërtimin e qyteteve duke u kthyer në metodat tradicionale. Është modeli i zhvillimit që sigurisht ka kundërshtarët e vet, por që në masë të madhe shumë qytete janë duke aplikuar dhe mbështetur disa strategji të kësaj lëvizjeje në zhvillimit territorial të tyre.

1.9.5 Përmbledhje e qasjeve teorike sot

Në përmbledhje të qasjeve teorike sot mund të themi se shumica e literaturës së hasur mbi planifikimin territorial, duke filluar nga viti 1990 e tutje, fokusohet në zhvillimin e qytetit kompakt i cili përfaqëson një koncept projektimi të implementimit të zhvillimit të qëndrueshëm brenda mjedisit urban me qëllim kundërshtimin e ndikimeve negative sociale, ekonomike dhe mjedisore të shpërhapjes urbane. Ka pasur shumë përpjekje për të përcaktuar çfarë saktësisht është një qytet kompakt, por në përgjithësi do të thotë një qytet (a) me densitet relativisht të lartë; (b) me përdorim të përzier (miks) të tokës; (c) bazuar në një transport publik efikas; por dhe (d) dimensione të tilla që inkurajojnë të ecjen (në këmbë) dhe pedalimin (e biçikletave) (Burton, 2000:1970).

Plani i Përgjithshëm Vendor i Tiranës i konceptuar nga studio Stefano Boeri Architects, prezantoi tre skenarë të zhvillimit të qytetit të Tiranës: (1) Zhvillimin e qytetit Linear; (2) Rritjen Koncentrike dhe (3) Rritjen e densitetit brenda së njëjtës gjurmë zhvillimi. Ky i fundit është dhe skenari final i përzgjedhur për zhvillimin e Tiranës deri në vitin 2030, skenar i cili shoqërohet edhe me një zonë urbane më të dendur e cila do të akomodojë popullsinë në rritje të kryeqytetit. Praktikisht është model që është në analogji me nivelet teorike të zhvillimit të një qytetit kompakt.

1.10 Modelimi Teorik

I gjithë diskutimi mbi qëndrimet e ndryshme të autorëve dhe personaliteteve të ndryshëm përgjatë periudhave të historisë, nuk ka për qëllim vetëm informimin mbi zhvillimet në fushën e peizazhit. Në thelb qëllimi është i prezantimit të transformimit të mendimit në fushën e peizazhit, kjo edhe në funksion të transformimeve të ndryshme sociale, ekonomike, demografike, e tashmë në shekujt e fundit dhe mjedisore. Pavarësisht këtyre transformimeve, ajo që ngelet në thelb e njëjtë, është qëndrimi në marrëdhënie me prezencën e peizazhit natyror në afërsi të banorëve të qyteteve, thënë këtë, në të gjitha rastet zhvillimi urban do të duhet të zhvillohet paralelisht së bashku me peizazhin natyror. Sipas (Pötz & Bleuzé, 2022) në librin e tyre “Urban Green - Blue Grids”, modelet e formave të gjelbra dhe blu të cilët përfaqësojnë këtë marrëdhënie mes sistemeve urbane dhe sistemeve natyrore të gjelbra dhe blu, shprehen nëpërmjet skemave të mëposhtme, treguar në (FIGURA 19.1). Në mënyrë të përmbledhur mund të përshkruajmë se skema: (i) ilustron modelin e hapësirave të gjelbra në brendësi të pëlhurës urbane të qytetit; (ii) ilustron modelin e brezit të gjelbër rrotull qytetit; (iii) përfaqëson modelin e pykave (wedges) apo copave (slabs) të gjelbra; dhe (iv) përfaqëson modelin e rrjetit të gjelbër dhe blu. Sigurisht aplikimi i këtyre modeleve lidhet shumë me gjeografinë e territorit mbi të cilin shtrihet zhvillimi urban.

Kanë qenë pikërisht studimi i këtyre autorëve dhe i qasjeve teorike sot mbi të cilat është përcaktuar matrica e elementeve fillestarë të vlerësimit mbi bazën e të cilëve është ndërtuar dhe gjithë metodologjia e këtij kërkimi.




FIGURA 1.9.6.1 Modele të zhvillimit të zonave të gjelbra në qytete
Burimi: (Pötz & Bleuzé, 2022)

Arkitektura e Peizazhit është një profesion kyç për një botë e cila përballet me një të panjohur mjedisore. Megjithatë, ajo pengohet nga një krize kronike identiteti. Ajo së pari ka të bëjë me krijimin e vendeve të bukura, por dhe ndihmon njerëzit duke shpëtuar planetin nga katastrofat ekologjike (Thomson, 2005). Do të duhet të theksojmë se fusha e studimit të Peizazhit Natyror paraqitet relativisht komplekse sot, ku ka ndërthurje të gjeografisë, gjeologjisë, planifikimit, projektimit, ekologjisë, perceptimit, etj., të gjitha të ndërthurura me aspekte sociale dhe ekonomike.

Do të duhet të theksojmë se ky studim nuk merr përsipër kthimin e të gjitha përgjigjeve, thënë këtë ai përqendrohet në terma sasiorë dhe ato fillestarë për sa i takon përcaktimit të cilësisë.

Nëse i referohemi ilustrimit të mëposhtëm, do të duhet të nënvizojmë se trajtimi në këtë punë kërkimore shtrihet kryesisht në terma të Ekologjisë dhe Komunitetit.




FIGURA 1.9.6.2 Mbivendosja e vlerave në peizazh
Burimi: (Thomson, 2005)

.....

Pjesa e Parë – Politikë-bërja dhe krahasimi me modele ndërkombëtare

.....

2. Panoramë e përgjithshme e Organizmave dhe Politikë-Bërjes në Zhvillimin e Qëndrueshëm

Për një kuptueshmëri më të madhe të rëndësisë që zhvillimi i qëndrueshëm ka në shkallë globale do të rendisim shumë shkurt disa prej organizatave, politike-bërjes dhe vendimmarrjeve të tyre.

2.1 OKB dhe planet e veprimit në nivel global

Organizata e Kombeve të Bashkuara (më tej do të përdoret akronimi OKB), është një organizatë ndërkombëtare e themeluar në 1945, e që momentalisht përbëhet nga 193 vende anëtare. OKB është një organizatë që prej periudhës së pas-luftës së dytë botërore trajton çështje të cilat shqetësojnë njerëzimin (www.un.org). Shqipëria është një prej vendeve anëtare në OKB që prej datës 14 Dhjetor, 1955 (www.un.org).

FAO	Tokë agrikulurore
WHO	Shëndeti i banorëve Ndotja e ajrit Hapësirat e gjelbra në zonat urbane
UN	
UNESCO	
UN-HABITAT	
WMO	Ndryshimi i Klimës
WTO	Turizmi

TABELA 2.1.1 Tabelë treguese e agjencive të KB dhe disa prej fushave që ato mbulojnë
Burimi: www.un.org
Përpunoi: Autori

Zhvillimi i qëndrueshëm dhe promovimi i tij është një prej çështjeve kryesore prej dekadash në agjendën e OKB-së, sigurisht duke pësuar transformime në qasje bazuar edhe në problematikat e momentit apo mënyrës së trajtimit të çështjeve. Për observimin e çështjeve të ndryshme janë ngritur një sërë agjencish në shkallë ndërkombëtare. Agjencitë mbulojnë çështje të ndryshme, por ato të cilat në mënyrë direkt janë të lidhura me zhvillimin e qëndrueshëm në përgjithësi dhe temën të cilën po trajtojmë në veçanti, janë si më poshtë (TABELA 2.1.1) (www.un.org):

2.2 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) apo “Sustainable Development Goals” (SDG)

Prej dekadash tashmë kryefjala sidomos në fushën e planifikimit territorial është “Zhvillimi i Qëndrueshëm” (ZHQ). Shtyllat e ZHQ janë: (1) Aspekti Mjedisor; (2) Aspekti Social; (3) Aspekti Ekonomik. Në shkallë globale janë zhvilluar prej dekadash një numër shumë i lartë aktivitetesh, samitësh, konferencash për shqyrtim të problematikave mjedisore në shkallë globale. Në figurën më poshtë (FIGURA 2.2.1) ilustrohen grafikisht të gjithë vendet pjesëmarrëse të cilët i janë bashkuar marrëveshjes kryesore mbi bazë të së cilës po vijohet me të gjitha politikat në lidhje me ZHQ. Siç edhe mund të kuptohet, të gjitha vendet, përfshirë Shqipërinë janë pjesë e kësaj marrëveshjeje dhe duhet të respektojnë vendimmarrjet dhe agjendën e rënë dakord. Kjo agjendë e bazuar në tre shtyllat e përmendura më sipër, ka përcaktuar 17 “gola” (GOALS) apo “target” kryesorë mbi të cilët do të mbështeten të gjitha sferat e zhvillimit në nivel ndërkombëtar duke përcaktuar në këtë mënyre dhe agjendën deri në vitin 2030. Të shprehur grafikisht në (FIGURA 2.2.3) ato janë si me poshtë (www.un.org):




FIGURA 2.2.1 Hartë e vendeve të UN që janë pjesë e marrëveshjes së Parisit, 2015
Burimi: (www.statista.com)

- GOAL 01** Përfundimi i varfërisë të së gjitha formave gjithandej në botë;
- GOAL 02** Përfundimi i urisë, sigurimi i ushqimit dhe përmirësimi i tij; Promovimi i agrikulturës së qëndrueshme;
- GOAL 03** Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i të qenit mirë në të gjithë grup-moshat;

- GOAL 04** Sigurimi i arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës, si dhe promovimi i mundësisë për të mësuar gjatë gjithë jetës;
- GOAL 05** Arritja e barazisë mes gjinive dhe fuqizimi i grave dhe i vajzave;
- GOAL 06** Mundësia e sigurimit i të ujit; menaxhimi i qëndrueshëm i ujit dhe sigurimi i kanalizimeve për të gjithë;
- GOAL 07** Qasja e të gjithëve ndaj energjive të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne;
- GOAL 08** Promovimi i rritjes së qëndrueshme e gjithëpërfshirëse ekonomike, punësim i plotë dhe produktiv si edhe punësim i denjë për të gjithë;
- GOAL 09** Të ndërtojë infrastrukturë fleksibël, të promovojë industrializim gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe të kujdeset për inovacionin;
- GOAL 10** Të reduktojë pabarazinë brenda dhe mes vendeve të ndryshme;
- GOAL 11** Të bërit e qyteteve dhe vendbanimeve të njerëzve gjithëpërfshirëse, të sigurta, fleksibël dhe elastike;
- GOAL 12** Sigurimi i modeleve të qëndrueshëm të konsumimit dhe prodhimit;
- GOAL 13** Marrja e masave urgjente për të luftuar ndryshimin e klimës dhe ndikimeve që ajo ka;
- GOAL 14** Konservimi dhe qëndrueshmëria e oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillimin e qëndrueshëm;
- GOAL 15** Të mbrojturit, të rivendosurit dhe promovimi i përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve territoriale, menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve, luftimit të shkretëtirëzimit dhe ndalimi i kthimit të tokës në të degraduar, si dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit;
- GOAL 16** Promovimi i shoqërive të paqeta dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, të siguruarit e qasjes ndaj së drejtës për të gjithë dhe të ndërtuarit e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet;
- GOAL 17** Fuqizimi i mënyrave të implementimit dhe rivitalizimit të partneritetit Global për Zhvillimin e Qëndrueshëm;

Për të vlerësuar e monitoruar ecurinë dhe arritjet, janë përcaktuar një seri treguesish të cilët do të ndihmojnë qoftë në përcaktimin e objektivave të qarta, në vlerësim të tyre, por dhe në krahasim e në këtë mënyrë të mos pasurit vend të interpretimeve e thënë këtë, vlerësimet të jene objektive dhe jo subjektive. Lista e agjendës deri në vitin 2030 përmban një total prej 241 treguesish, ku raportet mes aspektit mjedisor, atij ekonomik dhe social janë si në figurën më poshtë (FIGURA 2.2.2).

Kjo temë disertacioni, duke qenë se ka fokus kryesor mjediset natyrore dhe gjysmë natyrore, është në mënyrë të drejtpërdrejtë e lidhur me realizimin e disa prej golave (FIGURA 2.2.4), kryesisht atyre të lidhur me shëndetin e njerëzve (GOAL.3); me qytetet dhe vendbanimet (GOAL.11); me luftën ndaj ndryshimeve klimaterike (GOAL.13); me ruajtjen e ekosistemeve dhe resurseve të territorit; por tematikat që do të trajtohen nuk mbeten të kufizuara vetëm në këtë aspekt. Zhvillimi i qëndrueshëm i agrikulturës (GOAL.2), qëndrueshmëria e ujërave (GOAL.6), arsimit cilësor (GOAL.4), ekonomia e qëndrueshme (GOAL.8), qasja nga të gjithë ndaj energjive të pastra (GOAL.7),

promovimi i shoqërive të paqeta (GOAL.16), por ndoshta edhe më tepër, janë të përfshirë në mënyrë indirekte me atë çfarë kjo teze disertacioni ka për qëllim të arrijë.



FIGURA 2.2.2 17 Golat kryesorë të ZHQ të marrëveshjes së Parisit, 2015
Burimi: (www.un.org)



FIGURA 2.2.3 4 Golat kryesorë të marrëveshjes së Parisit, 2015, ku fusha e “landscape” apo peizazhit natyror është e përfshirë;
Burimi: (www.un.org)




FIGURA 2.2.4 Paraqitje e tre shtyllave të ZHQ dhe klasifikimit të Golave sipas tyre, 2015
Burimi: (www.un.org)

2.2.1 GOAL 11; Qytetet e qëndrueshme dhe elastikë

Në rolin e projektuesve, ne, arkitektët dhe planifikuesit urbanë do të duhet të konsiderojmë GOAL 11 si golin kryesor mbi të cilin do të duhet të zhvillohen qytetet dhe qendrat e banuara. Sipas këtij goli, qendrat e banuara dhe qytetet do të duhet të jenë gjithëpërfshirëse, të sigurta, elastike dhe të qëndrueshme. Ato duhet të ofrojnë një jetë cilësore për të gjithë banorët, pavarësisht nga statusi i tyre social dhe ekonomik. Sigurisht qyteti është një organizëm shumë kompleks, thënë këtë janë shumë shtresat të cilat do të duhet të konsiderohen. Siç është përmendur edhe më sipër, kjo tezë disertacioni nuk merr përsipër të prekë të gjitha çështjet, por përpiqet të hedhë dritë e të theksojë rëndësinë e atyre të cilat lidhen dhe kanë një dimension natyror dhe gjysmë-natyror. Sipas marrëveshjes së Parisit, qytetet do të duhet të bëhen gjithëpërfshirës, të sigurt, elastik dhe të qëndrueshëm. Me konkretisht sipas “target” 11.7, deri në vitin 2030 qytetet do të duhet të sigurojnë qasje (akses) në hapësirat e gjelbra dhe publike, të cilat do të duhet të jenë të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të arritshme, sidomos për gratë dhe fëmijët, moshat e treta dhe personat me aftësi të kufizuara. Për të bërë të mundur vlerësimin e njëjtë nga të gjithë të treguesve të cilët janë përcaktuar si ilustrues të përmbushjeve (performancave) periodike, organizata apo federata të ndryshme kanë përcaktuar mënyra të unifikuara të këtyre vlerësimeve. Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin (ONS) është një prej tyre.

2.2.2 ISO 37120; ISO 37122 dhe ISO 37123

(ONS) apo “International Organization for Standardization” (ISO) është një federatë mbarë botërore e grupeve të standardeve kombëtare e cila harton standarde. Në lidhje

me OZHQ, konkretisht GOAL 11, kjo federatë ka hartuar një seri standardesh ISO të cilët përcaktojnë mënyrën e matjes së një serie treguesish (indikatorësh) të cilët vijnë në ndihmë për të matur, vlerësuar nëpërmjet treguesve efikasitetin apo performancën e qyteteve në mënyrë që ajo të jetë e matshme në gjithë vendet njësoj, e thënë këtë, të mund të jetë e krahasueshme. Për sa i takon ZHQ, klasifikimi i standardeve dhe ndërlidhja mes tyre bëhet sikundër tregohet në figure (TABELA 2.2.5) ku:




TABELA 2.2.2.1 Zhvillimi i qëndrueshëm i komuniteteve - Marrëdhënia mes familjeve të standardeve mbi treguesit
Burimi: (ISO, Sustainable cities and communities - Indicators for city services and quality of life, 2018)
Përpunoi: Autori

ISO 37120 - Përmban indikatorë të Qytetit të shërbimeve dhe cilësisë së jetës në qytet

ISO 37122 - Përmban indikatorë të Qyteteve të Zgjuara (Smart City)

ISO 37123 - Përmban indikatorë të Qytetit Elastik (Resilient)

Një qytet elastik, është një qytet që është në gjendje të adaptohet me katastrofa dhe strese natyrore të tilla si, tërmete, përmytje, uragane, pandemi, po aq sa dhe të adaptohet me strese të shkaktuara nga raca njerëzore, të tilla si degradimi mjedisor, pabarazia sociale, apo mungesa e stabilitetit ekonomik të cilat shkaktojnë ndikim negativ në një qytet. Një qytet elastik duhet të mund të rikuperohet në kohë dhe mënyrë efikase. Fleksibiliteti e bën një qytet të tentojë të ecë drejt modelit të qytetit të qëndrueshëm.

Në tabelat përkatësisht (TABELA 2.2.2.1) dhe (TABELA 2.2.2.2) ilustron një skanim i realizuar i të gjithë treguesve të cilët lidhen me mënyrën se si planifikohet qyteti, e në veçanti këta tregues lidhen me indikatorë që përcaktojnë dhënien e dimensionit të elementeve natyrore dhe gjysmë-natyrore në brendësi e në perimetër të tij. Thënë sa më sipër, për të siguruar një qytet të jetueshëm do të duhet që shumë nga problematikat që lidhen me ndotjet e ajrit, ndotjet akustike, etj., mund të adresohen e zgjidhen nëpërmjet prezencës së vegjetacionit në një pëlhurë urbane. Prezenca e hapësirave të rekreacionit, apo impianteve sportive gjithashtu të domosdoshme në sigurimin e jetueshmërisë, janë të lidhura sërish me prezencën ose jo të hapësirave urbane me

karakter natyror. Të dhëna të tjera të rëndësishme në pikëpamje të konsiderimit nga planifikuesit urbanë, rezultojnë të jenë marrëdhëniet e ndërsjella mes dendësisë (së ndërtimit) dhe numrit të pemëve.

Gjatë zhvillimit të analizave të cilat do të vijojnë këtë kërkim, do të mund të vlerësojmë disa prej tyre për të kuptuar e ilustruar metodologjinë e punës. Nuk është qëllimi kryesor i kësaj teze doktorate vlerësimi i indikatorëve. Ky është një vlerësim të cilët do të duhet ta kryejnë aktoret e institucioneve, si bashkitë e qyteteve apo të tjerë aktorë, por është qëllimi i zhvillimit të kësaj teze, theksimi i rëndësisë që ka që në proceset e planifikimit të qytetit të qëndrueshëm e jetueshëm, të konsideruarit e sistemeve natyrore dhe gjysmë-natyrore në proceset planifikuese.

Një prej indikatorëve kryesorë në procesin e planifikimit urban është - Sipërfaqe e Gjelbër (në Ha) për 100,000 banorë, ku me “Sipërfaqe të Gjelbër” do të kuptohen sipërfaqet e mbuluara me vegjetacion dhe/apo sipërfaqet natyrale në brendësi të pëlhurës urbane të qytetit. Këto sipërfaqe do të duhet të përfshijnë edhe sipërfaqe të tarracave të gjelbra, si dhe hapësirat e gjelbra urbane publike dhe ato private. Thënë këtë, jo vetëm sipërfaqet e gjelbra rekreative.

Siç është përmendur më sipër, ky indikator llogaritet si Hektarë Hapësirë e Gjelbër Urbane për 100,000 banorë. Nuk ka një tregues apo rekomandim në standardet ISO se sa duhet të jetë kjo vlerë, por përcaktohet metodologjia e përlllogaritjes e cila do të duhet të jetë e njëjtë në gjithë qytetet, performanca e të cilëve do të vihet në garë.

Të gjithë qytetet në vendet e zhvilluara të KE vlerësojnë një seri indikatorësh për t'u krahasuar ndër vetë, e për të treguar cilësinë e jetës që ato ofrojnë duke u bërë më atraktive, qoftë për banorët e përhershëm, qoftë për ata të përkohshëm (vizitorët apo turistët). Në njërin prej vendeve tona fqinje, Itali, në një prej formave të mundshme, performanca e qyteteve përcaktohet nga indikatorët e mëposhtëm:

Performanca Ambientale e Qyteteve (Itali):

(Legambiente; Ambiente Italia; Il Sole 24 Ore, 2019)

- | | | |
|-----|------------------|---|
| 1. | Cilësia e Ajrit: | Bioksidi i Azotit (NO ₂); |
| 2. | Cilësia e Ajrit: | Ozoni (O ₃); |
| 3. | Cilësia e Ajrit: | Pluhura të Hollë (PM _{2,5}); |
| 4. | Cilësia e Ajrit: | Pluhura të Hollë (PM ₁₀); |
| 5. | Zhurma: | Zonifikimi Akustik; |
| 6. | Zhurmat: | Deklarimet apo Raportet e Qytetarëve; |
| 7. | Klima: | Objektivi i Reduktimit të CO ₂ ; |
| 8. | Uji: | Konsumi Hidrik Shtëpiak; |
| 9. | Uji: | Humbjet në Rrjet; |
| 10. | Uji: | Kapacitete të Pastrimit; |
| 11. | Uji: | Mungesa Hidrike (Mungesa e Ujit); |
| 12. | Mbetjet: | Prodhimi i mbetjeve Urbane; |

- | | | |
|-----|--------------------------|--|
| 13. | Mbetjet: | Mbledhja e Diferencuar; |
| 14. | Mbetjet: | Portë me Portë; |
| 15. | Mobiliteti: | Pasagjere të transportit publik; |
| 16. | Mobiliteti: | Oferta e Transportit Publik; |
| 17. | Mobiliteti: | Viktima në rrugë; |
| 18. | Mobiliteti: | Shtigje ekuivalente të çiklizmit; |
| 19. | Mobiliteti: | Rrugë për Biçikleta; |
| 20. | Mobiliteti: | Shkalla e motorizimit me Auto; |
| 21. | Mobiliteti: | Shkalla e motorizimit me Motor; |
| 22. | Mobiliteti: | Ndarje e Makinave; |
| 23. | Mobilitet: | Ndarja e Biçikletave; |
| 24. | Mjedisi Urban: | Ishuj Këmbësorë; |
| 25. | Mjedisi Urban: | Pemë në Qytet; |
| 26. | Mjedisi Urban: | Gjelbërim i përdorshëm; |
| 27. | Energji të rinovueshme: | Panel diellor termik dhe fotovoltaik publik; |
| 28. | Përdorim efikas i tokës; | |

2.2.3 Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) apo World Health Organization (WHO)

OBSH është një prej shume agjencive të Kombeve të Bashkuara me gol kryesor promovimin dhe ruajtjen e shëndetit të popullatës. Ka një numër te madh temash si (1) Ndotja e Ajrit; (2) Pandemitë; (3) Fatkeqësitë natyrore, etj., të cilat lidhin në mënyrë të drejtpërdrejtë shëndetin e njeriut me planifikimin apo zhvillimin urban të qyteteve, shumë nga të cilat më pas lidhen me mënyrën e planifikimit të sistemeve natyrore. Për këtë arsye OBSH realizon një seri studimesh dhe rekomandimesh në nivel global një pjesë e së cilave lidhen me Hapësirat e Gjelbra Urbane, avantazhet dhe përfitimet që ato kanë në jetën e njeriut dhe se si do të duhet të projektohen. Janë disa materiale, produkte të OBSH të cilat kanë shërbyer si referencë në këtë punim e që do të citohen më poshtë.

2.3 Qasje përgjatë historisë të Komunitetit Evropian; Politika të Komuniteti Evropian (KE) në ditët e sotme

Vendet evropiane, si vende udhërrëfyese apo “leader” në zhvillimin e qëndrueshëm kanë ndërmarrë një seri politikash bazuar në marrëveshjet në shkallë ndërkombëtare, por shpesh kanë qenë dhe nxitëse në krijimin e këtyre politikave. Në vijim të shumë “event-eve” dhe ngjarjeve në shkallë globale, Evropa ka ndërmarrë një seri aktivitete për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm në kontekstin evropian. Këto aktivitete janë zhvilluar dhe zhvillohen në nivele qeverish apo në nivele lokale. Kështu duke filluar nga viti 1994, në vazhdim të COP Rio 1992 janë zhvilluar konferencat mbi

TEMA	TREGUES KRYESORË	TREGUES MBËSHTETËS	TREGUES PROFILI
Ekonomi			
Edukim			
Energji			
Mjedisi dhe Ndryshimet Klimaterike	Përqendrimi i Ndotjeve (PM2.5) Përqendrimi i Ndotjeve (PM10) Emetimet e gazrave serrë	Përqindje e zonave të caktuara si zona të mbrojtura Përqendrimi i NO2 (Dioksid Azoti) Përqendrimi i SO2 (Dioksid Sulfuri) Përqendrimi i O3 (Ozon) Ndotje akustike Ndryshim në perqindje në numrin e specieve autoktone	
Financa			
Qeverisja			
Shëndeti			
Strehimi			
Popullata dhe kushtet sociale			
Rekreacioni		Metra katrorë/banorë e hapësirave të jashtme rekreative	
Siguria			
Mbetjet e Ngurta			
Sporti dhe Kultura		Numri i institucioneve kulturore dhe objekteve sportive për popullsi 100,000 banorë.	
Telekomunikacioni			
Transporti			
Agrikultura urbane/lokale dhe sigurimi i ushqimit	Sipërfaqe totale e agrikulturës urbane për 100,000 banorë.		
Planifikimi Urban	Sipërfaqe e gjelbër për 100,000 banorë. Indikatorë të profilit të Planifikuesit Urban.		Numër pemësh për 100,000 banorë Dendësia e ndërtimit
Humbje e Ujit			
Uji			

TEMA	TREGUES KRYESORË	TREGUES MBËSHTETËS	TREGUES PROFILI
Ekonomi			
Edukim			
Energji			
Mjedisi dhe Ndryshimet Klimaterike	Përqendrimi i Ndotjeve (PM2.5) Përqendrimi i Ndotjeve (PM10) Emetimet e gazrave serrë	Përqindje e zonave të caktuara si zona të mbrojtura Përqendrimi i NO2 (Dioksid Azoti) Përqendrimi i SO2 (Dioksid Sulfuri) Përqendrimi i O3 (Ozon) Ndotje akustike Ndryshim në përqindje në numrin e specieve autoktone	
Financa			
Qeverisja			
Shëndeti			
Strehimi			
Popullata dhe kushtet sociale			
Rekreacioni		Metra katrorë/banorë e hapësirave të jashtme rekreative	
Siguria			
Mbetjet e Ngurta			
Sporti dhe Kultura		Numri i institucioneve kulturore dhe objekteve sportive për popullsi 100,000 banorë	
Telekomunikacioni			
Transporti			
Agrikultura urbane/lokale dhe sigurimi i ushqimit	Sipërfaqe totale e agrikulturës urbane për 100,000 banorë		
Planifikimi Urban	Sipërfaqe e gjelbër për 100,000 banorë Indikatorë të profilit të Planifikuesit Urban		Numër pemësh për 100,000 banorë Dendësia e ndërtimit
Humbje e Ujit			
Uji			

TABELA 2.2.2.1	<p>Tabelë e disa prej treguesve përcaktuar nga ISO 37120:2018 për "Qytetet dhe komunitetet e qëndrueshme - Treguesit për shërbimet e qytetit dhe cilësinë e jetës"</p> <p>Burimi: (ISO, Sustainable cities and communities - Indicators for city services and quality of life, 2018)</p> <p>Përpunoi: Autori</p>
TABELA 2.2.2.2	<p>Tabelë e disa prej treguesve përcaktuar nga ISO 37123:2019 për "Qytetet dhe komunitetet e qëndrueshme - Treguesit për qytetet elastike"</p> <p>Burimi: (ISO, Sustainable cities and communities - Indicators for resilient cities, 2019)</p> <p>Përpunoi: Autori</p>

zhvillimin e qytetit të qëndrueshëm. Një ndër ngjarjet më të rëndësishme të ndërmarra është Karta e Gjelbër 1990 (TABELA 1.1.1); (TABELA 2.3.1).

Energjia, Ndryshimet Klimaterike, Mjedisi - Nëpërmjet politikave të KE tenton të minimizojë risqet ndaj klimës, shëndetit të njerëzve dhe biodiversitetit. Ky synim tenton të zbatohet nëpërmjet planit të zbatimit “Marrëveshja e Gjelbër Evropiane” (*European Green Deal*), marrëveshje e cila tenton të kthejë Evropën në kontinentin e parë neutral ndaj klimës (www.ec.europa.eu). Temat e lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me MGJE janë: *Agrikultura, Ajri, Lëndët Kimike, Ekonomia Qarkulluese, Qytetet, Ndryshimet e Klimës, Energjia, Industria, Toka dhe Dheu, Mjedisi Detar dhe Bregdetar, Natyra dhe Biodiversiteti, Zhurma, Kërkimi dhe Inovacioni, Transporti, Ndotjet, Uji*, një pjesë e madhe e së cilave janë elementë përbërës së procesit të planifikimit territorial dhe të lidhura ngushtë me prezencën dhe ruajtjen e sistemeve natyrore.

Për sa i takon qyteteve dhe zhvillimit urban Komuniteti Evropian është duke punuar së bashku me qytetet për të siguruar një cilësi të mirë jete. Kjo nëpërmjet ndarjes së njohurive, fondeve dhe politikave apo iniciativave urbane. Në të gjitha politikat e Komunitetit Evropian rëndësia nuk ndalet vetëm tek hartimi i politikave, por një rëndësi gjithmonë e më të madhe ka fituar gjithashtu (1) raportimi dhe (2) monitorimi i veprimeve. Goli kryesor i planifikimit është përdorimi i tokës në mënyrë ekonomike dhe me masë. Kjo është arsyeja pse banimi po projektohet shumë më i dendur, por dhe mëhallët ekzistuese po dendësohen me ndërtime. Kopshte të mëdha do të mund të ndahen duke rezultuar në parcela të reja toke. Kjo lejon që zonat ekzistuese të banesave të bashkangjitura, gjysmë të bashkangjitura, të tarracuar etj. të mund të zhvillohen më tej. Kjo politikë – bërje, kursen natyrën dhe peizazhin jashtë qytetit, por gjithashtu kërkon që hapësirat e hapura në brendësi të qytetit të mund të menaxhohen me shumë më tepër ndjeshmëri (Bott, Grassl, & Anders, 2017).

2.3.1 Agjencia Evropiane e Mjedisit (AEM) apo European Environmental Agency (EEA)

Agjencia Evropiane e Mjedisit është agjenci e varur nga Komuniteti Evropian me qendër në Kopenhagen. Roli i saj është mbledhja dhe sigurimi i informacioneve mbi mjedisin. Është një burim përveçse i standardizuar, i sigurt dhe i bollshëm presa i takon vlerësimeve apo politikave të cilat do të mund të ndërmerren. Në këtë agjenci marrin pjesë 32 vende të Evropës, disa anëtarë, e disa të tjerë vende bashkëpunuese. Një nga këto vende bashkëpunuese është edhe Shqipëria. Kjo agjenci ekzekuton një seri programesh një nga te cilat është dhe **Kopernikus - Sistemi i Menaxhimit të Tokës** (Copernicus - Land Monitoring System CLMS). Ky program mbledh dhe harton data bazë nga monitorimi satelitor, por për t'u siguruar për saktësinë e kësaj data baze, konsultohet dhe me partnerë lokalë duke marrë të ashtuquajturat informacione in-situ (në vend). Me mbledhjen e këtyre informacioneve dhe me pas përpunimin e tyre, ky program ofron informacion me gjashtë tema kryesore të cilat janë: (1) Atmosfera; (2) Toka, (3) Detet, (4) Ndryshimet klimaterike, (5) Menaxhimi i emergjencave dhe (6) Siguria. I gjithë informacioni është i mundur të përdoret në fushën e planifikimit sipas interesave të projekteve specifike (Programme, n.d.).

2.3.2 Këshilli i Evropës dhe Konventa e Peizazheve Evropiane

Ka marrëdhënie shumë të qarta mes peizazhit dhe territorit, dhe është e mundur të krijohen sinergji të konsiderueshme. Në shumë gjuhë, termi “peizazh” përkufizohet zakonisht duke ju referuar si territor apo si një term me të njëjtën rrënjë kuptimore (Council of Europe, 2006).

3. Krahasime mes modelit të Tiranës sot dhe modeleve evropiane

3.1 Përcaktimi i metodologjisë krahasuese

Për t'ju përgjigjur pyetjes kryesore të kërkimit, është vlerësuar si shumë i rëndësishëm të vlerësuarit në një kontekst më të gjerë sesa ai lokal. Kjo për shkak të mungesave të data bazës, standardeve, aspekteve legislative, e të dhënave në nivelin lokal. Siç është përmendur më sipër, krijimi i modeleve të referencës jep një vlerësim më objektiv dhe ndihmon në një fazë të parë, në të kuptuarit më mire performancën e qytetit, përveçse na ndihmon në krijimin e një metodologjie pune në drejtim të përmirësimit të proceseve planifikuese. Nëpërmjet këtij kërkimi, janë identifikuar disa indikatorë për sa i takon matjes së prezencës së vegjetacionit në brendësi të sistemeve urbane. Në funksion të secilit indikator që përzgjidhet, bëhet edhe vlerësimi, ose anasjelltas, në funksion të nevojës për të matur, bëhet përzgjedhja e sistemit të vlerësimit. Këto indikatorë përcaktohen si më poshtë:

- (i) Numër pemësh në total; Numër pemësh / banor; Numër pemësh / 100 banorë;
- (ii) Sipërfaqe e kurorave të pemëve;
- (iii) Mbulim Toke | Përdorim toke i sistemeve natyrore apo gjysmë-natyrore;

Ajo që vihet re në të gjithë dokumentacionet dhe rekomandimet e shfletuara, është të vlerësuarit në përgjithësi e mbajtja në kontroll e territorit nëpërmjet hartave satelitore dhe sistemit GIS (Geografic Information System). Kopernikus - Sistemi i menaxhimit të Tokës (Copernicus, Land Monitoring (www.copernicus.eu)) është një prej programeve që në bashkëpunim me AEM kontrollon sistemet natyrore të kontinentit evropian.

Për të ndërtuar një metodologji pune në procesin e krahasimit të disa modeleve evropiane, është vënë në përdorim pikërisht data baza e vënë në dispozicion nga ky program. Klasifikimi i bërë për Mbulimin e Tokës/Përdorimin e Tokës (MT/PT) derivon nga Mbulimi i Tokës CORINE, e përbëhet nga 27 klasa si nënkategori të 5 temave kryesore të cilat janë:

1. Sipërfaqe Artificiale
2. Sipërfaqe Agrikulturë
3. Sipërfaqe Natyrore dhe Gjysmë-Natyrore
4. Ligatina
5. Sipërfaqe Ujore

Në tabelën (TABELA 3.1.1) janë renditur të gjitha temat; klasat; numrat dhe kodet e përcaktuara sipas Atlasit Urban (AU) apo Urban Atlas (UA). Këto klasa përcaktojnë edhe matricën e vendosur nga AU për Sipërfaqet Artificiale. Mbi bazën e këtyre tematikave dhe klasave është thirrur dhe baza e të dhënave si edhe janë ndërtuar hartat e shumë qyteteve të Evropës. Janë pikërisht këto të dhëna (atribute) të cilat janë thirrur nga data baza e Atlasit Urban (Urban Atlas) dhe janë ndërtuar tabelat me të dhëna për secilin qytet, të dhëna të cilat më pas bëhen lehtësisht të krahasueshme. Kjo do të përcaktonte edhe një përpjekje për të krahasuar dhe për të unifikuar si fillim terminologjinë teknike, gjithmonë nëse e nevojshme.

Për të mundësuar krahasimin mes konteksteve të ndryshme, standardeve apo vlerave sasimore, lind si domosdoshmëri vendosja e elementëve të matshëm në një sistem të vetëm krahasimi. Tre janë elementët kryesorë të cilët janë vlerësuar si indikatorë kryesorë për t'u krahasuar:

- (i) Shtrirja Urbane;
- (ii) Popullsia;
- (iii) Sasia në m² e territoreve me karakteristika natyrore;
- (iv) Ndërsa vlerësimi i indikatorit **m²/banor** rrjedh nga njohja e pikave b dhe d me sipër.

Fakti që ekzistojnë edhe hartat e territorit të Tiranës në këtë program, e thjeshton mjaftueshëm krahasimin mes qyteteve për sa i takon sistemeve natyrore ekzistuese në pëlhurën urbane të tyre. Për sa i takon Tiranës, vlerat janë dhënë për Tiranën qytet dhe Kamzën pasi në përgjithësi vlerësimi bëhet për vazhdimësi territoriale dhe jo njësi administrative. Në përgjithësi termi i përdorur për këtë kufi është “Urban Functional Area” ose në gjuhën shqipe – “Zonë Urbane Funktionale”.

NUMRI (SIPAS AU)	KODI	NOMENKLATURA
1		Sipërfaqe artificiale
1.1		Pëlhura urbane
1.1.1	11100	Pëlhurë e vazhduar urbane (S.L.: > 80%)
1.1.2		Pëlhurë e pa vazhduar urbane (S.L.: 10% - 80%)
1.1.2.1	11210	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, e dendur (S.L.: 50% - 80%)
1.1.2.2	11220	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, mesatarisht e dendur (S.L.: 30% - 50%)
1.1.2.3	11230	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, me densitet të ulët (S.L.: 10% - 30%)
1.1.2.4	11240	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, me densitet shumë të ulët (S.L.: < 10%)
1.1.3	11300	Struktura të izoluar
1.2		Njësi industriale, tregtare, publike, ushtarake dhe private
1.2.1	12100	Njësi industriale, tregtare, publike, ushtarake dhe private
1.2.2		Rrjet rrugësh, hekurudhash dhe tokë në shërbim të tyre
1.2.2.1	12200	Rrugë të shpejta tranziti dhe tokë në shërbim të tyre
1.2.2.2	12220	Rrugë të tjera dhe tokë në shërbim të tyre
1.2.2.3	12230	Hekurudha dhe tokë në shërbim të tyre
1.2.3	12300	Zona portuale
1.2.4	12400	Aeroporte
1.3		Miniera, vende hedhjesh mbeturinash dhe kantiere ndërtimi
1.3.1	13100	Nxjerrje mineralesh dhe zona mbledhje mbeturinash
1.3.3	13300	Kantiere ndërtimi
1.3.4	13400	Tokë pa një përdorim aktual
1.4		Zona artificiale me vegjetacion jo me karakter agrikor
1.4.1	14100	Hapësira të gjelbra urbane
1.4.2	14200	Objekte sportive e të kohës së lirë
2		Zona agrikulturore
2.1	21000	Tokë e punueshme (Kultura vjetore)
2.2	22000	Kultura të Përherëshme (Vreshta, Pemë frutore, Ullishte)
2.3	23000	Kullota
2.4	24000	Modele të përziera të kultivimit
3		Zona natyrore dhe (gjysmë -) natyrore
3.1	31000	Pyje
3.2	32000	Grumbullime me vegjetacion barishtor (tokë barishtore natyrore, barishte të larta ...)
3.3	33000	Hapësira të hapura me pak ose aspak vegjetacion (plazhe, duna, shkëmbinj, akullnaja)
4	40000	Ligatina
5	50000	Sipërfaqe Ujore
9.1	91000	Pa bazë të dhënash (Re dhe hije)
9.2	92000	Pa bazë të dhënash (Imazhe që mungojnë)

TABELA 3.1.1

Tabela e temave; klasifikimit dhe nomenklaturës së Mbulimit të Tokës | Përdorimit të tokës sipas AU

Burimi: <https://land.copernicus.eu>

Përpunoi: Autori

3.2 Përzgjedhja e qyteteve

Referuar literaturës dhe shumë studimeve në rang kontinenti (Green Surge), prezenca e sistemeve natyrore në një sistem urban është derivat i disa karakteristikave kryesore:

- (i) Fashës klimaterike së cilës i përket;
- (ii) Gjeografisë së territorit - shkalla e fragmentarizmit;
- (iii) Metodave të planifikimit;
- (iv) Morfologjisë së territorit;
- (v) Morfologjisë së formës urbane;

Në këtë studim është ndërtuar një matricë e tillë ku janë përzgjedhur qytete të cilat:

- (i) Kanë data bazë në të paktën 2 burime të siguruara (AU dhe STATISTA);
- (ii) Përfaqësojnë qytete nga fasha të ndryshme klimaterike;
- (iii) Përfaqësojnë qytete të cilët kanë qenë në kushte të ndryshme të planifikimit;

STATISTA është një kompani gjermane e specializuar në grumbullimin e të dhënave statistikore për tematika nga më të ndryshmet. Të dhënat në nivel Evropian i referohen të dhënave të vëna në dispozicion për përdorim nga programet e sipërpërmendura (pas përpunimit të tyre) dhe të tjera informacione e të dhëna të publikuara nga STATISTA (www.statista.com). Referenca të tjera janë gjeneruar nga publikime, kërkime pjesore apo edhe raste studimore të përmendura në literaturë. Sa më sipër, referuar dhe raporteve të ndryshme, familjet e planifikimit janë të shpjeguara shkurtimisht më poshtë, ku për secilën familje është përcaktuar dhe qyteti i përzgjedhur për krahasim në këtë studim.

- (i) **Familja Nordike e Planifikimit | Gjithëpërfshirëse dhe e Integruar**
Helsinki;
- (ii) **Familja Britanike e Planifikimit | Menaxhimi i Përdorimit të Tokës**
Dublin;
- (iii) **Familja e planifikimit të shteteve të reja në KE | Post Socialiste**
Varshavë, Budapest, Lubjanë;
- (iv) **Familja e planifikimit qendror | Planifikim Ekonomik Rajonal**
Vjenë, Mynih, Marsejë;
- (v) **Familja e planifikimit mesdhetar | Urbanistikë**
Milano, Lisbonë, Selanik, Valeta;

Këto qytete të përzgjedhura kënaqin gjithashtu kushtin e paravendosur të përfaqësimit të fashave të ndryshme klimaterike, por dhe ekzistencën e të dhënave mbi to edhe në burime të tjera informacioni, të sipërpërmendura.

3.3 Vlerësime dhe Analizimi i rezultateve

Tirana




FIGURA 3.3.1 Hartë e Mbulimit të Tokës / Përdorimit të Tokës për qytetin e Tiranës
Burimi: <https://land.copernicus.eu/>
Përpunoi: Autori




FIGURA 3.3.2 Fragment i Mbulimit të Tokës / Përdorimit të Tokës për qytetin e Tiranës
Burimi: <https://land.copernicus.eu/>

				TIRANË
KODI	NOMENKLATURA	SIPËRFAQE (M ²)	SIPËRFAQE (HA)	POPULLSIA (2018)
Sipërfaqe artificiale				
Pëlhura urbane				
11100	Pëlhurë e vazhduar urbane (S.L.: > 80%)	13 880 604,33	1 388,06	303 967
	Pëlhurë e pa vazhduar urbane (S.L.: 10% - 80%)	n/a	n/a	n/a
11210	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, e dendur (S.L.: 50% - 80%)	17 495 351,97	1 749,54	208 100
11220	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, mesatarisht e dendur (S.L.: 30% - 50%)	18 578 061,02	1 857,81	122 954
11230	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, me densitet të ulët (S.L.: 10% - 30%)	27 654 397,64	2 765,44	116 067
11240	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, me densitet shumë të ulët (S.L.: < 10%)	35 813 443,05	3 581,34	74 900
11300	Struktura të izoluar	10 196 551,30	1 019,66	15 038
Njësi industriale, tregtare, publike, ushtarake dhe private				
12100	Njësi industriale, tregtare, publike, ushtarake dhe private	32 439 250,89	3 243,93	16 092
	Rrjet rrugësh, hekurudhash dhe tokë në shërbim të tyre	n/a	n/a	n/a
12200	Rrugë të shpejta tranziti dhe tokë në shërbim të tyre	1 314 422,89	131,44	-
12220	Rrugë të tjera dhe tokë në shërbim të tyre	22 591 233,39	2 259,12	-
12230	Hekurudha dhe tokë në shërbim të tyre	833 792,38	83,38	-
12300	Zona portuale	766 204,31	76,62	431
12400	Aerporte	n/a	n/a	n/a
Miniera, vende hedhesh mbeturinash dhe kantiere ndërtimi				
13100	Nxjerrje minerale dhe zona mbledhje mbeturinash	2 619 576,77	261,96	-
13300	Kantiere ndërtimi	2 658 769,96	265,88	-
13400	Tokë pa një përdorim aktual	7 059 842,38	705,98	-
Zona artificiale me vegetacion jo me karakter agrikulor				
14100	Hapësira të gjelbra urbane	4 513 873,39	451,39	-
14200	Objekte sportive e të kohës së lirë	1 539 519,66	153,95	396
Zona agrikulorore				
21000	Tokë e punueshme (Kultura vjetore)	219 421 773,22	21 942,18	10 717
22000	Kultura të Përherëshme (Vreshta, Pemë frutore, Ullishte)	4 225 300,20	422,53	395
23000	Kullota	186 430 030,26	18 643,00	15 665
24000	Modele të përziera të kultivimit	23 084 188,63	2 308,42	-
Zona natyrore dhe (gjysmë -) natyrore				
31000	Pyje	612 852 785,80	61 285,28	-
32000	Grumbullime me vegetacion barishtor (tokë barishtore natyrore, barishte të larta ...)	308 125 521,54	30 812,55	-
	Hapësira të hapura me pak ose aspak vegetacion (plazhe, duna, shkëmbinj, akullnaja)	74 305 769,10	7 430,58	-
33000	Ligatina	11 452 898,07	1 145,29	-
50000	Sipërfaqe Ujore	30 127 672,41	3 012,77	-
91000	Pa bazë të dhënash (Re dhe hije)	n/a	n/a	n/a
92000	Pa bazë të dhënash (Imazhe që mungojnë)	n/a	n/a	n/a
Sipërfaqe TOTALE (e analizuar) (Ha)			166 998,08	
POPULLSI TOTALE (Banorë)				884 722
Sipërfaqe artificiale TOTALE (Ha)			12 967,18	
Popullsi TOTALE për SIPËRFAQEN ARTIFICIALE (Banorë)				841 422
Sipërfaqe TOTALE e pëlhurës urbane (Ha)			12 361,84	
Sipërfaqe TOTALE e zonave artificiale, jo bujqësore, me vegetacion (Ha)			605,34	
M² REKREACION / BANOR				7,19
M ² Gjellbërim urban			4 513 873,39	
M² GJELBËRIM URBAN / BANOR				5,36
M ² Objekte sportive e të kohës së lirë			1 539 519,66	
M² OBJEKTE SPORTIVE E TË KOHËS SË LIRË / BANOR				1,83

TABELA 3.3.1 Tabela e të dhënave mbi klasat dhe popullsinë për qytetin e Tiranës
 Burimi: <https://land.copernicus.eu>;
 Përpunoi: Autori

Sipas matjeve të realizuara në këtë data bazë, Zona Funktionale Urbane (FUA) me një popullsi 884,722 siguron **7.19 m²/banor** sipërfaqe rekreative, e cila sipas matricës së AU përbëhet nga kategoritë e (1) Gjellbërimit Urban **5.36 m²/banor** dhe (2) Objekte sportive e të kohës së lirë **1.83 m²/banor**.

Budapest




FIGURA 3.3.3

Hartë e Mbulimit të Tokës / Përdorimit të Tokës për qytetin e Budapestit
Burimi: <https://land.copernicus.eu/>
Përpunoi: Autori



FIGURA 3.3.4

Fragment i Mbulimit të Tokës / Përdorimit të Tokës për qytetin e Budapestit
Burimi: <https://land.copernicus.eu/>

				BUDAPEST
KODI	NOMENKLATURA	SIPËRFAQE (M ²)	SIPËRFAQE (HA)	POPULLSIA (2018)
Sipërfaqe artificiale				
Pëlhura urbane				
11100	Pëlhurë e vazhduar urbane (S.L.: > 80%)	166 105 092,00	16 610,51	1 397 588
	Pëlhurë e pa vazhduar urbane (S.L.: 10% - 80%)	n/a	n/a	n/a
11210	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, e dendur (S.L.: 50% - 80%)	387 444 018,57	38 744,40	1 228 861
11220	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, mesatarisht e dendur (S.L.: 30% - 50%)	108 995 862,49	10 899,59	168 051
11230	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, me densitet të ulët (S.L.: 10% - 30%)	32 027 592,78	3 202,76	25 538
11240	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, me densitet shumë të ulët (S.L.: < 10%)	4 418 584,92	441,86	6 099
11300	Struktura të izoluar	11 453 514,05	1 145,35	5 858
Njësi industriale, tregtare, publike, ushtarake dhe private				
12100	Njësi industriale, tregtare, publike, ushtarake dhe private	187 007 762,00	18 700,78	66 916
	Rrjet rrugësh, hekurudhash dhe tokë në shërbim të tyre	n/a	n/a	n/a
12200	Rrugë të shpejta tranziti dhe tokë në shërbim të tyre	19 776 346,85	1 977,63	-
12220	Rrugë të tjera dhe tokë në shërbim të tyre	100 281 299,80	10 028,13	-
12230	Hekurudha dhe tokë në shërbim të tyre	17 763 506,05	1 776,35	-
12300	Zona portuale	1 522 533,39	152,25	339
12400	Aeroporte	20 381 130,64	2 038,11	-
Miniera, vende hedhësh mbeturinash dhe kantiere ndërtimi				
13100	Nxjerrje mineralësh dhe zona mbledhje mbeturinash	27 736 502,03	2 773,65	-
13300	Kantiere ndërtimi	5 356 792,39	535,68	-
13400	Tokë pa një përdorim aktual	13 392 174,01	1 339,22	-
Zona artificiale me vegjetacion jo me karakter agrikulturor				
14100	Hapësira të gjelbra urbane	49 093 283,99	4 909,33	-
14200	Objekte sportive e të kohës së lirë	62 241 026,72	6 224,10	6 074
Zona agrikulturore				
		2 313 653	231 365,32	31 927
21000	Tokë e punueshme (Kultura vjetore)	249,82		
22000	Kultura të Përherëshme (Vreshta, Pemë frutore, Ullishte)	32 314 346,19	3 231,43	583
		1 194 433	119 443,38	39 813
23000	Kullota	813,04		
24000	Modele të përziera të kultivimit	109 969,46	11,00	-
Zona natyrore dhe (gjysmë -) natyrore				
		1 479 763	147 976,36	-
31000	Pyje	647,31		
32000	Grumbullime me vegjetacion barishtor (tokë barishtore natyrore, barishte të larta ...)	22 433 362,46	2 243,34	-
33000	Hapësira të hapura me pak ose aspak vegjetacion (plazhe, duna, shkëmbinj, akullnaja)	16 626,30	1,66	-
40000	Ligatina	16 557 252,11	1 655,73	-
50000	Sipërfaqe Ujore	118 876 979,11	11 887,70	-
91000	Pa bazë të dhënash (Re dhe hije)	n/a	n/a	n/a
92000	Pa bazë të dhënash (Imazhe që mungojnë)	n/a	n/a	n/a
Sipërfaqe TOTALE (e analizuar) (Ha)			639 315,63	
POPULLSI TOTALE (Banorë)				2 977 647
Sipërfaqe artificiale TOTALE (Ha)			82 177,90	
Popullsi TOTALE për SIPËRFAQEN ARTIFICIALE (Banorë)				2 838 069
Sipërfaqe TOTALE e pëlhurës urbane (Ha)			71 044,47	
Sipërfaqe TOTALE e zonave artificiale, jo bujqësore, me vegjetacion (Ha)			11 133,43	
M² REKREACION / BANOR				39,23
M ² Gjellbërim urban			49 093 283,99	
M² GJELBËRIM URBAN / BANOR				17,30
M ² Objekte sportive e të kohës së lirë			62 241 026,72	
M² OBJEKTE SPORTIVE E TË KOHËS SË LIRË / BANOR				21,93

TABELA 3.3.2

Tabela e të dhënave mbi klasat dhe popullsinë për qytetin e Budapestit

 Burimi: <https://land.copernicus.eu>;

Përpunoi: Autori

Sipas matjeve të realizuara në këtë data bazë, Zona Funktionale Urbane (FUA) me një popullsi 2,977,647 siguron **39.23 m²/banor** sipërfaqe rekreative, e cila sipas matjeve se AU përbëhet nga kategoritë e (1) Gjellbërimit Urban **17.30 m²/banor** dhe (2) Objekte sportive e të kohës së lirë **21.93 m²/banor**.

Dublin




FIGURA 3.3.5

Hartë e Mbulimit të Tokës / Përdorimit të Tokës për qytetin e Dublinit
Burimi: <https://land.copernicus.eu/>
Përpunoi: Autori




FIGURA 3.3.6

Fragment i Mbulimit të Tokës / Përdorimit të Tokës për qytetin e Dublinit
Burimi: <https://land.copernicus.eu/>

				DUBLIN
KODI	NOMENKLATURA	SIPËRFAQE (M ²)	SIPËRFAQE (HA)	POPULLSIA (2018)
Sipërfaqe artificiale				
Pëlhura urbane				
11100	Pëlhurë e vazhduar urbane (S.L.: > 80%)	11 205 807,21	1 120,58	168 953
	Pëlhurë e pa vazhduar urbane (S.L.: 10% - 80%)	n/a	n/a	n/a
11210	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, e dendur (S.L.: 50% - 80%)	162 989 182,11	16 298,92	1 180 902
11220	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, mesatarisht e dendur (S.L.: 30% - 50%)	150 038 122,06	15 003,81	348 626
11230	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, me densitet të ulët (S.L.: 10% - 30%)	64 801 606,71	6 480,16	38 305
11240	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, me densitet shumë të ulët (S.L.: < 10%)	3 244 306,90	324,43	3 716
11300	Struktura të izoluar	104 045 756,58	10 404,58	53 887
Njësi industriale, tregtare, publike, ushtarake dhe private				
12100	Njësi industriale, tregtare, publike, ushtarake dhe private	170 544 339,38	17 054,43	51 082
	Rrjet rrugësh, hekurudhash dhe tokë në shërbim të tyre	n/a	n/a	n/a
12200	Rrugë të shpejta tranziti dhe tokë në shërbim të tyre	15 382 538,13	1 538,25	-
12220	Rrugë të tjera dhe tokë në shërbim të tyre	108 792 602,22	10 879,26	-
12230	Hekurudha dhe tokë në shërbim të tyre	5 939 376,91	593,94	-
12300	Zona portuale	3 360 430,87	336,04	879
12400	Aerporte	9 820 459,05	982,05	-
Miniera, vende hedhesh mbeturinash dhe kantiere ndërtimi				
13100	Nxjerrje minerale dhe zona mbledhje mbeturinash	40 915 356,19	4 091,54	-
13300	Kantiere ndërtimi	10 565 972,92	1 056,60	-
13400	Tokë pa një përdorim aktual	12 042 560,50	1 204,26	-
Zona artificiale me vegetacion jo me karakter agrikor				
14100	Hapësira të gjelbra urbane	63 162 282,72	6 316,23	-
14200	Objekte sportive e të kohës së lirë	131 288 880,89	13 128,89	5 372
Zona agrikor				
21000	Tokë e punëshme (Kultura vjetore)	615 203 124,02	61 520,31	6 819
22000	Kultura të Përherëshme (Vreshta, Pemë frutore, Ullishte)	n/a	n/a	n/a
		3 946 510	394 651,06	57 553
23000	Kullota	554,00		
24000	Modele të përziera të kultivimit	n/a	n/a	n/a
Zona natyrore dhe (gjysmë -) natyrore				
31000	Pyje	604 908 245,56	60 490,82	-
32000	Grumbullime me vegetacion barishtor (tokë barishtore natyrore, barishte të larta...)	607 360 796,59	60 736,08	-
33000	Hapësira të hapura me pak ose aspak vegetacion (plazhe, duna, shkëmbinj, akullnaja)	3 698 427,00	369,84	-
40000	Ligatina	102 957 626,02	10 295,76	-
50000	Sipërfaqe Ujore	89 256 501,98	8 925,65	-
91000	Pa bazë të dhënash (Re dhe hije)	n/a	n/a	n/a
92000	Pa bazë të dhënash (Imazhe që mungojnë)	n/a	n/a	n/a
Sipërfaqe TOTALE (e analizuar) (Ha)			703 803,49	
POPULLSI TOTALE (Banorë)				1 916 094
Sipërfaqe artificiale TOTALE (Ha)			69 077,59	
Popullsi TOTALE për SIPËRFAQEN ARTIFICIALE (Banorë)				1 799 761
Sipërfaqe TOTALE e pëlhurës urbane (Ha)			49 632,48	
Sipërfaqe TOTALE e zonave artificiale, jo bujqësore, me vegetacion (Ha)			19 445,12	
M² REKREACION / BANOR				108,04
M ² Gjëlberim urban			63 162 282,72	
M² GJELBËRIM URBAN / BANOR				35,09
M ² Objekte sportive e të kohës së lirë			131 288 880,89	
M² OBJEKTE SPORTIVE E TË KOHËS SË LIRË / BANOR				72,95

TABELA 3.3.3

Tabela e të dhënave mbi klasat dhe popullsinë për qytetin e Dublinit

Burimi: <https://land.copernicus.eu>;

Përpunoi: Autori

Sipas matjeve të realizuara në këtë data bazë, Zona Funktionale Urbane (FUA) me një popullsi 1,916,094 siguron **108.04 m²/banor** sipërfaqe rekreative e cila sipas matjes se AU përbëhet nga kategoritë e (1) Gjëlberimit Urban **35.09 m²/banor** dhe (2) Objekte sportive e të kohës së lirë **72.95 m²/banor**.

Helsinki




FIGURA 3.3.7

Hartë e Mbulimit të Tokës / Përdorimit të Tokës për qytetin e Helsinkit

Burimi: <https://land.copernicus.eu/>

Përpunoi: Autori




FIGURA 3.3.8

Fragment i Mbulimit të Tokës / Përdorimit të Tokës për qytetin e Helsinkit

Burimi: <https://land.copernicus.eu/>

				HELSINKI
KODI	NOMENKLATURA	SIPËRFAQE (M ²)	SIPËRFAQE (HA)	POPULLSIA (2018)
Sipërfaqe artificiale				
Pëlhura urbane				
11100	Pëlhurë e vazhduar urbane (S.L.: > 80%)	10 238 451,81	1 023,85	209 882
	Pëlhurë e pa vazhduar urbane (S.L.: 10% - 80%)	n/a	n/a	n/a
11210	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, e dendur (S.L.: 50% - 80%)	62 311 440,33	6 231,14	484 475
	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, mesatarisht e dendur (S.L.: 30% - 50%)	75 565 967,51	7 556,60	369 031
11220	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, me densitet të ulët (S.L.: 10% - 30%)	77 874 001,17	7 787,40	208 325
11230	Pëlhurë e pa vazhduar urbane, me densitet shumë të ulët (S.L.: < 10%)	78 539 493,84	7 853,95	72 378
11240	Struktura të izoluar	88 893 888,58	8 889,39	37 576
Njësi industriale, tregtare, publike, ushtarake dhe private				
12100	Njësi industriale, tregtare, publike, ushtarake dhe private	112 998 537,78	11 299,85	52 207
	Rrjet rrugësh, hekurudhash dhe tokë në shërbim të tyre	n/a	n/a	n/a
12200	Rrugë të shpejta tranziti dhe tokë në shërbim të tyre	15 613 528,67	1 561,35	-
12220	Rrugë të tjera dhe tokë në shërbim të tyre	91 756 518,49	9 175,65	-
12230	Hekurudha dhe tokë në shërbim të tyre	7 130 619,49	713,06	-
12300	Zona portuale	5 454 094,31	545,41	7 516
12400	Aerporte	12 980 552,58	1 298,06	-
Miniera, vende hedhesh mbeturinash dhe kantiere ndërtimi				
13100	Nxjerrje minerale dhe zona mbledhje mbeturinash	28 669 149,51	2 866,91	-
13300	Kantiere ndërtimi	4 256 552,03	425,66	-
13400	Tokë pa një përdorim aktual	4 653 260,57	465,33	-
Zona artificiale me vegetacion jo me karakter agrikoror				
14100	Hapësira të gjelbra urbane	41 197 012,90	4 119,70	-
14200	Objekte sportive e të kohës së lirë	42 469 527,39	4 246,95	3 706
Zona agrikuturore				
		1 029 870	102 987,08	23 588
21000	Tokë e punëshme (Kultura vjetore)	815,80		
22000	Kultura të Përherëshme (Vreshta, Pemë frutore, Ullishte)	57 711,53	5,77	-
23000	Kullota	236 518 393,58	23 651,84	9 534
24000	Modele të përziera të kultivimit	n/a	n/a	n/a
Zona natyrore dhe (gjysmë -) natyrore				
		2 504 429	250 442,99	-
31000	Pyje	908,57		
	Grumbullime me vegetacion barishtor (tokë barishtore natyrore, barishte të larta...)	47 550 217,92	4 755,02	-
32000	Hapësira të hapura me pak ose aspak vegetacion (plazhe, duna, shkëmbinj, akullnaja)	1 398 274,85	139,83	-
33000	Ligatina	23 295 861,73	2 329,59	-
50000	Sipërfaqe Ujore	342 389 771,78	34 238,98	-
91000	Pa bazë të dhënash (Re dhe hije)	n/a	n/a	n/a
92000	Pa bazë të dhënash (Imazhe që mungojnë)	n/a	n/a	n/a
Sipërfaqe TOTALE (e analizuar) (Ha)		494 611,36		
POPULLSI TOTALE (Banorë)				1 478 218
Sipërfaqe artificiale TOTALE (Ha)		47 708,98		
Popullsi TOTALE për SIPËRFAQEN ARTIFICIALE (Banorë)				1 385 373
Sipërfaqe TOTALE e pëlhurës urbane (Ha)		39 342,32		
Sipërfaqe TOTALE e zonave artificiale, jo bujqësore, me vegetacion (Ha)		8 366,65		
M² REKREACION / BANOR				60,39
M ² Gjelbërim urban		41 197 012,90		
M² GJELBËRIM URBAN / BANOR				29,74
M ² Objekte sportive e të kohës së lirë		42 469 527,39		
M² OBJEKTE SPORTIVE E TË KOHËS SË LIRË / BANOR				30,66

TABELA 3.3.4

Tabela e të dhënave mbi klasat dhe popullsinë për qytetin e Helsinkit

 Burimi: <https://land.copernicus.eu>;

Përpunoi: Autori

Sipas matjeve të realizuara në këtë data bazë, Zona Funktionale Urbane (FUA) me një popullsi 1,478,218 siguron **60.39 m²/banor** sipërfaqe rekreative e cila sipas matjes së AU përbëhet nga kategoritë e (1) Gjelbërimit Urban **29.74 m²/banor** dhe (2) Objekte sportive e të kohës së lirë **30.66 m²/banor**.

Lisbonë




FIGURA 3.3.9

Hartë e Mbulimit të Tokës / Përdorimit të Tokës për qytetin e Lisbonës
Burimi: <https://land.copernicus.eu/>
Përpunoi: Autori




FIGURA 3.3.10

Fragment i Mbulimit të Tokës / Përdorimit të Tokës për qytetin e Lisbonës
Burimi: <https://land.copernicus.eu/>

				LISBONË
KODI	NOMENKLATURA	SIPËRFAQE (M ²)	SIPËRFAQE (HA)	POPULLSIA (2018)
Sipërfaqe artificiale				
Pëlhura urbane				
11100	Pëlhurë e vazhduar urbane (S.L.: > 80%)	116 090 583,73	11 609,06	1 682 193
Një plan që rifiton peizazhin: ky është vizioni i së ardhmes së Tiranës nga sot deri në 2030 dhe me pak fjale, bërthama e projektit të zhvilluar nga “Stefano Boeri Architeti” për kryeqytetin e Shqipërisë. Duke filluar nga imazhi i së famshmes “*Allegoria ed Effetti del Buono e del Cattivo Governo*” (*The Allegory of Good and Bad Government*), afresk i Ambrogio Lorenzetti, tema e një **modeli për një balance mes qytetit dhe natyrës** është përkufizuar si “qyteti kaleidoskopik”.

Tirana 2030, kartëvizita identitare e zhvillimit të ardhshëm të qytetit, përbehet nga tre pjesë kryesore të cilat korrespondojnë me tre faza të projektimit të Planit Rregullues, secila prej të cilave me karakteristikat e veta të ecurisë së zhvillimit si edhe të përkufizimeve. “Afresku Metropolitan”, bazuar në 10 tema kryesore (**biodiversiteti**, policentrizmi, përhapja e njohurive, lëvizshmëria, **uji**, gjeopolitika, turizmi, **aksesueshmëria (arritshmëria)**, agrikultura dhe energjia), sigurojnë vizionin e përgjithshëm të PPV-së. “Atlasi” i përberë nga **13 projekte strategjike** (FIGURA 4.1.2.1) të përcaktuara brenda këtij territori, përkufizojnë ndërhyrjet të cilat do të gjenerojnë zhvillimet e përcaktuara nga “Afresku” dhe të cilat do të mund të zbatohen nëpërmjet “Tabelës së Udhëzimeve”, drafti i së cilës përfaqëson fazën e tretë të implementimit të planit. Strategjia kryesore përcakton se përmbajtja e përdorimit të tokës ecën në mënyrë të pashmangshme paralel me kërkesën për ndërprerje të vazhdimësisë urbane. Ky objektivi do të mund të ndiqet nëpërmjet shfrytëzimit në drejtimin vertikal në shkëmbim të lirimit të sipërfaqeve të tokave. Në fakt Tirana si qytet nuk ka një mesatare të lartë në lartësinë e ndërtesave, por në të njëjtën kohe është një nga qytetet më të dendura në Evropë, me një hapësirë të hapur (open space) të ngjeshur. Ushtrimi i presionit në zonat bosh për të krijuar hapësire publike ishte prioriteti i këtij plani, ashtu sikurse ndërhyrja në sektorët natyrorë dhe të agrikulturës, në mënyrë që të prezantojë elementë të një diversiteti apo shumëllojshmërie të pasur në kufijtë e urbanes.

Tema kryesore në lidhje me përmirësimin e dimensionit natyror brenda mjedisit urban të Tiranës ndahet në disa seksione të ndryshme operative. Këto përfshijnë:

(1) Një sistem pyjor të vazhduar, të vendosur në perimetër të qytetit, përreth tij, me një përmbajtje rreth dy milion pemë, duke përfshirë parqe natyrore të mbrojtura dhe oaze për të ruajtur dhe mbajtur gjallë biodiversitetin lokal, (2) Korridore të reja ekologjike përgjatë lumenjve të Lanës, Tiranës dhe Erzenit dhe një unazë të gjelbër, të njohur si “Unaza e 4-t” duke synuar një hapësirë publike lineare për lëvizshmërinë dhe në një pozicion qendror krahasuar me Tiranën e madhe dhe zonën metropolitane të saj. Projekti përfshin gjithashtu (3) linçimin e qendrave më të vogla si një rrjet i përhapur për zhvillimin e turizmit dhe prodhimit, në komunikim me njëra tjetrën dhe me zonën urbane. Në këtë mënyrë, PPV-ja tenton të polarizojë densitetin kaotik të pjesës së konsoliduar të qytetit, nëpërmjet përmirësimit të zonave peri-urbane me densitet të rrallë dhe qendrave satelit, secila duke u zhvilluar bazuar në potencialin që mbart.

Afërsisht një shekull pas hartimit të planit të vitit 1925 nga një grup projektuesish italianë, të udhëhequr nga Armando Brasini, plani Tirana 2030 vendos një gamë të gjerë objektivash të cilat synojnë që të inaugurojnë një fazë të re në zhvillimin e kryeqytetit të Shqipërisë.

Krahasuar me Planin e shekullit të kaluar, **Tirana 2030 redukton parashikimin për zhvillimin demografik të zonës urbane me dy të tretat në favor të qytetit të gjelbër, të arritshëm (aksesueshëm) për të gjithë, në emër të shumëllojshmërisë funksionale dhe aktiviteteve.** Plani i ri hartuar nga “Stefano Boeri Arkitekti”, funksionon duke aktivizuar dy nivele metodologjike.

E para është ndërveprimi mes një serie zonash të mëdha dhe vektorësh abstraktë me entitete të tjera që janë më shumë “të përcaktuar në mënyrë empirike”. Kjo rezulton në një qasje ndërhyrjeje, e ushqyer nga ndërhyrje të shkallës së vogël, të afta për të aktivizuar rigjenerimin e teksturës ekzistuese nga brendësia dhe që arrijnë të emetojnë efekte e të shumëfishohen në nivel mëhale. Në më shumë detaje, programi përfshin (1) ndërtimin e 20 shkollave të reja mbi një rrjet hapësirash të hapura dhe (2) sheshesh urbane, të cilët ofrojnë banorëve aktivitete kulturore dhe shërbime që i japin një imazh të ri qytetit, atë të një qyteti publik dhe gjithëpërfshirës.

Nga ana tjetër, **sipërfaqet e gjelbra në qytet do të trefishohen** nëpërmjet një ndërhyrjeje shumëfazëshe e cila përfshin (1) ndërtimin e rrugicave për këmbësoret e pedaluesit e biçikletave, me dy linja pemësh në zonën qendrore, (2) një oazi të madh natyror rreth Liqenit të Farkës dhe (3) shirita të gjelbër të cilët kufizojnë sipërfaqet ujore. Sistemi i gjeneruar në këtë formë, do të mund të krijojë një korridor të vërtetë ekologjik, i aftë për të stimuluar prodhimin e energjisë nëpërmjet përdorimit të burimeve të rinovueshme. Projekti gjithashtu ri-projekton sistemin e lëvizjes urbane duke prezantuar një tarifë mbingarkese në zonat qendrore, duke inkurajuar dhe duke mbështetur përdorimin e sistemit të “linjës së dedikuar të autobusëve” me një tjetër linjë ekstra e cila do të ofrojë një lidhje të shpejtë mes aeroportit e bulevardit “Dëshmorët e Kombit” (rruga historike e qytetit) dhe që sjell racionalizimin e lidhjeve me qendrat jashtë qytetëse.




FIGURA 4.1.2.1

13 Strategjitë e PPV Tirana 2030
Burimi: (Municipality of Tirana, 2017)
Përpunoi: Autori

Në të njëjtën kohë, edhe brenda qytetit të konsoliduar edhe në zonat peri-urbane dhe rurale, Masterplani përcakton “epiqendrat” e reja për zhvillimin urban, ekonomik dhe social të Tiranës, duke përcaktuar linjat e udhëzuesve për një qytete të ardhshëm policentrik dhe kaleidoskopik.

Tirana sipas Boerit përfaqëson një manifesto gjeopolitik të shekullit të 20-të me aksin e vet qendror Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”.

Ky monument, i zhvilluar si pjesë e planit të Brasinit përshkruan qytetin nga veriu në jug, duke e theksuar edhe më shumë konfigurimin e saj me rrathë koncentrike. Pëlhura e qytetit është modifikuar tashmë nga ndërhyrje të rëndësishme si ajo e projektit 51N4E për sheshin Skënderbej, apo zgjatimi i bulevardit nga “Grimshaw Architects” dhe më tepër hapësira të gjelbra janë prezantuar së bashku me rritjen e hapësirës këmbësore dhe projekte të tjera të lidhura me këto hapësira. Më i rëndësishmi prej tyre është Parku Botëror, një shesh i ri drejtkëndor i destinuar për të mirëpritur të gjitha ambasadat me qëllim që të theksojë dhe të konsolidojë dimensionin gjeopolitik të qytetit në një lloj alegorie të shtrirë në tre dimensione. Qyteti do të rritet në intensitet, së bashku me rrugë të tjera historike, (unaza e dytë dhe e katërt, Rruga Tiranë - Durrës dhe pesë zona zhvillimi), pa okupuar toka të reja të agrikulturës, apo toka natyrore, por duke shumëfishuar zonat e gjelbra, shërbimet dhe hapësirat publike.

Sa më sipër, marrë nga relacionet përkatëse e shpjegimet e dhëna nga autorët, në nivelin teorik e atë strategjik, PPV Tr2030 është në vazhdimësi e qëndron në një nivel me politike-bërjen në rang ndërkombëtar.

4.1.3 Metrobosco

Një prej strategjive shumë interesante të propozuara në PPV Tr2030 është Metrobosco. Por çfarë është Metrobosco? Brez i Gjelbër apo Sistem Parqesh Periferikë?

PPV Tr030 përkufizon limitet maksimale të shpërndarjes urbane. Për njësinë administrative të Tiranës, Metrobosco rezulton të jetë kufiri fizik i zhvillimit dhe zgjerimit. Edhe për sa i takon zonave rurale, ky plan vendos një limit për zhvillimin/zgjerimin/rritjen e densitetit të tyre (Municipality of Tirana, 2017).

Parë nga ky këndvështrim, ka ngjashmëri me karakteristikat e një Brezi të Gjelbër, por nuk i plotëson të gjitha kriteret e një Brezi të Gjelbër. Referuar politikave të Brezit të Gjelbër në Britaninë e Madhe, ai ka karakteristikat e përshkruara më poshtë.

Politikat e Brezit të Gjelbër - Sipas NPPF (National Planning Policy Framework) jepen këto qëllime të implementimit të tij:

- (i) Kontrollon përhapjen e pakufizuar të zonave të mëdha të ndërhuara;
- (ii) Ndalon takimin me njëri-tjetrin të qyteteve fqinje;
- (iii) Asiston në ruajtjen e fshatrave nga mbivendosjet me zonat urbane;
- (iv) Ruan vendosjen dhe karakterin e veçantë të qyteteve historike;
- (v) Asiston në rigjenerimin urban, duke inkurajuar riciklimin e tokave të braktisura dhe llojeve të tjera të tokës urbane.

Referuar Strategjisë 01 në PPV Tr2030 Metrobosco është - Realizimi i një brezi prej 2 milionë pemësh rreth qytetit, i cili do të ketë mundësi të bllokojë konsumin e tokës dhe të krijojë një unazë me pemë frutore, parqe me pemë dhe pyje me qëllim natyralizimin e territoreve specifike. Sikundër është përshkruar në kapitujt e mëparshëm, në 15 vitet e fundit, qyteti i Tiranës ka pësuar një rritje të fortë demografike. Për të përballuar një kërkesë të lartë për banesa, qyteti i ndërtuar është zgjeruar në këtë mënyrë në drejtim të pakontrolluar, jo vetëm në zonat e qytetëruara, por edhe në zonat ish bujqësore dhe natyrore. Plani i Përgjithshëm Vendor ka për qëllim të luftojë këtë fenomen, të kufizojë konsumin e tokës, të ruajë zonat bujqësore dhe natyrore, duke parashikuar, aty ku rezulton e nevojshme, ri-natyralizimin e tyre. Sipas këtij plani Metrobosco do të jetë:

- (a) Kufiri natyral i qytetit (Vijë e gjelbër);
- (b) Do të lidhë sisteme parqesh peri-urbane;
- (c) Do të lidhë 14,671 ha territore natyrore ndër-vete;

Referuar Planit të Përgjithshëm Vendor, Strategjisë Territoriale të Bashkisë Tiranë, karakteristikat e Metrobosco-s do të duhet të jenë si më poshtë:

- (a) Brez i gjelbër me thellësi maksimale 200 M dhe thellësi minimale 30 M;
- (b) Do të përmbajë një total prej 2,000,000 pemësh;
- (c) KSHT - 7% mbi tokë;
- (d) KSHT - 12 % nëntokë;
- (e) I - 0.15;
- (f) Maksimumi - 2 Kate;

Referuar Projektit të PSNB (Planit Strategjik në Nivel Bashkie) të hartuar për Metrobosco-n apo Pyllin Orbital, ky i fundit përcaktohet si një instrument për frenimin e konsumit të tokës (i referohemi këtu asaj bujqësore dhe natyrore), frenimin e shpërhapjes urbane dhe identifikohet si kufiri fizik i zhvillimit dhe zgjerimit të sistemit urban në mjedisin natyror dhe gjysmë natyror. Ky kufi përkufizohet në terma ligjorë dhe teknikë si “Një brez me funksion natyralizimi, që do të lidhë parqet ekzistuese sub-urbane, zonat bujqësore, zonat pyjore dhe zonat përreth liqeneve”, duke përbërë kështu në vetvete një nga hapësirat e reja të gjelbra të Tiranës. Me një sipërfaqe prej 2,563.80 Ha, ky pyll konceptohet si një brez mbrojtës i cili do të ketë mundësi të bllokojë konsumin e tokës duke krijuar një unazë me pemë frutore, parqe, pyje me natyralizim të krijuar nga një brez përkufizues të kryeqytetit përbërë prej një sasive prej rreth 2 milionë pemësh.

- (1) Brez i gjelbër me thellësi maksimale 200 M dhe thellësi minimale 30 M;
- (2) Do të përmbajë një total prej afërsisht 2,000,000 pemësh;
- (3) KSHT - 50% mbi tokë për zhvillimet e parashikuara IE;
- (4) KSHT - 50% nëntokë;
- (5) Sipas rregullores së PPV-së;
- (6) Maksimumi - 3 Kate.

Për më tepër në pikën 3.2 të Nenit 3 thuhet që: “Lejohen të drejta zhvillimi në të gjitha përdorimet e sistemit urban për të gjitha njësitë në të cilat mbivendoset Pylli Orbital, sipas kushteve zhvillimore të përcaktuara nga PPV, me kushtin e zbatimit të rregullave të përcaktuara nga kjo rregullore për realizimin e Pyllit Orbital. Mbjellja e detyruar duhet të jetë realizuar sipas standardeve teknike të përcaktuara në këtë rregullore, me miratimin e *Aktit të Kontrollit “Për përfundimin e punimeve të karabinasë së strukturës”*. Në të gjitha njësitë ku mbivendoset strategjia e realizimit të Pyllit Orbital, nuk lejohet tejkallim i lartësisë mbi 3 kate. Ky rregull është i vlefshëm edhe në rastet e përfshirjes të instrumenteve zhvillimor të parashikuar sipas nenit 54 pika 4 të Rregullores Vendore. Në këto raste e drejta e zhvillimit do të jepet me kushtin e mbjelljes së pemëve për realizimin e Pyllit Orbital, të identifikuar sipas legjendës përkatëse të përcaktuar për të gjithë hapësirën territoriale në të cilën shtrihet, sipas *Hartës së mënyrave të ndërhyrjes në territor, Shtojca 3*, bashkëlidhur kësaj rregullore. Në të gjitha njësitë subjekt PDV ku do të propozohet konvertim i kategorisë së propozuar të përdorimit të tokës për realizimin e Pyllit Orbital sipas shtrirjes të kufirit të tij në *Hartën e Njësisve Strukturore që prek Pylli Orbital (Shtojca 5)* nëpërmjet PPP (partneriteteve publike private), standardet e kësaj rregulloreje do të aplikohen në PDV-të përkatëse. Në të gjitha rastet e kërkesave për zhvillim në përdorimet IE (Industri dhe Ekonomi) ku mbivendoset hapësira territoriale e shtrirjes së Pyllit Orbital, nuk lejohet zgjerim i KSHT-së më tepër se 50% e pronës. Në të gjitha rastet e kërkesave për zhvillim në përdorime të cilave u mbivendoset Pylli Orbital, nuk lejohet tejkallim i shfrytëzimit të nëntokës mbi 50% të sipërfaqes së parcelës të përfshirë për zhvillim.”

Sa më sipër, vlerësohet që PPV-ja në kombinim me Projektin Strategjik, lënë deri diku të interpretueshëm implementimin korrekt të Pyllit Orbital në territorin e qytetit të Tiranës. Thënë këtë, vazhdimi i projekteve të detajuara sektoriale, dhe implementimi i sipërfaqeve të gjelbra në pëlhurën urbane të qytetit të Tiranës, marrin rëndësi të madhe e konsiderohen një domosdoshmëri në kuadër të gjithë qasjeve në nivel ndërkombëtar e kombëtar. Është tashmë e ditur që nga historia sidomos e Tiranës, që territoret natyrore janë ato më vulnerabile në një zhvillim territorial e urban gjë që kërkon hartimin e instrumenteve dhe rregulloreve të forta për t’u realizuar e zbatuar me sukses, në të kundërt, presioni i ndërtimit që historikisht edhe në kontekste ndërkombëtare ka qenë i fuqishëm mund t’i kthejë të gjitha strategjitë e mirë menduara, në teorike.

4.2 Përcaktimi i Metodologjisë

Në kapitujt e mësipërm u përmend data baza e krijuar nga agjenci të ndryshme në KE, të cilat monitorojnë nëpërmjet hartave satelitore zhvillimet në territor. Një shërbim të tillë e ofron dhe “Copernicus” (<https://land.copernicus.eu/>) në bashkëpunim me AEM apo EEA. Ky monitorim realizohet periodikisht (çdo 3 vjet) për të gjithë vendet e Evropës nëpërmjet të dhënave të dërguara nga institucionet përgjegjëse, por dhe nëpërmjet marrjes së informacionit nga hartat satelitore e më pas i konvertuar si material digjital në sistemin GIS. I gjithë informacioni është i arritshëm e i përdorshëm nëpërmjet programeve si ArkGIS. I gjithë ky sistem i ngritur rezulton në një territor lehtësisht të kontrollueshëm.

Thënë sa më sipër, duke qenë se dhe kërkimi në këtë studim bazohet në analizën e zhvillimit të territorit, për më tepër thekson rëndësinë në një krijim të data bazës, analizimi i elementëve natyrorë, që referuar legjislacionit lokal do përkthehej në territor të përbërë nga sistemi natyror dhe sistemi ujore, përdorimi i hartave satelitore është vlerësuar i domosdoshëm. Si rrjedhim, për të realizuar këtë fazë të parë të analizës, përdorimi i Sistemit të Informacionit Gjeografik (sistemit GIS) është përzgjedhur si instrument për të ndërtuar data bazën, e më pas analizën.

4.3 GIS

Një Sistem Informacioni Gjeografik (SIG apo GIS) është një sistem i cili krijon, menaxhon, analizon, dhe hartëzon të gjitha llojet e të dhënave. GIS lidh të dhënat me një hartë satelitore, duke integruar të dhëna të vendndodhjes (ku objektet janë) me të gjitha llojet e informacionit nëpërmjet përshkrimeve (si janë objektet). Kjo siguron një “themel” për hartëzim dhe analizim që përdoret në shkencë dhe në çdo industri. GIS ndihmon përdoruesit të kuptojnë teksturat (patterns), marrëdhëniet, dhe kontekstin gjeografik. Përfitimet e këtij përdorimi, përfshijnë përmirësim të komunikimit dhe efikasitet të lartë, ashtu sikurse një menaxhim dhe vendimmarrje më të mirë (<https://www.esri.com/en-us/what-is-gis/overview>).

4.3.1 Burimi i të dhënave

Për të mbledhur këto informacione gjeo-hapësinore si burim kryesor në këtë kërkim është përdorur Gjeoportali Kombëtar (www.asig.gov.al) cili na jep mundësinë e të përdorimit të të dhënave gjeografike nga disa institucione, si të Ortofoto-ve që i përkasin periudhave e viteve të ndryshme kohore. Për këtë Gjeoportali, autoritet përgjegjës është ASIG. Të tjera të dhëna të rëndësishme për këtë lloj analize konsistojnë në të dhëna të popullsisë e shpërndarjen e saj në terren, me autoritet përgjegjës INSTAT (www.instat.gov.al). Për analizim janë marrë të dhëna të projeksionit të së ardhmes, referuar PPV-së së Bashkisë Tiranë, me autoritete përgjegjëse AKPT (www.planifikimi.gov.al) dhe Bashkia Tiranë (www.tirana.al). Këto të dhëna do të mund të përdoren në programin GIS duke i thërritur si shërbime, për t'i përdorur më pas për digjitalizim të informacionit satelitor, e për t'i eksportuar më pas në formate të ndryshme përpara përdorimit të tyre në analiza. Në këtë fazë të parë të studimit, janë renditur metadat për të dhënat të cilat janë përdorur më poshtë. Duhet theksuar që, që nga koha e fillimit të këtij studimi dhe fillimit të punës me hartografinë, e deri në përfundim të studimit, ka pasur përditësime të data bazës dhe hartografisë, por që sa më poshtë u vlerësuan dhe përbëjnë fillesën e studimit, nisur dhe nga fakte historike e periodiciteti i tyre, si sfond mbi të cilin u vendos të punohej e ndërtohej e gjithë data baza:

- (i) Hartë topografike italiane e skanuar, afërsisht hartë e pandryshuar deri në vitin 1944;
- (ii) Hartë topografike e ushtrisë, e vlerësuar si hartë e vitit 1984;
- (iii) Fotografim ajror i Skanuar 1994;
- (iv) Ortofoto e vitit 2007;

- (v) Ortofoto e vitit 2015;
- (vi) Ortofoto e vitit 2018;
Të dhëna të tjera të përdorura krahas hartave janë sa më poshtë:
- (vii) Shpërndarja e popullsisë për çdo KM², bazuar të dhënave të CENSUS-it të fundit të realizuar në vitin 2011, e vënë në dispozicion nga INSTAT;
- (viii) Përdorimi i Propozuar i Tokës bazuar në PPV-në e fundit të vitit 2017 për Bashkinë Tiranë.

4.4 Dinamika e shtrirjes urbane të qytetit të Tiranës (1944-2018)

Faza e parë e këtij studimi ka për qëllim (1) Kuptueshmërinë në kohë të zhvillimit të qytetit në drejtim të territoreve natyrore; dinamikën e këtij zhvillimi që nga momenti i prezencës së materialeve hartografike; (2) Kuptueshmërinë e prezencës së territoreve të lira (të pazëna me ndërtime); dinamikën në zënien e tyre; (3) Kuptueshmërinë e territoreve nën presionin e ndërtimit; dinamikën e zënies së tyre. Në këtë fazë, informacioni është hapësinor dhe do të mund të ndërtohet nëpërmjet thirrjes në GIS të hartave të ndryshme. Nëpërmjet hedhjes së informacionit, krijimit të hartave në GIS dhe vlerësimeve sasiore, tentohet të kuptohet lidhja e ndërsjellët mes elementëve të sipërpërmendur. Matjet janë realizuar për të gjithë vitet e listuar më sipër duke filluar nga momentet e para të pasurit të hartografisë. Kështu, marrja e informacionit nga hartat e ndërtimi i data bazës janë realizuar për vitet dhe hartat - 1928 (Hartë e skanuar italiane); 1944 (Hartë e skanuar); 1984 (Hartë topografike e ushtrisë); 1994 (Hartë Fotografike e Skanuar); 2007 (Ortofoto e këtij viti); 2015 (Ortofoto e këtij viti) dhe 2018 (Ortofoto e këtij viti).

4.4.1 Shtrirja urbane e qytetit të Tiranës afërsisht deri në vitin 1944 (Sipas hartës topografike italiane)





FIGURA 4.4.1.1 Hartë e Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 1944
Përpunoi: Autori

Shtirja urbane e qytetit të Tiranës (afërsisht) deri në vitin 1944

Nomenklatura	Sipërfaqe e Kategorisë (m ²)	Sipërfaqe e Nën-kategorisë (m ²)
Pëlhurë e vazhduar urbane	5 108 656,53	n/a
Pëlhurë e pa vazhduar urbane	104 508,86	n/a
Kantieri ndërtimi	n/a	n/a
Tokë pa ndonjë përdorim aktual	n/a	n/a

TABELA 4.4.1.1 Tabelë e vlerave të kategorive kryesore treguese të Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 1944
Përpunoi: Autori



- Pëlhurë e vazhduar urbane
- Pëlhurë e pa vazhduar urbane
- Kantieri ndërtimi
- Tokë pa ndonjë përdorim aktual

GRAFIKU 4.4.1.1 Grafik i raportit mes kategorive kryesore treguese të shtrirjes së pëlhurës urbane të qytetit të Tiranës deri afërsisht në vitin 1944
Përpunoi: Autori

4.4.2 Shtrirja urbane e qytetit të Tiranës afërsisht deri në vitin 1984 (Sipas hartës topografike të ushtrisë)





FIGURA 4.4.2.1 Hartë e Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 1984
Përpunoi: Autori

Shtrirja urbane e qytetit të Tiranës (afërsisht) deri në vitin 1984		
Nomenklatura	Sipërfaqe e Kategorisë (m ²)	Sipërfaqe e Nën-kategorisë (m ²)
Pëlhurë e vazhduar urbane	15 282 882,75	15 282 882,75
Pëlhurë e pa vazhduar urbane	10 847 781,29	10 847 781,29
Kantiere ndërtimi	n/a	n/a
Tokë pa ndonjë përdorim aktual	92 285,88	92 285,88

TABELA 4.4.2.1 Tabelë e vlerave të kategorive kryesore treguese të Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 1984
Përpunoi: Autori



GRAFIKU 4.4.2.1 Grafik i raportit mes kategorive kryesore treguese të shtrirjes së pëlhurës urbane të qytetit të Tiranës deri afërsisht në vitin 1984
Përpunoi: Autori

4.4.3 Shtrirja urbane e qytetit të Tiranës afërsisht deri në vitin 1994 (Sipas fotografimit ajror të skanuar; www.geoportal.asig.gov.al)





FIGURA 4.4.3.1 Hartë e Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 1994
Përpunoi: Autori

Shtirirja urbane e qytetit të Tiranës (afërsisht) deri në vitin 1994

Nomenklatura	Sipërfaqe e Kategorisë (m ²)	Sipërfaqe e Nën-kategorisë (m ²)
Pëlhurë e vazhduar urbane	22 415 061,56	22 415 061,56
Pëlhurë e pa vazhduar urbane	15 206 437,83	15 206 437,83
Kantiere ndërtimi	2 385 382,98	2 385 382,98
Tokë pa ndonjë përdorim aktual	1 912 476,46	1 912 476,46

TABELA 4.4.3.1 Tabelë e vlerave të kategorive kryesore treguese të Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 1994
Përpunoi: Autori



GRAFIKU 4.4.3.1 Grafik i raportit mes kategorive kryesore treguese të shtrirjes së pëlhurës urbane të qytetit të Tiranës deri afërsisht në vitin 1994
Përpunoi: Autori

4.4.4 Shtrirja urbane e qytetit të Tiranës afërsisht deri në vitin 2007 (Sipas Ortofoto-s; www.geoportal.asig.gov.al)





FIGURA 4.4.4.1 Hartë e Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 2007
Përpunoi: Autori

Shtrirja urbane e qytetit të Tiranës (afërsisht) deri në vitin 2007

Nomenklatura	Sipërfaqe e Kategorisë (m ²)	Sipërfaqe e Nën-kategorisë (m ²)
Pëlhurë e vazhduar urbane	69 522 904,86	69 522 904,86
Pëlhurë e pa vazhduar urbane	7 445 308,02	7 445 308,02
Kantiere ndërtimi	5 234,48	5 234,48
Tokë pa ndonjë përdorim aktual	8 885 963,94	8 885 963,94

TABELA 4.4.4.1 Tabelë e vlerave të kategorive kryesore treguese të Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 2007
Përpunoi: Autori



GRAFIKU 4.4.4.1 Grafik i raportit mes kategorive kryesore treguese të shtrirjes së pëlhurës urbane të qytetit të Tiranës deri afërsisht në vitin 2007
Përpunoi: Autori

4.4.5 Shtrirja urbane e qytetit të Tiranës afërsisht deri në vitin 2015 (Sipas Ortofoto-s; www.geoportal.asig.gov.al)




FIGURA 4.4.5.1 Hartë e Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 2015
Përpunoi: Autori

Shtirja urbane e qytetit të Tiranës (afërsisht) deri në vitin 2015

Nomenklatura	Sipërfaqe e Kategorisë (m ²)	Sipërfaqe e Nën-kategorisë (m ²)
Pëlhurë e vazhduar urbane	73 491 121,56	73 491 121,56
Pëlhurë e pa vazhduar urbane	11 571 305,44	11 571 305,44
Kantiere ndërtimi	50 579,51	50 579,51
Tokë pa ndonjë përdorim aktual	11 765 421,00	11 765 421,00

TABELA 4.4.5.1 Tabelë e vlerave të kategorive kryesore treguese të Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 2015
Përpunoi: Autori



- Pëlhurë e vazhduar urbane
- Pëlhurë e pa vazhduar urbane
- Kantiere ndërtimi
- Tokë pa ndonjë përdorim aktual

GRAFIKU 4.4.5.1 Grafik i raportit mes kategorive kryesore treguese të shtrirjes së pëlhurës urbane të qytetit të Tiranës deri afërsisht në vitin 2015
Përpunoi: Autori

4.4.6 Shtrirja urbane e qytetit të Tiranës afërsisht deri në vitin 2018 (Sipas Ortofoto-s; www.geoportal.asig.gov.al)




FIGURA 4.4.6.1 Hartë e Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 2018
Përpunoi: Autori

Shtirja urbane e qytetit të Tiranës (afërsisht) deri në vitin 2018


Nomenklatura	Sipërfaqe e Kategorisë (m ²)	Sipërfaqe e Nën-kategorisë (m ²)
Pëlhurë e vazhduar urbane	79 692 292,39	79 692 292,39
Pëlhurë e pa vazhduar urbane	42 135 811,79	42 135 811,79
Kantieri ndërtimi	1 197 109,54	1 197 109,54
Tokë pa ndonjë përdorim aktual	6 872 796,71	6 872 796,71

TABELA 4.4.6.1 Tabelë e vlerave të kategorive kryesore treguese të Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 2018
Përpunoi: Autori




GRAFIKU 4.4.6.1 Grafiki i raportit mes kategorive kryesore treguese të shtrirjes së pëlhurës urbane të qytetit të Tiranës deri afërsisht në vitin 2018
Përpunoi: Autori


4.4.7 Të kuptuarit e dinamikave dhe tendencave të së ardhmes në shtrirjen urbane të qytetit të Tiranës



GRAFIKU 4.4.7.1 Grafik i dinamikës së rritjes urbane në vite; Raportit mes kategorive kryesore treguese së pëlhurës urbane të qytetit të Tiranës për periudhën 1944 - 2018
Përpunoi: Autori



GRAFIKU 4.4.7.2 Grafik i dinamikës së rritjes urbane në vite; Raportit mes kategorive kryesore treguese së pëlhurës urbane të qytetit të Tiranës për periudhën 1944 - 2018
Përpunoi: Autori



GRAFIKU 4.4.7.3 Grafik i dinamikës së rritjes demografike urbane në vite; (Të dhënat janë improvizuar nga burime të ndryshme si AEM, INSTAT, Bashkia e Tiranës)
Përpunoi: Autori

5. Vlerësimi sasior i hapësirave publike të gjelbra urbane në Tiranë referuar kategorive dhe nën-kategorive kryesore (1984-2015)

Në fazën e parë të këtij studimi informacionet e nevojshme janë zonat hapësinore të gjelbra në territorin e Bashkisë Tiranë ndër vite, përcaktimi i kategorive të Mbulimit të Tokës | Përdorimit të Tokës (TABELA 5.2.1) të cilët do të maten, si dhe njehsimi i këtyre kategorive me termat apo emërtimet e përdorura në AU (Atlasin Urban). Për të mundësuar një referim në metodologji të matjeve dhe krahasim me kontekstin ndërkombëtar, është realizuar një përafrim i terminologjisë dhe simboleve, duke bërë një përafrim të termave të përdorur nga institucione të ndryshme, apo të përcaktuar në standarde ndërkombëtare (kryesisht evropiane). Themi që është përafrim pasi dhe në nivele ndërkombëtare nuk ka specifikime dhe përkufizime fikse, por koncepte të njëjta interpretohen në nivele lokale në varësi të kontekstit. Pavarësisht interpretimeve, është vlerësuar që një përafrim i terminologjive do të mund të përafronte dhe të bënte të krahasueshme kontekstin lokal me atë ndërkombëtar edhe rezultatet e matjeve, edhe pse është e pranuar që do të ketë një përmbajtje të një marzhë gabimi.

5.1 Metodologjia

Për sa i takon metodologjisë së punës, do të vijohet me të njëjtën metodologji dhe në vazhden e data bazës, tashmë të krijuar.

5.2 Hapësira e Gjelbër Urbane - HGJU (Urban Green Space - UGS)

Sipas shumë studimeve të zhvilluara nga organizata të ndryshme si OBSH-ja, por dhe literaturës së hasur, nuk ka një përkufizim fiks për sa i takon HGJU-së. **Në përgjithësi, me HGJU nënkuptohen sipërfaqe natyrore apo sipërfaqe me karakteristika natyrore.** Nën këtë klasifikim bëjnë pjesë duke filluar nga (1) Parqet publike; (2) Kopshtet publike; (3) Gjelbërimi që shoqëron brigjet e lumenjve; (4) Hapësira rekreative sportive; (5) Këndet e lojërave të fëmijëve, (6) Kopshte private; (7) Kopshtet gjysmë-private; (8) Tarracat e gjelbëruara; (9) Gjelbërimi i banesave private; por në të

njëjtën kohë nënkuptohen dhe elementë si: (10) Gjëlberimi rrugor apo (11) Sipërfaqet ujore duke përfshirë në to, nga një pellg ujor e deri në vija liqenore apo bregdetare.

NUMRI (Sipas kodifikimit të AU /Atlasi Urban)	Kategori	Nën - Kategori (Nën - Klasa)	KODI (i vendosur)	NOMENKLATURA (E kategorive dhe e nën-kategorive të përcaktuara në këtë studim referuar AU dhe metodologjisë së ndjekur mbi unifikimin e tyre.)
1				Sipërfaqe artificiale
1.1				Pëlhura urbane
1.1.1			10	Pëlhurë e vazhduar urbane
1.1.2			20	Pëlhurë e pa vazhduar urbane
1.3.3			30	Kantieri ndërtimi
1.3.4			40	Tokë pa ndonjë përdorim aktual
1.4.1			50	Hapësira të gjelbra urbane
			51	Parqe
			52	Kopshte dhe lulishte publike
			53	Kopsht botanik
			54	Kopsht zoologjik
			55	Gjëlberim rrugor
			56	Kopshte dhe lulishte gjysëm publike
			57	Kopshte private
5.0.0			60	Ujë
			61	Sipërfaqe pellgësh ujore (rezervuarë)
			62	Sipërfaqe lumenjsh
1.4.2			70	Objekte sportive e të kohës së lirë
2.0.0_4.0.0			80	Tokë agrikulturore; gjysëm-natyrore dhe zonat ligatinore
3.0.0			90	Pyje
			91	Pyje suburbane
			92	Zona natyrore suburbane

TABELA 5.2.1 Tabelë e përcaktimit të kodeve të kategorive e nën-kategorive të MT | PT
Përpunoi: Autori

Sipas Atlasit Urban (Urban Atlas) kodi 14100 përfshin hapësirat e gjelbra urbane të përdorura kryesisht për rekreacion. Nën këtë kategori mund të përmendim (1) Kopshtet; (2) Kopshtet zoologjike; (3) Parqet; (4) Sipërfaqet dhe pyjet sub-urbane natyrale; (5) Sipërfaqet e gjelbra në kufij të zonave urbane të cilat menaxhohen apo përdoren për qëllime rekreacioni. Në terma të politikë bërjes është e rëndësishme vendosja e fokusit në HGJU-në, hapësirë e cila është e hapur ndaj publikut në veçanti kur konsiderohen hapësira të gjelbra me qasje universale, pra hapësira të shfrytëzueshme nga të gjithë rezidentet e zonave urbane, pavarësisht nga rrethanat socio-ekonomike të tyre.

Për të bërë të mundur lidhjen dhe paralelizmin (deri diku) të klasifikimeve të përcaktuara nga AU, është realizuar një kodifikim i klasave të cilat do të konsiderohen në këtë studim. Do të duhet të theksojmë, që ky studim merret me HGJU-në me karakter publik dhe nuk hyn në terma të HGJU të blloqeve të banimit (referuar literaturës, por jo legjisllacionit lokal gjysmë-publike) apo të banesave private (referuar literaturës dhe legjisllacionit lokal - private).

5.3 Matje të kategorive dhe nën-kategorive të Mbulimit të Tokës | Përdorimit të Tokës, e në veçanti të hapësirave të gjelbra urbane në vitin 1984

Në figurat më poshtë janë ilustruar hartat e Mbulimit të Tokës | Përdorimit të Tokës për Tiranën, të punuara në ArcGIS në bazë të hartës topografike të ushtrisë, vënë në dispozicion nga www.geoportal.gov.al. Në hartën e parë janë identifikuar kategoritë kryesore të elementëve natyrorë, ndërsa në hartën e dytë janë identifikuar nën-kategoritë. Kjo me qëllim jo vetëm identifikimin në hapësirë të këtyre kategorive, por më pas për t'i kthyer ato në elementë të matshëm.




FIGURA 5.3.1 Hartë e kategorive të HGJU në vitin 1984

Përpunoi: Autori

FIGURA 5.3.2 Hartë e nën-kategorive të HGJU në vitin 1984

Përpunoi: Autori

Tabelë e vlerave të kategorive kryesore dhe nën-kategorive të tyre | Tregues kryesorë të Shtirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 1984 (Në analogji me treguesit e përcaktuar në Atlasin Urban, AEM)


Nomenklatura	Sipërfaqe e Kategorisë (m ²)	Sipërfaqe e Nën-kategorisë (m ²)	Popullsi
Pëlhurë e vazhduar urbane	22 415 061,56	22 415 061,56	
Pëlhurë e pa vazhduar urbane	15 206 437,83	15 206 437,83	
Kantieri ndërtimi	2 385 382,98	2 385 382,98	
Tokë pa ndonjë përdorim aktual	1 912 476,46	1 912 476,46	
Hapësira të gjelbra urbane	8 947 675,48		
Parqe		1 794 284,58	
Kopshte dhe lulishte publike		691 872,39	
Kopsht botanik		146 703,84	
Kopsht zoologjik		65 456,88	
Gjellbërim rrugor		n/a	
Kopshte dhe lulishte gjysmë publike		55 306,72	n/a
Kopshte private		n/a	
Ujë			
Sipërfaqe pellgësh ujore (rezervuarë)		2 087 507,76	
Sipërfaqe lumenjsh		4 106 543,31	
Objekte sportive e të kohës së lirë	322 424,62	322 424,62	
Tokë agrikuturore; gjysmë-natyrore dhe zonat ligatinore	170 630 668,21	170 630 668,21	
Pyje	109 530 868,04		
Pyje suburbane		82 860 886,37	
Zona natyrore suburbane		26 669 981,67	

TABELA 5.3.1 Tabelë e vlerave të kategorive kryesore dhe nën-kategorive treguese të Shtirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 1984

Përpunoi: Autori

5.3.1 Përmbledhje e rezultateve

Një panoramë më të qartë të vlerave numerike do të mund të krijojmë nëpërmjet grafikëve të mëposhtëm ku përkatësisht janë shprehur (1) Raportet mes kategorive kryesore të sipërfaqeve artificiale të (1.a) Pëlhurës Urbane; (1.b) Sipërfaqeve të vegjetacionit me karakter jo agrikulturë; (1.c) Sipërfaqeve me karakter gjysmë-natyror; (2) Raportet mes nën-kategorive të HGJU-së në rastin kur sipërfaqet ujore dhe objektet sportive e të kohës së lirë bëhen pjesë e llogaritjes në HGJU; (3) Raportet mes nën-kategorive të HGJU-së në rastin kur këto nuk bëhen pjesë e llogaritjeve.



GRAFIKU 5.3.1.1 Grafiku i raportit mes kategorive kryesore treguese të shtrirjes së pëlhurës urbane të qytetit të Tiranës deri afërsisht në vitin 1984
Përpunoi: Autori

Siç mund të shohim nga grafikët, pjesën më të madhe të HGJU për Tiranën e viteve '80 e përbëjnë parqet – “Parku i Liqenit Artificial” e një pjesë tjetër të madhe e zënë kopshtet dhe lulishtet publike, përgjithësisht të pozicionuar në akset kryesore të pëlhurës së qytetit, përkatësisht aksit të bulevardit “Dëshmorët e Kombit” dhe aksit përgjatë lumit Lana.

5.4 Matje të kategorive dhe nën-kategorive të Mbulimit të Tokës | Përdorimit të Tokës, e në veçanti të hapësirave të gjelbra urbane në vitin 1994

Në figurat më poshtë janë ilustruar hartat e Mbulimit të Tokës | Përdorimit të Tokës për Tiranën, të punuara në programin ArcGIS, në bazë të fotografimit ajror të skanuar, vënë në dispozicion nga www.geoportal.gov.al. Në hartën e parë janë identifikuar kategoritë kryesore të elementëve natyrore, ndërsa në hartën e dytë janë identifikuar nën-kategoritë. Kjo me qëllim jo vetëm identifikimin në hapësirë të këtyre kategorive, por më pas për t'i kthyer ato në elementë të matshëm.




FIGURA 5.4.1 Hartë e kategorive të HGJU në vitin 1994

Përpunoi: Autori

FIGURA 5.4.2 Hartë e nën-kategorive të HGJU në vitin 1994

Përpunoi: Autori

Tabelë e vlerave të kategorive kryesore dhe nën-kategorive të tyre | Tregues kryesorë të Shtirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 1994 (Në analogji me treguesit e përcaktuar në Atlasin Urban, AEM)


Nomenklatura	Sipërfaqe e Kategorisë (m ²)	Sipërfaqe e Nën-kategorisë (m ²)	Popullsi
Pëlhurë e vazhduar urbane	22 415 061,56	22 415 061,56	
Pëlhurë e pa vazhduar urbane	15 206 437,83	15 206 437,83	
Kantieri ndërtimi	2 385 382,98	2 385 382,98	
Tokë pa ndonjë përdorim aktual	1 912 476,46	1 912 476,46	
Hapësira të gjelbra urbane	8 947 675,48		
Parqe		1 794 284,58	
Kopshte dhe lulishte publike		691 872,39	
Kopsht botanik		146 703,84	
Kopsht zoologjik		65 456,88	
Gjelbërim rrugor		n/a	
Kopshte dhe lulishte gjysmë publike		55 306,72	n/a
Kopshte private		n/a	
Ujë			
Sipërfaqe pellgësh ujore (rezervuarë)		2 087 507,76	
Sipërfaqe lumenjsh		4 106 543,31	
Objekte sportive e të kohës së lirë	322 424,62	322 424,62	
Tokë agrikuturore; gjysmë-natyrore dhe zonat ligatinore	170 630 668,21	170 630 668,21	
Pyje	109 530 868,04		
Pyje suburbane		82 860 886,37	
Zona natyrore suburbane		26 669 981,67	

TABELA 5.4.1 Tabelë e vlerave të kategorive kryesore dhe nën-kategorive treguese të Shtirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 1994

Përpunoi: Autori

5.4.1 Përmbledhje e rezultateve

Një panoramë më të qartë të vlerave numerike do të mund të krijojmë nëpërmjet grafikëve të mëposhtëm ku përkatësisht janë shprehur (1) raportet mes kategorive kryesore të sipërfaqeve artificiale të (1.a) Pëlhurës Urbane; (1.b) Sipërfaqeve të vegjetacionit me karakter jo agrikulturë; (1.c) Sipërfaqeve me karakter gjysmë-natyor; (2) Raportet mes nën-kategorive të HGJU-së në rastin kur sipërfaqet ujore dhe objektet sportive e të kohës së lirë bëhen pjesë e llogaritjes së HGJU-së; (3) Raportet mes nën-kategorive të HGJU-së në rastin kur këto nuk bëhen pjesë e llogaritjeve.



GRAFIKU 5.4.1.1 Grafiki i raportit mes kategorive kryesore treguese të shtrirjes së pëlhurës urbane të qytetit të Tiranës deri afërsisht në vitin 1994
Përpunoi: Autori

Siç mund të shohim nga grafikët, pjesën më të madhe të HGJU-së për Tiranën e viteve '90 e përbëjnë parqet – “Parku i Liqenit Artificial” e një pjesë tjetër të madhe e zënë kopshtet dhe lulishtet publike, përgjithësisht të pozicionuar në akset kryesore të pëlhurës së qytetit, përkatësisht aksit të bulevardit “Dëshmorët e Kombit” dhe aksit përgjatë lumit Lana.

5.5 Matje të kategorive dhe nën-kategorive të Mbulimit të Tokës | Përdorimit të Tokës, e në veçanti të hapësirave të gjelbra urbane në vitin 2007

Në figurat më poshtë janë ilustruar hartat e Mbulimit të Tokës | Përdorimit të Tokës për Tiranën, të punuara në programin ArcGIS në bazë të Ortofoto-s së vënë në dispozicion nga www.geoportal.gov.al. Në hartën e parë janë identifikuar kategoritë kryesore të elementëve natyrorë, ndërsa në hartën e dytë janë identifikuar nën-kategoritë. Kjo me qëllim jo vetëm identifikimin në hapësirë të këtyre kategorive, por më pas për t'i kthyer ato në elementë të matshëm.




FIGURA 5.5.1 Hartë e kategorive të HGJU në vitin 2007

Përpunoi: Autori

FIGURA 5.5.2 Hartë e nën-kategorive të HGJU në vitin 2007

Përpunoi: Autori

Tabelë e vlerave të kategorive kryesore dhe nën-kategorive të tyre | Tregues kryesorë të Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 2007 (Në analogji me treguesit e përcaktuar në Atlasin Urban, AEM)

Nomenklatura	Sipërfaqe e Kategorisë (m ²)	Sipërfaqe e Nën-kategorisë (m ²)	Popullsi
Pëlhurë e vazhduar urbane	69 522 904,86	69 522 904,86	
Pëlhurë e pa vazhduar urbane	7 445 308,02	7 445 308,02	
Kantieri ndërtimi	5 234,48	5 234,48	
Tokë pa ndonjë përdorim aktual	8 885 963,94	8 885 963,94	
Hapësira të gjelbra urbane	7 657 384,93		
Parqe		1 416 715,80	
Kopshte dhe lulishte publike		392 797,79	
Kopsht botanik		146 703,86	
Kopsht zoologjik		65 456,88	
Gjelbërim rrugor		n/a	n/a
Kopshte dhe lulishte gjysmë publike		85 411,78	
Kopshte private		n/a	
Ujë	5 550 298,82		
Sipërfaqe pellgësh ujore (rezervuarë)		1 443 759,30	
Sipërfaqe lumenjsh		4 106 539,52	
Objekte sportive e të kohës së lirë	385 407,97	385 407,97	
Tokë agrikuturore; gjysmë-natyrore dhe zonat ligatinore	145 457 710,47	145 457 710,47	
Pyje	93 334 156,34		
Pyje suburbane		81 717 135,71	
Zona natyrore suburbane		11 617 020,63	


TABELA 5.5.1

Tabelë e vlerave të kategorive kryesore dhe nën-kategorive treguese të Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 2007

Përpunoi: Autori

5.5.1 Përmbledhje e rezultateve

Një panoramë më të qartë të vlerave numerike do të mund të krijojmë nëpërmjet grafikëve të mëposhtëm ku përkatësisht janë shprehur (1) raportet mes kategorive kryesore të sipërfaqeve artificiale të (1.a) Pëlhurës Urbane; (1.b) Sipërfaqeve të vegjetacionit me karakter jo agrikulturë; (1.c) Sipërfaqeve me karakter gjysmë- natyror; (2) Raportet mes nën-kategorive të HGJU-së në rastin kur sipërfaqet ujore dhe objektet sportive dhe të kohës së lirë bëhen pjesë e llogaritjes në HGJU; (3) Raportet mes nën-kategorive të HGJU-së në rastin kur këto nuk bëhen pjesë e llogaritjeve.



GRAFIKU 5.5.1.1 Grafik i raportit mes kategorive kryesore treguese të shtrirjes së pëlhurës urbane të qytetit të Tiranës deri afërsisht në vitin 2007
Përpunoi: Autori

Siç mund të shohim nga grafikët, pjesën më të madhe të HGJU për Tiranën e viteve 2000 e përbëjnë parqet – “Parku i Liqenit Artificial” e një pjesë tjetër të madhe e zënë kopshtet dhe lulishtet publike, përgjithësisht të pozicionuar në akset kryesore të pëlhurës së qytetit, përkatësisht aksit të bulevardit “Dëshmorët e Kombit” dhe aksit përgjatë lumit Lana.

5.6 Matje të kategorive dhe nën-kategorive të Mbulimit të Tokës | Përdorimit të Tokës, e në veçanti të hapësirave të gjelbra urbane në vitin 2015

Në figurat më poshtë, janë ilustruar hartat e Mbulimit të Tokës | Përdorimit të Tokës për Tiranën të punuara në programin ArcGIS, në bazë të Ortofoto-s së vënë në dispozicion nga www.geoportal.gov.al. Në hartën e parë, janë identifikuar kategoritë kryesore të elementëve natyrorë, ndërsa në hartën e dytë janë identifikuar nën-kategoritë. Kjo me qëllim jo vetëm identifikimin në hapësire të këtyre kategorive, por me pas kthimin e tyre në elementë të matshëm.




FIGURA 5.6.1 Hartë e kategorive të HGJU në vitin 2015

Përpunoi: Autori

FIGURA 5.6.2 Hartë e nën-kategorive të HGJU në vitin 2015

Përpunoi: Autori

Tabelë e vlerave të kategorive kryesore dhe nën-kategorive të tyre | Tregues kryesorë të Shtirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 2015 (Në analogji me treguesit e përcaktuar në Atlasin Urban, AEM)

Nomenklatura	Sipërfaqe e Kategorisë (m ²)	Sipërfaqe e Nën-kategorisë (m ²)	Popullsi (CENSUS 2011)
Pëlhurë e vazhduar urbane	73 491 121,56	73 491 121,56	
Pëlhurë e pa vazhduar urbane	11 571 305,44	11 571 305,44	
Kantieri ndërtimi	50 579,51	50 579,51	
Tokë pa ndonjë përdorim aktual	11 765 421,00	11 765 421,00	
Hapësira të gjelbra urbane	7 974 213,79		
Parqe		1 738 311,58	
Kopshte dhe lulishte publike		391 339,90	
Kopsht botanik		131 387,39	
Kopsht zoologjik		55 796,46	
Gjelbërim rrugor		n/a	
Kopshte dhe lulishte gjysmë publike		85 411,77	374 554
Kopshte private		n/a	
Ujë	5 571 966,68		
Sipërfaqe pellgësh ujore (rezervuarë)		1 544 668,66	
Sipërfaqe lumenjsh		4 027 298,02	
Objekte sportive e të kohës së lirë	297 440,49	297 440,49	
Tokë agrikulturore; gjysmë-natyrore dhe zonat ligatinore	176 254 152,84	176 254 152,84	
Pyje	50 927 093,54		
Pyje suburbane		39 468 235,34	
Zona natyrore suburbane		11 458 858,20	


TABELA 5.6.1

Tabelë e vlerave të kategorive kryesore dhe nën-kategorive treguese të Shtirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 2015

Përpunoi: Autori

5.6.1 Përmbledhje e rezultateve

Një panoramë më të qartë të vlerave numerike do të mund të krijojmë nëpërmjet grafikëve të mëposhtëm ku përkatësisht janë shprehur (1) Raportet mes kategorive kryesore të sipërfaqeve artificiale të (1.a) Pëlhurës Urbane; (1.b) Sipërfaqeve të vegjetacionit me karakter jo agrikulturë; (1.c) Sipërfaqeve me karakter gjysmë- natyror; (2) Raportet mes nën-kategorive të HGJU-së në rastin kur sipërfaqet ujore dhe objektet sportive e të kohës së lirë bëhen pjesë e llogaritjes në HGJU; (3) Raportet mes nën-kategorive të HGJU-së në rastin kur këto nuk bëhen pjesë e llogaritjeve.



GRAFIKU 5.6.1.1 Grafiku i raportit mes kategorive kryesore treguese të shtrirjes së pëlhurës urbane të qytetit të Tiranës deri afërsisht në vitin 2015
Përpunoi: Autori

Siç mund të shohim nga grafikët, pjesën më të madhe të HGJU-së për Tiranën rreth viteve 2015 e përbëjnë parqet – “Parku i Liqenit Artificial” e një pjesë tjetër të madhe

e zënë kopshtet dhe lulishtet publike, përgjithësisht të pozicionuar në akset kryesore të pëlhurës së qytetit, përkatësisht aksit të bulevardit “Dëshmorët e Kombit” dhe aksit përgjatë lumit Lan.

6. Vlerësimi sasior i hapësirave të gjelbra urbane në Tiranë referuar kategorive dhe nën-kategorive kryesore; Arritshmëria e tyre (2018)

Në ndryshim nga vitet e mëparshme, për vitin 2018, për të cilin do të vlerësohet edhe arritshmëria apo “akesibiliteti” i HGJU-së, analiza do të zhvillohet në dy raste. Rasti (1) Duke ruajtur të njëjtat kategori e nën-kategori dhe rasti (2) Duke shtuar një nën-kategori të re e cila përfaqësohet nga “Gjelbërimi Rrugor”. Jo të gjitha studimet e hasura mbi këtë temë e përfshijnë këtë komponent në llogaritjen e HGJU-së, për këtë arsye janë llogaritur e vlerësuar të dyja rastet, pikërisht për të krijuar një ide më të kompletuar e të qartë të kontributit që kjo nën-kategori ka në përmbushjen e nevojave të qytetit.

6.1 Metodologji

Metodologjia për sa i takon krijimit të hartave me kategoritë dhe nën-kategoritë e HGJU-së, është e njëjtë, me përjashtimin që këtu thirret dhe informacioni mbi Gjelbërimin Rrugor të vënë në dispozicion nga studime të mëparshme të ekzekutuara nga ing. Enxhi Masha, ekspert GIS-i. Për të ndërtuar këtë data bazë, referuar përshkrimit të autorit, është ndjekur metodologjia si më poshtë:

“Për të realizuar gjetjen e pemëve përgjatë rrugëve në qytetin e Tiranës, u përdor një metodë risi e cila integron Inteligjencën Artificiale (IA) me GIS. Për të realizuar këtë data bazë u përdor programi ArcGIS për trajnimin e një modeli AI i cili arrin të evidentojë nga Ortofoto (foto satelitore) kurorën e pemëve. Ky proces, kalon në 5 hapa kryesorë:

- (i) Përgatitja e të dhënave - Ky hap konsiston në krijimin dhe/ose mbledhjen e të dhënave dhe përgatitjen e tyre në format të përshtatshëm për përdorim në ML (Machine Learning). Në rastin tonë kemi marrë një imazh Ortofoto-je dhe kemi realizuar digjitalizimin e pemëve në atë zonë. Zona e përdorur konsiston në një sipërfaqe prej 0.38 Km², sipërfaqe në të cilën u digjitalizuan një numër prej 6,420 pemësh.
- (ii) Trajnimi i modelit - Nënkupton realizimin e një funksionaliteti specifik, qoftë ky për të realizuar parashikim, gjetjen e teksturave apo “patterns”, anomalive apo edhe gjetjen e objekteve. Këto modele që trajnojmë mund të jenë të mbikëqyrura, ose jo. Në rastin tonë, kemi realizuar trajnimin e modelit për afërsisht 57 orë, bazuar mbi pemët të cilat ne i digjitalizuam në hapin e mëparshëm, duke arritur një saktësi prej 81.9% në zonën urbane.

- (iii) Inference - është hapi në të cilin përdorim modelin e krijuar për të analizuar “Imazherinë” e Ortofoto-s. Në rastin tonë kemi realizuar analizimin e një territori prej 14.25 Km².
- (iv) Analizimi - Të dhënat krijohen për të realizuar një analizë të caktuar. Pra, procesi nuk ndalon vetëm me prodhimin e të dhënave nga një model ML, por këto të dhëna përdoren në analiza të ndryshme. Në rastin tonë të dhënat e krijuara u përdorën për të kuptuar sipërfaqen që mbulojnë kurorat e pemëve, indeksin e pemëve me popullsinë dhe indeksin e pemëve për rrugë. Në këtë hap, ne përdorem informacionin e prodhuar nga Plani i Përgjithshëm Vendor për sistemin rrugor dhe përzgjedhëm të gjithë pemët që ndodhen në një hapësirë prej 20 Metrash nga rruga. Kështu mundem të evidentonim vetëm pemët të cilat gjenden pranë rrugëve.
- (v) Shpërndarja:
Në këtë hap, rezultatet e analizës shpërndahen me palët e interesuara dhe vendimmarrësit duke përdorur shërbimet “web” si harta, aplikacione apo “dashboards”. Në rastin tonë kemi përdorur informacionin për të krijuar hartën e gjelbërimit rrugor më poshtë (FIGURA 6.1.1). Për ilustrim më të mirë, janë dhënë dhe disa fragmente të hartës së krijuar në (FIGURA 6.1.2).




FIGURA 6.1.1 Hartë e nën-kategorive të HGJU në vitin 2015
Burimi: Ing. E.Masha



FIGURA 6.1.2

Fragment_01 deri 04 i hartës së gjelbërimit rrugor,
referuar Ortofoto-s së vitit 2018
Burimi: E. Masha (Ekspert GIS); Përpunoi: Autori

6.2 Vlerësimi sasior i hapësirave të gjelbra urbane në Tiranë referuar kategorive dhe nën-kategorive kryesore; Arritshmëria e tyre (2018)




FIGURA 6.2.1 Hartë e kategorive të HGJU-së në vitin 2018
Përpunoi: Autori




FIGURA 6.2.2 Hartë e nën-kategorive të HGJU-së në vitin 2018
Përpunoi: Autori

Tabelë e vlerave të kategorive kryesore dhe nën-kategorive të tyre | Tregues kryesorë të Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 2018 (Në analogji me treguesit e përcaktuar në Atlasin Urban, AEM)

Nomenklatura	Sipërfaqe e Kategorisë (m ²)	Sipërfaqe e Nën-kategorisë (m ²)	Popullsi (Referuar BT, 2019)
Pëllhurë e vazhduar urbane	79 692 292,39	79 692 292,39	
Pëllhurë e pa vazhduar urbane	42 135 811,79	42 135 811,79	
Kantiere ndërtimi	1 197 109,54	1 197 109,54	
Tokë pa ndonjë përdorim aktual	6 872 796,71	6 872 796,71	
Hapësira të gjelbra urbane	7 948 499,14		
Parqe		1 713 319,99	
Kopshte dhe lulishte publike		365 694,86	
Kopsht botanik		132 732,64	
Kopsht zoologjik		61 201,17	
Gjelbërim rrugor			
Kopshte dhe lulishte gjysmë publike		76 147,53	681 065
Kopshte private		n/a	
Ujë	5 599 402,96		
Sipërfaqe pellgësh ujore (rezervuarë)		1 520 085,30	
Sipërfaqe lumenjsh		4 079 317,65	
Objekte sportive e të kohës së lirë	282 081,14	282 081,14	
Tokë agrikulturore; gjysmë-natyrore dhe zonat ligatinore	113 510 950,87	113 510 950,87	
Pyje	103 650 371,06		
Pyje suburbane		80 372 925,55	
Zona natyrore suburbane		23 277 445,50	

TABELA 6.2.1 Tabelë e vlerave të kategorive kryesore dhe nën-kategorive treguese të Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës dhe HGJU-së deri në vitin 2018 (Pa përfshirë gjelbërimin rrugor)
Përpunoi: Autori

Tabelë e vlerave të kategorive kryesore dhe nën-kategorive të tyre | Tregues kryesorë të Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës deri në vitin 2018 duke përfshirë edhe gjelbërimin rrugor (Në analogji me treguesit e përcaktuar në Atlasin Urban, AEM)


Nomenklatura	Sipërfaqe e Kategorisë (m ²)	Sipërfaqe e Nën-kategorisë (m ²)	Popullsi (Referuar BT, 2019)
Pëllhurë e vazhduar urbane	79 692 292,39	79 692 292,39	
Pëllhurë e pa vazhduar urbane	42 135 811,79	42 135 811,79	
Kantiere ndërtimi	1 197 109,54	1 197 109,54	
Tokë pa ndonjë përdorim aktual	6 872 796,71	6 872 796,71	
Hapësira të gjelbra urbane	9 765 787,25		
Parqe		1 713 319,99	
Kopshte dhe lulishte publike		365 694,86	
Kopsht botanik		132 732,64	
Kopsht zoologjik		61 201,17	
Gjelbërim rrugor		1 817 288,11	
Kopshte dhe lulishte gjysmë publike		76 147,53	681 065
Kopshte private		n/a	
Ujë	5 599 402,96		
Sipërfaqe pellgësh ujore (rezervuarë)		1 520 085,30	
Sipërfaqe lumenjsh		4 079 317,65	
Objekte sportive e të kohës së lirë	282 081,14	282 081,14	
Tokë agrikulturore; gjysmë-natyrore dhe zonat ligatinore	113 510 950,87	113 510 950,87	
Pyje	103 650 371,06		
Pyje suburbane		80 372 925,55	
Zona natyrore suburbane		23 277 445,50	

TABELA 6.2.2 Tabelë e vlerave të kategorive kryesore dhe nën-kategorive treguese të Shtrirjes Urbane të Qytetit të Tiranës dhe HGJU deri në vitin 2018 (Duke përfshirë gjelbërimin rrugor)
Përpunoi: Autori

6.2.1 Përmbledhje e rezultateve

Në grafikët më poshtë do të mund të kuptohen rezultatet në shifra të sasive për kategoritë dhe nën-kategoritë, sidomos të HGJU-së, përkatësisht në rastet kur (1) gjelbërimi rrugor nuk është konsideruar si pjesë e HGJU-së dhe (2) kur është konsideruar në përlllogaritje. Siç mund të vërehet nga rezultatet, ai përbën një pjesë shumë të rëndësishme në terma sasiorë duke qenë pothuaj i barasvlershëm në terma sasiorë me “Parkun e liqenit artificial”. Efekti që ky gjelbërim ka, sigurisht nuk është i njëjtë me atë të “Parkut të liqenit artificial” duke qenë i shpërndarë në të gjithë sipërfaqen e njësisë administrative të qytetit, thënë këtë, duke pasur një morfologji tjetër e rrjedhimisht edhe funksionalitet tjetër.

Pa Gjelbërim Rrugor | Me Gjelbërim Rrugor



GRAFIKU 6.2.1

Grafik i raportit mes kategorive kryesore treguese të shtrirjes së pëlhurës urbane të qytetit të Tiranës deri afërsisht në vitin 2018, duke mos konsideruar dhe konsideruar gjelbërimin rrugor si pjesë të HGJU-së

Përpunoi: Autori

Nëpërmjet metodës së përdorur, është vlerësuar edhe sasia e pemëve pjesëmarrëse në këtë gjelbërim (në total rezultojnë një sasi prej 79,818 pemësh), duke dhënë në këtë mënyrë mundësinë e llogaritjeve edhe për sa i takon numrit të Pemëve / Banor të qytetit, e për t'u bërë gjithmonë instrument krahasimi me modele të tjera evropiane.

6.3 “Aksesibiliteti” apo arritshmëria e HGJU-së

6.3.1 Metodologjia

Për të bërë të mundur llogaritjen e “aksesibilitetit” do të duhet të kuptojmë se çfarë parametri do të duhet të vlerësohet. Referuar literaturës e studimeve të ndryshme, me “aksesibilitet” i jemi referuar praktikisht popullsisë që gjendet (1) Në një rreze të caktuar; (2) Nga një dimension i caktuar i HGJU-së. Referuar standardeve të KE-së, HGJU-të do të duhet të jenë të shpërndara njëtrajtësisht, e të jenë të aksesueshme, të arritshme nga e gjithë popullata e një zone urbane. Edhe në këtë fazë të analizës është vlerësuar programi “ArcGIS” si instrumenti i përshtatshëm i cili do të realizojë analizimin mes (1) data bazës së ndërtuar të HGJU-ve të ndërtuara dhe (2) përdorimit të hartës së shtrirjes së Popullsisë.

Kjo e fundit është siguruar nga INSTAT dhe është një popullsi në shtrirje, që vjen në formën e rrjetit kuadratik, 1 Km x Km, ku çdo katror ka një densitet të caktuar të popullsisë. Normalisht edhe të dhënat që do të përpunohen do të mund të jenë të detajuara në shkallën e detajimit të informacionit që mbart ky rrjet kuadratik. Në studime të ndryshme të hasura, në vendet e zhvilluara krijimi i data bazave mbi popullsinë në rrjete kuadratike është i një saktësie më të madhe. P.sh. në Gjermani, në land-e të veçanta ky rrjet është 100 m x 100 m, duke rezultuar në një sistem më të saktë për sa i takon data bazës së krijuar, e më pas çdo analize të realizuar.

Pavarësisht saktësisë së të dhënave, edhe për faktin që përkojnë me periudhën e hartimit të CENSUS 2011, ajo e cila ky punim tenton të realizojë është prezantimi i metodologjisë dhe mënyrës së përlllogaritjes së këtyre të dhënave, por dhe kuptueshmëria e një trend-i të përgjithshëm të mënyrës se si hapësirat e gjelbra janë të shpërndara në strukturën urbane dhe se sa në vija të përgjithshme popullsia e kryeqytetit qaset ndaj këtyre hapësirave, referuaruar mënyrave e metodave ndërkombëtare të përlllogaritjes.

Në aspektin teorik është me interes të citojme sa më poshtë:

Do të duhet të kuptojmë që me zhvillimin e strategjive për Qytetet e Jetueshme, qasja ndaj shërbimeve është një prej elementëve shumë të rëndësishëm. Krahas kësaj, ka evidenca të cilat mbështesin faktin se sa më e madhe të jetë një hapësirë e gjelbër, aq më tepër njerëzit do ta përdorin atë. Nuk është një surprizë, pasi një sipërfaqe më e madhe e hapësirës së gjelbër me shumë ngjasë ofron një gamë më të gjerë funksionesh, eksperiencash dhe aktivitetesh për banorët e grupeve të ndryshme, stativeve të ndryshme socio-ekonomike dhe interesave, krahasuar me hapësira të vogla të gjelbra. (De Oliveira, 2017).

Është e dokumentuar gjithashtu se përdorimi i hapësirës së gjelbër është funksion direkt i afërsisë dhe mundësisë së qasjes së banorëve ndaj hapësirave të gjelbra. Një studim

në Danimarkë ka treguar se kishte një ulje në frekuencën e frekuentimit të tyre mbi 100-300 m e para, më pas grafiku tenton të jetë konstant me gjithë rritjen e distancës nga sipërfaqet e gjelbra. Marrëdhënia është kaq direkte, sa distanca nga sipërfaqet e gjelbra u konsiderua të ishte një parashikues shumë më i mirë i nivelit të stresit, krahasuar me përdorimin real të hapësirave të gjelbra. (De Oliveira, 2017).

Në qytetet Suedeze, u gjet se banorët të cilët banojnë 50 M, apo më pak nga hapësirat e gjelbra, e vizitojnë zakonisht hapësirën e hapur të gjelbër të paktën 3-4 herë në javë, ndërsa ato me një distancë 300 M i vizitojnë mesatarisht 2,7 herë në javë. Nëse distanca do të ishte 1,000 M, të tilla hapësira do të vizitoheshin vetëm 1 herë në javë.

Një marrëdhënie e ngjashme është gjetur edhe mes përdorimit të hapësirave të gjelbra dhe afërsisë së tyre. Në UK rekomandohet që hapësirat e gjelbra do të duhet të jenë në një distancë 300 M nga çdo banesë e personave të moshuar. Nuk ka nevojë të nënvizohet se cilësia e hapësirave të gjelbra është një faktor kyç në përdorimin e tyre. (De Oliveira, 2017)




FIGURA 6.3.11 Hartë e shtrirjes së Popullsisë sipas CENSUS 2011
(Në rrjetin 1 Km x 1 Km)
Burimi: INSTAT
Përpunoi: Autori

Në ditët e sotme, në vendet e zhvilluara nuk rezulton të ketë një standard fiks që përcakton sasinë e gjelbërimit për banor në procesin e planifikimit. Kjo sjell që dhe qytete të ndryshme të kenë qasje të ndryshme për sa i takon prezencës ose jo të sistemeve natyrore dhe gjysmë-natyrore referuar edhe karakteristikave të tyre klimaterike, politikave në nivele lokale, etj. Më poshtë do të mund të trajtojmë disa referenca të cilat janë konsideruar në realizimin e matjeve në kontekstin e Tiranës.

6.3.2 Referenca mbi distancat e rekomanduara për çdo dimension të HGJU-së

Shkalla	Distanca Maksimale (M)	Sip. Hapësirë e Hapur (Ha)	M ² /B
Banesa	250 M	< 1 Ha	4
Bllok	500 M	1.1 - 10 Ha	6
Lagje	1,000 M	10 - 40 Ha	7
Qytet	5,000 M	> 40 Ha	8

TABELA 6.3.2.1 Hapësira e rekreacionit sipas udhëzuesve të SenStadtUm 2013;
Burimi: (Bott, Grassl, & Anders, 2017)

Tipi i Parkut	Rrezja e Shërbimit (M)	Madhësia (Ha)
Mini Parku	> 400 M	0.25 Ha - 0.40 Ha
Park Lagje	400 M - 800 M	2.00 Ha – 4.00 Ha
Park Komuniteti	800 M – 4,800 M	12.0 ha – 20.0 ha
Park i Madh Urban	1 / qytet	Min. 20 Ha; Preferohet 30 Ha
Zonë Natyrore e Ruajtur	Nuk ka rekomandim.	Nuk ka rekomandim.
Kompleks Sportiv	Një për qytet.	Min. 10 Ha; Preferohet 16-32 Ha

TABELA 6.3.2.2 Standardet Kombëtare të Shoqatës së Rekreacionit dhe Parqeve, SHBA
Burimi: (Austin, 2014)

Tipi i Parkut	Rrezja e Shërbimit (M)	Madhësia (Ha)
Lagje	300 M	2 Ha
Komunitet	2,000 M	20 Ha
Park i Madh Urban	3,000 M	100 Ha
Rajonal	10,000 M	500 Ha
Zonë e Ruajtur Natyrore		1 Ha për çdo rritje me 1,000 banorë

TABELA 6.3.2.3 Standardet ANGS-t në Mbretërinë e Bashkuar
Burimi: (Austin, 2014)

Më konkretisht, referuar literaturës së sipërpërmendur janë përcaktuar për t'u konsideruar në këtë studim, të dhënat si më poshtë (TABELA 6.3.2.4):

Tipi i HGJU-së	Rrezja e Shërbimit (M)	Madhësia (Ha)
Të gjitha	250 M	Çdo lloj dimensiononi në Ha (të gjitha Sipërfaqet e HGJU-së) Pa përfshirë gjelbërimin rrugor;
Të gjitha	250 M	Çdo lloj dimensiononi në Ha (të gjitha Sipërfaqet e HGJU-së) Duke përfshirë gjelbërimin rrugor;
Të gjitha	250 M	< 1 Ha (të gjitha Sipërfaqet e HGJU-së) Pa përfshirë gjelbërimin rrugor;
Të gjitha	250 M	< 1 Ha (të gjitha Sipërfaqet e HGJU-së) Duke përfshirë gjelbërimin rrugor;
Të gjitha	500 M	1-10 Ha (të gjitha Sipërfaqet e HGJU-së) Pa përfshirë gjelbërimin rrugor;
Të gjitha	1,000 M	10-40 Ha (të gjitha Sipërfaqet e HGJU-së) Pa përfshirë gjelbërimin rrugor;
Të gjitha	5,000 M	> 40 Ha (të gjitha Sipërfaqet e HGJU-së) Pa përfshirë gjelbërimin rrugor;

TABELA 6.3.2.4

Përcaktimi i të dhënave në bazë të së cilave do të studiohet aksesibiliteti i HGJU-ve për qytetin e Tiranës; Databazë e përpunuar mbi hartën e vitit 2018
Burimi: Autori

6.4 Harta të zonave që kanë qasje (akses) në kategoritë dhe nën-kategoritë e HGJU-së në distancën 250 M (pa përfshirë gjelbërimin rrugor)




FIGURA 6.4.1 Hartë e rrezes së shërbimit në distancën 250 M për Hapësira të Gjelbra Urbane sipas kategorisë kryesore (pa gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori




FIGURA 6.4.2 Hartë e rrezes së shërbimit në distancën 250 M për Hapësira të Gjelbra Urbane sipas nën-kategorive (pa gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori

6.5 Harta të zonave që kanë qasje (akses) në kategoritë dhe nën-kategoritë e HGJU-së në distancën 250 M (duke përfshirë gjelbërimin rrugor)




FIGURA 6.5.1 Hartë e rrezes së shërbimit në distancën 250 M për Hapësira të Gjelbra Urbane sipas kategorisë kryesore (me gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori




FIGURA 6.5.2 Hartë e rrezes së shërbimit në distancën 250 M për Hapësira të Gjelbra Urbane sipas nën-kategorive (me gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori

6.6 Harta e shtrirjes së Popullsisë që ka qasje (akses) në kategoritë dhe nën-kategoritë e HGJU-së në distancën 250 M




FIGURA 6.6.1 Popullsia në distancë 250 M nga Hapësirat e Gjelbra Urbane (pa gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori




FIGURA 6.6.2 Popullsia në distancë 250 M nga Hapësirat e Gjelbra Urbane (me gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori

6.7 Harta e zonave që kanë qasje “akses” në kategorinë dhe nën-kategorinë e HGJU-së < 1 Ha në distancën 250 M (pa përfshirë gjelbërimin rrugor)




FIGURA 6.7.1 Hartë e rrezes së shërbimit në distancën 250 M për Hapësira të Gjelbra Urbane < 1 Ha sipas kategorisë kryesore (pa gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori




FIGURA 6.7.2 Hartë e rrezes së shërbimit në distancën 250 M për Hapësira të Gjelbra Urbane < 1 Ha sipas nën-kategorive (pa gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori

6.8 Harta e zonave që kanë qasje (akses) në kategorinë dhe nën-kategorinë e HGJU-së < 1 Ha në distancën 250 M (duke përfshirë gjelbërimin rrugor)




FIGURA 6.8.1 Popullsia në distancë 250 M nga Hapësirat e Gjelbra Urbane < 1 Ha (me gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori




FIGURA 6.8.2 Hartë e rrezes së shërbimit në distancën 250 M për Hapësira të Gjelbra Urbane < 1 Ha sipas kategorisë kryesore (me gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori

6.9 Harta e shtrirjes së popullsisë që ka qasje (akses) në kategorinë dhe nën-kategorinë e HGJU-së < 1 Ha në distancën 250 M (pa dhe me gjelbërimin rrugor)



FIGURA 6.9.1

Hartë e rrezes së shërbimit në distancën 250 M për Hapësira të Gjelbra Urbane < 1 Ha sipas nën-kategorive (pa gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori




FIGURA 6.9.2

Popullsia në distancë 250 M nga Hapësirat e Gjelbra Urbane < 1 Ha (me gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori

6.10 Harta e zonave që kanë qasje (akses) në kategorinë dhe nën-kategorinë e HGJU-së < 10 Ha në distancën 500 M




FIGURA 6.10.1 Hartë e rrezes së shërbimit në distancën 500 M për Hapësira të Gjelbra Urbane < 10 Ha sipas kategorisë kryesore (pa gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori




FIGURA 6.10.2 Hartë e rrezes së shërbimit në distancën 500 M për Hapësira të Gjelbra Urbane < 10 Ha sipas nën-kategorive (pa gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori

6.11 Harta e shtrirjes së popullsisë që kanë qasje (akses) në kategorinë dhe nën-kategorinë e HGJU-së < 10 Ha në distancën 500 M; HGJU < 40 Ha në distancë 1000 M




FIGURA 6.11.1 Popullsia në distancë 250 M nga Hapësirat e Gjelbra Urbane < 1 Ha (me gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori




FIGURA 6.11.2 Popullsia në distancë 1000 M nga Hapësirat e Gjelbra Urbane < 40 Ha (pa gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori

6.12 Harta e zonave që kanë qasje (akses) në kategorinë dhe nën-kategoritë e HGJU-së < 40 Ha në distancën 1000 M




FIGURA 6.12.1 Hartë e rrezes së shërbimit në distancën 1000 M për Hapësira të Gjelbra Urbane < 40 Ha sipas kategorisë kryesore (pa gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori




FIGURA 6.12.2 Hartë e rrezes së shërbimit në distancën 1000 M për Hapësira të Gjelbra Urbane < 40 Ha sipas nën-kategorive (pa gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori

6.13 Harta e zonave që kanë qasje (akses) në kategorinë dhe nën-kategorinë e HGJU-së > 40 Ha në distancën 5,000 M




FIGURA 6.13.1 Hartë e rrezes së shërbimit në distancën 5,000 M për Hapësira të Gjelbra Urbane > 40 Ha sipas kategorisë kryesore (pa gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori




FIGURA 6.13.2 Hartë e rrezes së shërbimit në distancën 5,000 M për Hapësira të Gjelbra Urbane > 40 Ha sipas nën-kategorive (pa gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori

6.14 Harta e shtrirjes së popullsisë që ka qasje (akses) në kategorinë dhe nën-kategoritë e HGJU-së > 40 Ha në distancën 5,000 M




FIGURA 6.14.1 Popullsia në distancë 5,000 M nga Hapësirat e Gjelbra Urbane > 40 Ha (pa gjelbërimin rrugor), viti 2018
Përpunoi: Autori

6.15 Përmbledhje e rezultateve

Në tabelat 6.3.2.5; 6.3.2.6 dhe 6.3.2.7 është bërë një përmbledhje e të gjithë rezultateve të nxjerra nga hartat dhe analizimi i tyre në “ArcGIS”, të cilat më pas jo vetëm që mund të analizohen grafikisht mbi mënyrën e shpërndarjes së HGJU-ve në teksturën e qytetit, por të dhënat mund të krahasohen përkatësisht me (1) Popullsinë e konsideruar në zhvillimin e analizave, referuar zonës së studimit sipas CENSUS 2011; (2) Popullsinë brenda kufijve administrativë të qytetit të Tiranës sipas CENSUS 2011; (3) Popullsinë e qytetit të Tiranës sipas të dhënave të marra nga Bashkia Tiranë. Në këto tabela jepen të dhënat si më poshtë:

1. Sipërfaqes referuese të tyre - tipit apo dimensionit;
(rezultat i përpunimit të referencave ndërkombëtare);
2. Rreze e shërbimit të dimensioneve specifike, përzgjedhur në bazë të referencave ndërkombëtare;
3. Sipërfaqes apo zonës së mbuluar nga rrezja e shërbimit (ne M² dhe Ha);
(normalisht atyre të hedhura në data bazë);
4. Popullsisë që ka akses apo qaset ndaj këtyre hapësirave të gjelbra;

Siç u përmend në kapitujt e mësipërm popullsia e analizuar është ajo që mund të gjeneronim, e që përkon me të dhënat e CENSUS 2011. Në mungesë të të dhënave të sakta në nivel bashkie, njësie administrative, apo shpërndarje populsi në rrjet kuadratik (1 Km x 1 Km) tabelës së mëposhtme i janë bashkëlidhur dhe të dhëna të

tjera të popullsisë, që pavarësisht pasaktësive që mund të përmbajnë përsëri ndihmojnë në krijimin e një prirjeje apo trend-i të përafërt mbi aksesibilitetin e banorëve të qytetit të Tiranës ndaj hapësirave të gjelbra të dimensioneve të ndryshme, në distancën e rekomanduar për përdorim të saj. Në këtë tabelë vihet re që referuar rekomandimeve dhe standarteve ndërkombëtare mbi distancat e pozicionimit të tipeve të ndryshme të HGJU-ve, e gjithë popullsia, 100% ka akses në sipërfaqe të gjelbra nëse përfshihet dhe gjelbërimi rrugor. Situata ndryshon me mos përfshirjen e tij, ku vetëm 37.29% e popullsisë ka akses në sipërfaqet e gjelbra në një distancë 250 M nga vendbanimi i tij. Për sipërfaqet 1-10 Ha është konsideruar një rreze prej 500 M, pra një rreze më e madhe shërbimi.

Sipërfaqe e Hapësirës së Gjelbër Urbane	Rrezja e Shërbimit - Vijë e drejtë (M)	Sipërfaqe e mbuluar me shërbim (M ²)	Sipërfaqe e mbuluar me shërbim (Ha)	Numri i banorëve që ka akses në HGJU (sipas hartës CENSUS 2011)	Numri TOTAL i banorëve për zonën e marrë në studim sipas CENSUS 2011	Numri i banorëve që ka akses në HGJU (e shprehur ne %)
Të gjitha Sipërfaqet e HGJU-së	250	91 470 260,00	9 147,03	491 153	491 153	100%
				<i>Me Gjelbërimin Rrugor</i>		
Të gjitha Sipërfaqet e HGJU-së	250	58 303 605,00	5 830,36	183 155	491 153	37%
				<i>Pa Gjelbërimin Rrugor</i>		
Sipërfaqe < 1 Ha	250	52 884 777,00	5 288,48	467 816	491 153	95%
				<i>Me Gjelbërimin Rrugor</i>		
Sipërfaqe < 1 Ha	250	3 697 404,00	369,74	26 705	491 153	5%
				<i>Pa Gjelbërimin Rrugor</i>		
Sipërfaqe 1 Ha - 10 Ha	500	39 789 562,00	3 978,96	205 454	491 153	42%
Sipërfaqe 10 Ha - 40 Ha	1 000	32 190 144,00	3 219,01	78 056	491 153	16%
Sipërfaqe > 40 Ha	5 000	379 789 037,00	37 978,90	603 070	491 153	123%

TABELA 6.15.1 Tabelë Përmbledhëse e rezultateve mbi aksesibilitetin e HGJU-ve Popullsia e Tiranës - Zona e marrë në studim sipas CENSUS 2011 Burimi: Autori

Referuar rezultateve, vetëm 41.83% e popullsisë kanë akses ndaj tyre. Ndërsa për sipërfaqet 10 Ha deri 40 Ha, 15.89 % e popullsisë kanë mundësinë e aksesit të tyre në një distancë deri në 1000 M. Sipërfaqet më të mëdha në një distancë më të madhe, janë të aksesueshme nga të gjithë.

Në të dy tabelat e mëposhtme përkatësisht TABELA 6.3.2.6 dhe TABELA 6.3.2.7 janë evidentuar të njëjtat rezultate, por duke i vënë përballë siç u përmend më sipër të dhëna të tjera të popullsisë të Tiranës, referuar këto burimeve të ndryshme.

Sipërfaqe e Hapësirës së Gjelbër-Urbane	Rrezja e Sherbimit - Vijë e drejtë (M)	Sipërfaqe e mbuluar me shërbim (M ²)	Sipërfaqe e mbuluar me shërbim (Ha)	Numri i banorëve që ka akses në HGJU (sipas hartës CENSUS 2011)	Numri TOTAL i banorëve për Njësinë Administrative Tiranë sipas CENSUS 2011	Numri i banorëve që ka akses në HGJU (e shprehur ne %)
Të gjitha Sipërfaqet e HGJU-së	250	91 470 260,00	9 147,03	491 153	374 554	131%
				<i>Me Gjelbërimin Rrugor</i>		
Të gjitha Sipërfaqet e HGJU-së	250	58 303 605,00	5 830,36	183 155	374 554	49%
				<i>Pa Gjelbërimin Rrugor</i>		
Sipërfaqe < 1 Ha	250	52 884 777,00	5 288,48	467 816	374 554	125%
				<i>Me Gjelbërimin Rrugor</i>		
Sipërfaqe < 1 Ha	250	3 697 404,00	369,74	26 705	374 554	7%
				<i>Pa Gjelbërimin Rrugor</i>		
Sipërfaqe 1 Ha - 10 Ha	500	39 789 562,00	3 978,96	205 454	374 554	55%
Sipërfaqe 10 Ha - 40 Ha	1 000	32 190 144,00	3 219,01	78 056	374 554	21%
Sipërfaqe > 40 Ha	5 000	379 789 037,00	37 978,90	603 070	374 554	161%

TABELA 6.15.2 Tabelë Përmbledhëse e rezultateve mbi aksesibilitetin e HGJU-ve Popullsia e Tiranës - Brenda kufijve administrativë të qytetit sipas CENSUS 2011
Burimi: Autori

Sipërfaqe e Hapësirës së Gjellbër Urbane	Rrezja e Sherbimit - Vijë e drejtë (M)	Sipërfaqe e mbuluar me shërbim (M ²)	Sipërfaqe e mbuluar me shërbim (Ha)	Numri i banorëve që ka akses në HGJU (sipas hartës CENSUS 2011)	Numri TOTAL i banorëve sipas Bashkisë Tiranë, 2019	Numri i banorëve që ka akses në HGJU (e shprehur në %)
Të gjitha Sipërfaqet e HGJU-së	250	91 470 260,00	9 147,03	491 153	681 065	72%
<i>Me Gjellbërimin Rrugor</i>						
Të gjitha Sipërfaqet e HGJU-së	250	58 303 605,00	5 830,36	183 155	681 065	27%
<i>Pa Gjellbërimin Rrugor</i>						
Sipërfaqe < 1 Ha	250	52 884 777,00	5 288,48	467 816	681 065	69%
<i>Me Gjellbërimin Rrugor</i>						
Sipërfaqe < 1 Ha	250	3 697 404,00	369,74	26 705	681 065	4%
<i>Pa Gjellbërimin Rrugor</i>						
Sipërfaqe 1 Ha - 10 Ha	500	39 789 562,00	3 978,96	205 454	681 065	30%
Sipërfaqe 10 Ha - 40 Ha	1 000	32 190 144,00	3 219,01	78 056	681 065	11%
Sipërfaqe > 40 Ha	5 000	379 789 037,00	37 978,90	603 070	681 065	89%

TABELA 6.15.3 Tabelë Përmbledhëse e rezultateve mbi aksesibilitetin e HGJU-ve Popullsia e Tiranës sipas të dhënave të Bashkisë Tiranë, 2019
Burimi: Autori

Pavarësisht të dhënave të ndryshme të popullsisë, rezultatet tregojnë trende të ngjashëm për dimensionet e HGJU-ve të marra në konsideratë dhe të hedhura në këtë data bazë. Ndjeshëm popullsia e qytetit të Tiranës nuk ka të mundur aksesin në distanca të rekomandueshme ndaj hapësirave të gjelbra urbane sidomos atyre me dimensione < 1 Ha dhe 10 Ha - 40 Ha.

Në rastet kur gjellbërimi rrugor është konsideruar, në pamje të parë duket sikur popullsia ka akses të mjaftueshëm përkundrejt HGJU-ve, por a mund të ofrojnë efekte të ngjashme të kohezionit social ky lloj vegjetacioni? Sigurisht që jo! Por për efekt studimi do të duhej të bëhej një vlerësim i këtij lloji.

6.16 Vlerësimi i sasive të HGJU për banor sipas disa te dhënave të BTR

Në hartat treguar përkatësisht në FIGURËN 6.15.1; 6.15.2 dhe 6.15.3 përsëri në “ArcGIS” janë analizuar të dhënat e gjeneruara nga databaza e ndërtuar, tashmë duke u interpretuar si shpërndarje e (1) Sipërfaqes totale të njësisë, (2) Popullsisë së njësisë administrative; (3) Sipërfaqes së HGJU-së për banor; (4) Sipërfaqe totale e HGJU-së për njësi administrative.

Ky është një interpretim grafik i të dhënave statistikore të gjeneruara i cili krijon një ide të qartë të shpërndarjes në territor të parametrave të mësipërm. Nëpërmjet këtyre hartave kuptohet jo vetëm gjendja e përgjithshme e njësisë administrative të Tiranës, por dhe marrëdhënia që gjendet mes njësive më të vogla 1-11. Në aspektin grafik kuptohet që njësitë 05 dhe 07 janë njësitë me popullsinë më të madhe, por që njësia me sasinë më të madhe të gjelbërimit dhe të M² gjelbërim / banor është njësia 07. Është e kuptueshme që kjo vjen nga prezenca e Parkut të Liqenit Artificial.

Njësitë me numër të vogël banorësh rezultojnë të jenë njësitë 01, 03, 08 dhe 10 ndërkohë që njësitë me sipërfaqe më të vogël HGJU-së rezultojnë të jenë njësitë 03 dhe 08. Njësitë me sipërfaqe më të vogël HGJU / Banor rezultojnë të jenë njësitë 03, 08 dhe 09. Një interpretim mund të lidhej me faktin që këto njësi karakterizohen nga ndërtesa të tipit banesa individuale formale dhe/apo informale, morfologji e cila përmban densitet të ulët të popullsisë dhe nuk karakterizohen nga prezenca e HGJU-ve me karakter publik (objekt i këtij studimi) ndonëse mund të karakterizohen nga prezenca e gjelbërimit në oborre.




FIGURA 6.16.1

Popullsia e shpërndarë sipas njësive administrative të qytetit të Tiranës, 2019

Burimi: Bashkia Tiranë

Përpunoi: Autori




FIGURA 6.16.2 Hartë e shpërndarjes së HGJU-së në Ha sipas njësive administrative të qytetit të Tiranës, 2019
Burimi: Bashkia Tiranë
Përpunoi: Autori




FIGURA 6.16.3 Sasia e HGJU-së në M² / Banor e shpërndarë sipas njësive administrative të qytetit të Tiranës, 2019
Burimi: Bashkia Tiranë
Përpunoi: Autori

Të gjitha të dhënat e gjeneruara në hartat më sipër, janë përmbledhur në formë tabelare në TABELËN 6.16.1 më poshtë.

Numër i Njësisë Administrative	Sipërfaqe e Njësisë (M ²)	Popullsia (Banorë)	M ² /Banor	HGJU / Njësi Administrative (Ha)
Njësi Administrative 01	3,059,778	51 871	3,05	15,8
Njësi Administrative 02	9,577,665	82 972	29,83	247,5
Njësi Administrative 03	2,009,486	45 174	2,59	11,7
Njësi Administrative 04	4,605,904	65 357	3,30	21,6
Njësi Administrative 05	2,865,151	86 997	2,93	25,5
Njësi Administrative 06	5,478,474	74 923	2,87	21,5
Njësi Administrative 07	3,056,755	74 950	3,06	22,9
Njësi Administrative 08	1,890,992	41 670	2,40	10,0
Njësi Administrative 09	2,779,880	64 014	2,67	17,1
Njësi Administrative 10	769,73	27 783	3,96	11,0
Njësi Administrative 11	4,992,395	65 354	4,24	27,7

TABELA 6.16.1 Tabelë Përmbledhëse e rezultateve të (1) Sipërfaqes, (2) Popullsisë, (3) Sipërfaqes së HGJU-së dhe (4) Sipërfaqe e HGJU-së në M² / Banor shpërndarë sipas Njësisë Administrative të Tiranës
Burimi: Autori

6.17 Konkluzione

Siç është përmendur edhe më parë, ky kërkim tenton të vendosë një gur të parë në fushën e studimit të hapësirave natyrore dhe gjysmë-natyrore në teksturën urbane të qytetit të Tiranës, kjo duke filluar ndërtimin e një databaze kryesisht të përqëndruar në hedhjen e sipërfaqeve të HGJU-ve të dimensioneve të mëdha, me karakter të fortë social dhe të pozicionuara në territore dhe akse kryesore. Ky kërkim nuk përfshin ndërtimin e databazës në brendësi të çdo blloku banimi dhe që nëpërmjet të gjithë mënyrës se si është strukturuar, tenton të krijojë një ide të përgjithshme të marrëdhënies që krijohet me HGJU-të në terma të sasisë së tyre, karakteristikave, pozicionimit të tyre në strukturën urbane për të mundësuar në hapa të tjerë jo vetëm plotësim me analizime, por dhe realizime të projekteve specifike të ndërhyrjes. Nga përpunimi i të gjitha të dhënave të hedhura në këtë databazë fillestare rezultojnë se:

1. Vlerat e HGJU-ve në terma të sasive, me gjithë gabimet e parashikuara, janë nën nivelet minimale të lejuara nga OBSH dhe shumë larg vlerave të rekomanduara;
2. Shpërndarja e tipeve të ndryshme të HGJU-ve të marra në konsideratë në këtë studim, nuk është një shpërndarje uniforme në territor në mënyrë që të ofrojë aksesueshmëri apo qasje nga të gjithë. Kjo përbën një tjetër problematikë në marrëdhënie me përmbushjen e kërkesave sidomos të aspektit social në një zhvillim të qëndrueshëm.

Saktësime më të mëdha dhe vlerësime të metejshme do të mund të realizohen në faza të mëvonshme, me ndërtimin e një metodologjie mbi pasurimin e data bazës me më tepër të dhëna mbi HGJU-të.

Pjesa e Tretë - Kërkim nëpërmjet projektimit; Eksperimentime Didaktikë

7. Hyrje

Ekzistojnë evidenca të forta që mbështesin krijimi e rrjeteve cilësorë të hapësirave të gjelbra dhe blu, duke përfshirë rrugët e gjelbra që të çojnë në vendndodhje kryesore, duhet të jenë prioritet në planifikimin e ditëve të sotme. Këto rrjete do të duhet të lëvizin nga shkallët rajonale, në ato lokale, dhe do të duhet të mbivendosen me rrjetin e trafikut dhe atë të transportit publik dhe privat. Kjo do të lejonte krijimin e një strukture të lidhur mirë që do të përfshinte një shumëllojshmëri madhësish dhe tipologjish të hapësirave të gjelbra. Do të duhet të konsiderohen nevojat e rezidenteve të cilët do të duhet të përfshihen në bashkë-projektimin e hapësirave të tyre të gjelbra. (De Oliveira, 2017)




FIGURA 7.0.1 Infrastruktura e gjelbër dhe gri janë nën-sisteme të cilat së bashku krijojnë peizazhin urban (David Witham, WRT)
Burimi: (Rouse, 2013)

Planifikimi urban duhet jo vetëm të sigurojë që densiteti i zhvillimit të jetë i përshtatshëm për karakterin e një mëhale, por në mënyrë të ndjeshme të rrisë cilësinë e hapësirave të hapura, kjo në terma mjedisore dhe sociale nëpërmjet projektimit. Ky synim do të mund të arrihet vetëm nëse (1) projektimi i hapësirave të gjelbra dhe (2) të konsideruarit e të gjitha “kokëçarjeve” mjedisore, të jenë një pjesë e integruar e planifikimit urban. Ky planifikim i integruar, i gjelbër duhet të formulojë dhe sistematikisht të zbatojë principe udhëzuese për të gjithë qytetin. Strategjia e planifikimit do të duhet të fokusohet në krijimin e një “shtylle të gjelbër kurrizore” si një element urban kyç i cili mund të jetë një “brez i gjelbër” i krijuar nga rrjetet parqesh, kopshtesh dhe sipërfaqesh ujore, apo mund të jetë një sistem lumor i vazhduar i rinatyalizuar i cili mund të lidhet me parqet, ndërtesat sportive dhe këndet e lojërave, rrugët e kalimit, ashtu sikurse dhe pajisjet e integruara dhe të lidhura publike. Mëhallët duhet të futen në këtë sistem dhe qeveritë lokale duhet të zbatojnë politika për të koordinuar zhvillimin privat të tyre së bashku me atë të ndërtesave, në përputhje me rrethanat e vendndodhjes (Bott, Grassl, & Anders, 2017). Sipas D. Witham, infrastruktura e gjelbër dhe ajo gri, janë nën-sisteme të cilat së bashku krijojnë peizazhin urban, thënë këtë, do të duhet të integrohen së bashku gjatë gjithë proceseve të planifikimit dhe të projektimit në shkallë të vogël.

7.1 Implementimi i teorisë në procese të kërkimit nëpërmjet projektit

Për këtë qëllim, implementimi i teorisë në procese të kërkimit nëpërmjet projektit, të gjithë problematikat e ngritura përgjatë kësaj teze disertacioni përipiqen të marrin një përgjigje edhe nëpërmjet zhvillimit të proceseve didaktike. Thënë këtë, por dhe duke konsideruar numrin e madh të strategjive në nivelin e PPV Tr2030, eksperimentohen projekte të “Implementimit të Infrastrukturës së Gjelbër” apo projekte të tjera me qasje të orientuar drejt prezencës më në brendësi të pëlhurës urbane të qytetit të Tiranës. Metodatat e përdorura në përgjithësi janë ende tradicionale, duke ju referuar përgjithësisht analizave të thjeshta hapësinore.

Një rast studimor i përzgjedhur, bazuar në objektivat kryesorë të paracaktuar, shkallës komplekse dhe vlerave që sjell, është një teme diplome e Masterit të Integruar në Arkitekturë, Profili Urbanist, ku ish-diplomantja tashmë arkitekte Lorena Hasani zhvilloi temën me titull “Lidhja hapësinore e Parqeve në Jug dhe Veri Të Tiranës - Drejt krijimit të Infrastrukturës së Gjelbër”. Kjo temë vjen në formën e zhvillimit të një projekti duke përkthyer në objektiva kryesore, njërin prej strategjive të PPV-së Tr2030, e që u zhvillua deri në detaje nëpërmjet zhvillimit të një punimi diplome.

Siç është përmendur edhe në kapitujt e mëparshëm, qëllimi i zhvillimit të këtij kërkimi është i shumëfishtë. Krahas krijimit të një data baze, zhvillimit të metodologjive dhe vlerësimeve e krahasimeve, kjo tezë disertacioni vjen me qëllim edhe për të demonstruar e për t’i ardhur në ndihmë proceseve didaktike nëpërmjet tentativës për të zhvilluar projekte e më pas për të sjellë e integruar metoda inteligjente në proceset e projektimit, thënë këtë edhe nëpërmjet aplikimit të tyre në auditor.




FIGURA 7.1.2

Skema të objektivave në zhvillimin e temës së diplomës;

Objektiva Ekonomike, Sociale dhe Mjedisore

Temë Diplome: “Lidhja hapësirore e parqeve në jug dhe veri të Tiranës – Drejt Krijimit të Infrastrukturës së Gjëlbrë”

Burimi: Diplomante Lorena Hasani | DU | FAU

Sidomos për implementime të elementëve të tillë të vazhduar në sistemin hapësinor të qytetit sikundër paraqitet “Infrastruktura e Gjellbër”, analiza hapësinore ku do të mund të integrohen shumë elementë si hapësira, dimensionimi i saj, shkalla e lidhjes (scale of connectivity), llogaritje të flukseve të lëvizjeve të shpejta e të ngadalta, vlerësimi i pronësive, i vlerës apo vlerave të pasurive të paluajtshme, shpërndarjes së shërbimeve në sistemin urban, etj., përdorimi i programeve si “ArcGIS” do të ishin shumë frytdhënës, pasi bëjnë të mundur analizimin e shumë elementëve të shtresëzuar e të ndërlidhur me njëri – tjetrin. Analizat që do të rezultojnë nga digjitalizimi zhvillimi i mëtejshëm i projekteve në proceset didaktike, do të mund të shërbenin për përmirësim të politikave apo projekteve reale, në bashkëpunim me institucionet e interesuara.

Një koordinim mes metodave tradicionale dhe metodave të shpejta, inteligjente është dhe rekomandimi për sa i takon vazhdimësinë në projektet e fushat e kërkimit të zhvilluara pranë UPT-së.

8. Konkluzione dhe Rekomandime

Në kushtet e lëvizjeve demografike nga zonat rurale në zonat urbane, qytetet po fitojnë një dimension të tillë i cili nëse nuk do të planifikohet siç duhet, mund të krijojë mjedis të papërshtatshme për të jetuar, krahas rrezikut tjetër të madh që mbartin - “Konsumin e burimeve natyrore”, por dhe efekteve indirekte siç është humbja e identiteteve lokale në territoret urbane, por sidomos ato rurale. **Thënë këtë, zhvillimi i modeleve të qyteteve të tilla që të mund të ruajnë balancat mes asaj që është artificiale dhe dimensionit natyror, është një prej sfidave të planifikuesve sot në të gjithë vendet e zhvilluara.** Peizazhi natyror, si elementi më vulnerabile në kontekstin e pëlurës urbane, shpesh neglizhohet për shkak të presioneve të zhvillimit (ky është një fenomen që ndodh në të gjitha kontekstet, por në shkallë të ndryshme). Trajtimi teorik në kapitujt e parë të këtij studimi, nuk ka vetëm rol informues, është një përpjekje për të përmbledhur e trajtuar në formën e një “timeline-i”, forma të ndryshme të qytetit që në periudhën kur lindi urbanistika, e deri në periudhën e revolucionit industrial. Arrijmë në përfundimin se - Në të gjitha rastet, që prej viteve 1900, rekomandohet që qyteti të zhvillohet së bashku me pjesën e peizazheve natyrore në brendësi dhe/apo periferi të tij.

Në fazën e parë të tij, kërkimi tenton të krijojë një sfond në një kontekst shumë më të gjerë sesa ai lokal, kjo për të kuptuar rëndësinë që kjo fushë - “landscape”, ka në Zhvillimin e Qëndrueshëm, duke prezantuar të gjitha (ose pjesën më të madhe të tyre) organizmat përcaktues në politike-bërje, e më pas duke tentuar të vendosë metodologji e të realizojë vlerësime sasiore e duke i ballafaquar me realitete evropiane. Në mungesë të shifrave, data bazave apo standardeve, konteksti lokal do të mund të kuptohet vetëm nëpërmjet krijimit të këtyre krahasimeve. Në 12+1 qytete të përzgjedhur, rezultojnë që Tirana ka sasinë në M²/Banor të HGJU-së më të vogël. Ajo që rezultojnë shqetësuese, është që vlerat që rezultojnë janë në nivele më poshtë krahasuar edhe me rekomandimet e OBSH-së për sa i takon prezencën minimale të HGJU-së. Kjo fazë e parë shërben njëkohësisht për të krijuar një kornizë të përgjithshme mbi “Metodat e vlerësimit të

elementeve natyrorë dhe gjysmë-natyrore, si edhe instrumenteve që do të mund të përdoren për realizimin e vlerësimeve”.

Që prej periudhës së pas-viteve '90, Tirana është karakterizuar nga një ritëm i shpejtë i rritjes demografike, shoqëruar kjo edhe me një urbanizim të territorit. Ajo që rezulton është se jo në të gjitha rastet ky urbanizim plotëson të gjitha kriteret për sa i takon dimensionit natyror të tij, megjithëse nuk kanë munguar instrumentet e planifikimit. Për këtë arsye në fazën e dytë të kërkimit tentohet të krijohet një sfond historik i zhvillimeve të qytetit të Tiranës, duke ju referuar tashmë termave dhe metodologjisë së aplikuar në analogji me vendet evropiane. Ajo që rezulton është që ndërsa qyteti rritet në dimensione, popullsia gjithashtu, hapësirat e gjelbra urbane tentojnë të shkojnë gjithmonë e më tepër drejt zvogëlimit, e krahas tyre dhe zënia e hapësirave të lira (pa ndonjë përdorim aktual) në brendësi të pëlhurës urbane, duke zvogëluar në këtë formë shkallën e fleksibilitetit që pëlhura urbane do të mund të ofronte. Edhe në këtë fazë, vlerësimet tentohen që të realizohen nëpërmjet sistemit GIS.

Sa më sipër ndodh në kontekstin lokal, ndërkohë që në kontekstin ndërkombëtar, kryefjala e këtij shekulli është “Zhvillimi i Qëndrueshëm” i cili bazohet në tre shtylla kryesore, **(1) Mjedis; (2) Ekonomi dhe (3) Aspekt social.**

Në rolin e projektuesve dhe planifikuesve, pra të aktorëve të cilët kanë një ndikim jo të vogël në mënyrën se si një territor lexohet, planifikohet dhe zhvillohet, rezulton shumë e rëndësishme që të kontribuojmë në përputhje me këto principe, ku do të duhet të nënvizojmë që ruajtja e mjediseve natyrore, si brenda, ashtu dhe jashtë strukturës së pëlhurës urbane ka një rol jo pak të rëndësishëm. Si aktorë pjesëmarrës gjithashtu në fushën akademike, do të duhet gjithashtu të orientonim fushat tona të studimeve dhe kërkimeve në drejtim të golave të përcaktuara e të miratuara në UN, në “Paris Agreement”.

8.1 Përshkrimi i arritjeve të këtij kërkimi

Ky kërkim ka rezultate në formë të përshkallëzuar dhe konkrete në disa drejtime, konkretisht:

- (1) Krijon një kornizë - “framework” të qartë të aspekteve teorike, si dhe të qasjeve dhe golave të rëndësishëm në fushën e peizazhit. Këto të fundit për t’u arritur në vitet në vijim;
- (2) Propozon një metodologji vlerësimi për sa i takon matjes sasiore të elementëve natyrorë në brendësi të sistemeve urbane, nëpërmjet përdorimit të sistemeve të GIS;
- (3) Propozon zhvillimin e përkufizimeve dhe përcakton kategori të hapësirave të gjelbra urbane, në analogji me ato të përdorura e vlerësuara në vendet e KE, thënë këtë, i kthyer në të krahasueshëm e konkurrues me kontekstet evropiane;
- (4) Jep vlerësim sasior M²/Banor nëpërmjet dy metodave mbi hapësirat e gjelbra urbane në Tiranë (HGJU-të, ato me karakter publik);

- (5) NËpËrmjet vlerËsimit të shpËrndarjes së hapËsirave të gjelbra, identifikon problematikat e zonave të ndryshme të qytetit;
- (6) Propozon të njëjtën formë pËrlllogaritje në pËrcaktimin e arritjes apo “aksesueshmërisë” së hapËsirave të gjelbra të pËrdorura në KE;
- (7) Krijon një data bazë fillestare pËr sa i takon hapËsirave të gjelbra urbane në qytet duke mundËsuar pasurimin e saj në të ardhmen e më pas, pËrdorimin e saj në analiza të tjera të rëndësishme;
- (8) Tenton të vËrë kËrkimin në shËrbim të pËrmirËsimit të procesit të projektimit dhe anaşjelltas;
- (9) Tenton të lidhë objektivat kryesorë të zhvillimit të qËndrueshëm, pËrcaktuar nËpËrmjet 17 golave edhe me fushën e edukimit dhe atë didaktike;
- (9) Mbi të gjitha, tenton të vendose theksin në një proces planifikimi e projektimi ku sistemet urbane dhe ato natyrorë zhvillohen njëkohësisht me qËllim të prodhuarit të një modeli qyteti të qËndrueshëm dhe të jetueshëm.

8.2 PËrse mund të shËrbejë ky kËrkim?

Në vijim të këtij kËrkimi, studimet të tjera do të mund ta pasojnë nËpËrmjet pasurimit të data bazës e vlerËsimeve të sa me poshtë:

- (a) Studime pËr sa i takon pËrfitimeve të ashtuquajturave “ShËrbime të Ekosistemit” (Ecosystem Services);
- (b) VlerËsime të indikatorëve të ndryshëm pËr të kuptuar cilësinë e jetës;
- (c) VlerËsime të indikatorëve pËr të kuptuar shkallën e fragmentarizmit të territorit natyror e më pas hartimit të projekteve pËr ristrukturim aty ku e nevojshme;
- (d) Shkallën e konsolidimit të zonës urbane;
- (g). Efektet e mikroklimës pËr sa i takon modifikimit të ishullit të nxehtësisë nËpËrmjet matjeve në zona të caktuara;
- (h) Matje pËr sa i takon shkallës së papËrshkueshmërisë nga uji, e më pas llogaritjes së pËrmbytjeve;
- (i) Pasurimi me të dhëna si, pËrcaktimi dhe dhënia e karakteristikave të bimësisë e vegjetacionit, e më pas pËrlllogaritjes së pËrfitimeve të ndryshme, pËrfshirë uljen e efektit të ishullit të nxehtësisë, prodhimit të oksigjenit, apo mbajtjes së pluhurave;
- (j) VlerËsimi i hartave mbi shpËrndarjen e bimësisë pËr sa i takon edhe problemeve të alergjive që ato shkaktojnë tek njerëzit;
- (k) Data bazë dhe shËrbime pËr sa i takon krijimit të projekteve mirëmbajtës dhe zËvendËsimit të bimësisë, sipas jetëgjatësisë e moshës së tyre;

- (l) Nisur dhe nga fakti i përfitimeve që mund të krijohen ndërmjet përdorimit të sistemeve të GIS nëpërmjet analizimit në 3D, do të mund të realizohen vlerësime edhe në lidhje me “Aspektin Vizual dhe Estetik të Elementëve Natyrorë” në zonat urbane. Analiza të cilat do të mund të udhëheqin e ri-krijojnë koncepte të leximit të qytetit apo të zhvillimeve të reja në përputhje me këtë qasje të rëndësishme;
- (o) Por, do të mund të realizohen edhe propozime mbi përmirësimin e metodologjisë në ruajtjen e të dhënave, si p.sh. krijimi i rrjetit të shpërndarjes së popullsisë sipas rrjetit kuadratik çdo 100M x 100M; Krijimin dhe përditësimin e hartave mbi bimësinë në një sistem urban, etj., etj..

9. Aneks 1

“Fjalorth” i Termave Teknikë të Përdorur

Në zhargonin e të folurit në gjuhën profesionale, shpesh përdorim terma të cilët hasen në literaturën e huaj, por që rezultojnë që ende nuk janë përvetësuar nga fjalori i gjuhës shqipe. Për korrektësi të procesit, krahas shpjegimeve nëpërmjet “footnotes” po mundohemi të bëjmë një përmbledhje dhe një shpjegim të shkurtër të kontekstit, apo të domethënies me të cilën këto terma janë përdorur në materialin e mësipërm.

Akses; Aksesueshmëri	Qasje; Mundësi për të arritur, për të aksesuar;
Antropizim	Ndryshim i tipareve të territorit, relievit, nga njeriu për qëllime të përdorimit nga vetë ai; Zonat urbane janë shembulli më i mirë ilustrues i antropizimit të territoreve natyrore;
Antropocentrike	Të konsideruarit e qenies humane si qendra e universit;
Benefite	Përfitime;
Biodiversitet	Tërësia e ekosistemeve për një rajon të caktuar ose për të gjithë globin;
Dashboards	Paraqitje në të njëjtin vend të disa formave grafike të dhënave;
Data bazë	Mbledhje e organizuar e një informacioni të strukturuar;
Densifikimi	Densifikimi i ndërtimit, rritja e ndërtimit për njësi sipërfaqe;
Derivon	Vjen si rrjedhim i një koncepti pre-ekzistues;
Disponueshmëri	Të qënurit në dispozicion; i gatshëm, etj.;
Diversitet	Shumëllojshmëri;
Ekocentrike	Term i përdorur nga filozofet e mjedisit dhe ekologjisë nëpërmjet të cilit vendoset natyra në qendër të universit, jo të qenies humane;
Fleksibël	Elastik; Të ketë aftësi të përkulet apo adaptohet lehtë;

Fotovoltaik	(Panele fotovoltaike) të cilat realizojnë shndërrimin e energjisë së dritës në energji elektrike;
Framework	Strukturë apo kornizë e strukturuar që shërben si udhëzues për të ndërtuar e kthyer këtë strukturë në material të përdorshëm;
